



# RINIA SHQIPTARE 2015

Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti... dhe besim tek BE!

Alba Çela

Geron Kamberi

Elena Pici – koordinatore e FES

**FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG**

# Rinia Shqiptare 2015

Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti..dhe besim tek BE!

Alba Çela

Geron Kamberi

Elena Pici – koordinatore e FES

Rinia Shiptare 2015

*“Ndryshim i ngadaltë, mbështetje tek interneti...dhe besim tek BE!”*

Mundësuar nga:

**Fondacioni “Friedrich Ebert”**

Zyra e Tiranës

Rruga: “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati i 6-te, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 22 50 986/22 73 306; Fax: +355 (4) 22 62 067

<http://fes.org.al>

Kordinimi, puna në terren, përpunimi grafik dhe redaktimi:

**IDRA Research & Consulting**

Autorët:

Alba Çela

Geron Kamberi

Elena Pici – koordinatore e FES

Viti i botimit: 2015

Mbledhja e të dhënave dhe studimi u kryen gjatë periudhës Shtator - Nëntor  
2014

# Përmbajtja

<b>FJALË HYRËSE</b> .....	7
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	9
<b>KAPITULLI I: TË RINJTË DHE KOMUNITETI - BESIMI DHE VLERAT</b>	
<b>1. Hyrje</b> .....	19
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	20
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	22
3.1 <i>Besimi dhe ndjenja e përkatësisë</i> .....	22
3.2 <i>Paragjykimet dhe diskriminimi</i> .....	24
3.3 <i>Vlerat</i> .....	29
<b>4. Përfundime</b> .....	38
<b>5. Rekomandime</b> .....	39
<b>KAPITULLI II: FAMILJA DHE LIDHJET SHOQËRORE... 37</b>	
<b>1. Hyrje</b> .....	42
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	43
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	44
3.1 <i>Marrëdhëniet me prindërit dhe familjen</i> .....	44
3.2 <i>Martesa dhe lidhja në çift</i> .....	50
3.3 <i>Shoqëria dhe rrethi shoqëror</i> .....	61
<b>4. Përfundime</b> .....	66
<b>5. Rekomandime</b> .....	67

### KAPITULLI III: ARSIMI DHE PUNËSIMI

<b>1. Hyrje</b> .....	70
<b>2. Gjetje kryesore</b> .....	71
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	72
3.1 <i>Arsimi – rëndësia dhe preferencat</i> .....	72
3.2 <i>Vlerësimi mbi sitemin arsimor</i> .....	78
3.3 <i>Punësimi</i> .....	83
<b>4. Përfundime</b> .....	94
<b>5. Rekomandime</b> .....	95

### KAPITULLI IV: SHQETËSIMET DHE ASPIRATAT

<b>1. Hyrje</b> .....	98
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	99
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	100
3.1 <i>Migrimi dhe emigrimi</i> .....	100
3.2 <i>E ardhmja dhe qëllimi në jetë</i> .....	106
3.3 <i>Altruizmi dhe morali</i> .....	108
3.4 <i>Raporti me të tjerët</i> .....	108
<b>4. Përfundime</b> .....	110
<b>5. Rekomandime</b> .....	111

### KAPITULLI V: KONSUMI, ARGËTIMI DHE TENDENCAT

<b>1. Hyrje</b> .....	114
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	115
<b>3. Analizë e detajuar e rezultateve</b> .....	117
3.1 <i>Koha e lirë</i> .....	117
3.1.1 <i>Mundësitë ekonomike, vendndodhja dhe opsionet</i> .....	119
3.1.2 <i>Çfarë ndjekin në ekranin e madh</i> .....	121
3.1.3 <i>Interneti</i> .....	124

3.2 Shpenzimi i parave.....	127
3.2.1 Çfarë është në modë?.....	128
3.3 Aspekte të tjera të stilit të jetesës.....	130
3.3.1 Konsumi i duhanit dhe alkoolit.....	130
3.3.2 Aktiviteti seksual.....	133
<b>4. Përfundime</b> .....	136
<b>5. Rekomandime</b> .....	137

## KAPITULLI VI: DEMOKRACIA DHE QEVERISJA

<b>1. Hyrje</b> .....	140
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	141
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	143
3.1 Qeverisja dhe elementët e saj.....	143
3.1.1 Problemet e zhvillimit.....	145
3.2 Demokracia dhe Politika.....	152
3.2.1 Interesi dhe informacioni mbi politikën.....	152
3.2.2 Sjellja Politike.....	157
3.2.3 Besimi tek demokracia dhe tek institucionet.....	161
<b>4. Përfundime</b> .....	167
<b>5. Rekomandime</b> .....	168

## KAPITULLI VII: SHQIPËRIA DHE EUROPA

<b>1. Hyrje</b> .....	170
<b>2. Gjetjet kryesore</b> .....	171
<b>3. Analiza e detajuar e rezultateve</b> .....	172
3.1 Anëtarësimi në BE.....	172
3.2 Efekti i anëtarësimit.....	173
3.3 Koha e anëtarësimit.....	174
3.4 Çfarë përbën anëtarësimi.....	175
3.5 Angazhimi i qeverisë Shqiptare.....	178

4. Përfundime.....	179
5. Rekomandime.....	180

## KAPITULLI VIII: ZËRI I TË RINJVE

HYRJE.....	182
1. Koha e lirë dhe mënyra e jetesës.....	184
2. Familja dhe rrethi shoqëror.....	188
3. Çështje besimi dhe përkatësie.....	193
4. Shqetësime dhe Aspirata.....	195
5. Arsim dhe Punësim.....	197
6. Qeverisje dhe Zhvillim.....	202
7. Politika.....	205
8. Bashkimi European.....	210
Aneks I: Metodologjia.....	217
Aneks II : Pyetëtori.....	221

## FJALA HYRËSE

Në 2011, FES-Tirana publikoi për herë të parë një studim shumë domethënës “Rinia Shqiptare 2011”, i cili shumë shpejt u bë studimi më i lexuar dhe më i referuar në lidhje me çështjet rinore. Ky studim i parë gjithëpërfshirës është referuar nga politikanë në parlament, nga gazetarë dhe studiues. Por më e rëndësishmja, ai u bë një lloj udhërrëfyesi për të gjithë ata që donin të punonin me dhe për rininë, dhe të rrisnin reputacionin dhe influencat e organizatës së tyre në politikë dhe shoqëri.

Gjenerata e re në Shqipëri është padyshim jo në minorancë. Fatmirësisht për vendin, rinia është në mazhorancë dhe ky është një ndër asetet më premtuese të vendit. Por megjithëse u bë e dukshme nëpërmjet këtij studimi se gjenerata e re ka disa kërkesa dhe nevoja të justifikueshme, reagimi nga politikë-bërja dhe shoqëria, ishte pak a shume sipërfaqësor. Po, partitë dhe organizma të tjerë tashmë kanë më shumë funksionarë të rinj dhe veçanërisht përpara zgjedhjeve çështjet rinore kthehen në qendër të vëmendjes të fjalimeve dhe premtimeve. Megjithatë, ka ende pak ndryshime për të rinjtë dhe për prespektivën e tyre të jetës. Papunësia rinore është ende ndër më të lartat në Ballkan, dhe sistemi edukimit vazhdon të ofrojë alternativa pa prespektive, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për ekonominë Shqiptare. Si ka mundësi që ende gjysma e të rinjve shqiptarë janë të papunë? Si ka mundësi që nga ana tjetër investitorët, shqiptarë dhe të huaj, janë dëshpërimisht në kërkim të fuqisë punëtore të kualifikuar?

Vazhdimësia e kësaj prespektive jo të mirë për gjeneratën e re mund të jetë arsyeja për shumë nga gjetjet e tjera të studimit, i cili tashmë është update-uar/përditësuar. Kryesisht ka vetëm pak ndryshime në rezultate, dhe fatkejsisht këto nuk tregojnë më shumë shpresë të gjeneratës së re se gjërat do të bëhen më mirë.



Nga ana tjetër, gjetjet na parashetrojnë shumë rekomandime se çfarë ne të gjithë mund të bëjmë tani. Së pari, vetë të rinjtë duhet te punojnë për të ardhmen e tyre më të mirë, duke qënë se ata duhet ta kenë mesuar se askush tjetër s'do ta bëj punën për ta. Por, së dyti, politikanët, partitë dhe organizatat duhet të kuptojnë që nuk është e mjaftueshme t'u japin të rinjve poste funksionarësh sepse kjo përngjan moderne, por të punojnë me ta, për problemet e tyre çdo ditë. Të punuarit për prespektiva më të mira për të rinjtë është një çështje për të gjithë shoqërinë, për të parandaluar largimin e të rinjve dhe mos zhvillimin ekonomik. Rruga drejt Bashkimit Evropian do të mbyllet nëse nuk do të përfshihen nevojat e të rinjve sa më shpejt të jetë e mundur.

**Frankt Hantke**  
**Drejtor FES**

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Studimi Rinia shqiptare 2014 është një fotografi shumëngjyrëshe e gjendjes së të rinjve shqiptarë, vlerave, ambicieve, dëshirave, shqetësimeve, sfidave dhe mendimeve të tyre. Në të njëjtën kohë ajo është një pasqyrë e larmisë së aktiviteteve që ata kryejnë rregullisht, sjelljeve që kanë dhe rrjeteve shoqërore ku bëjnë pjesë. Ky studim është hartuar mbi bazën e të dhënave numerike e cilësore të mbledhura nga sondazhi kombëtar me 1200 të rinj në të gjithë vendin dhe nga bisedat e strukturura në 8 fokus grupe.

Të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e 1200 të rinjve janë të grupuara sipas kapitujve të ndryshëm tematikë të pyetsorit. Në secilin kapitull janë vënë dhe kutiza ilustruese me të dhëna cilësore nga përgjigjet e marra prej fokus grupeve përkatëse. Ky studim është i ndarë në 7 kapituj kryesorë:

- Besimi dhe përkatësia
- Familja dhe shoqëria
- Arsimi dhe punësimi
- Shqetësimet dhe aspiratat
- Koha e lirë dhe mënyra e jetesës
- Qeverisja dhe demokracia
- Integrimi evropian dhe të rinjtë

Përmbajtja e seksionit të përmbledhjes ekzekutive ndjek rrjedhën e renditjes së kapitujve të studimit duke i paraqitur shkurtimisht lexuesit rezultatet dhe konkluzionet kryesore të këtyre kapitujve.

Ashtu sikundër në vitin 2011, kur u realizua për herë të parë ky sondazh, edhe këtë rradhë studimi fillon me kapitullin **“Besimi dhe Vlerat”** që bën një shqyrtim të niveleve të besimit familjar e horizontal.

Në të përfshihen dhe aspekte të tjera të botëkuptimit të brendshëm të të rinjve që kanë lidhje me vlerat, përkatësinë në komunitet dhe spiritualitetin. Në këtë drejtim rrethi i besimit tek të rinjtë në Shqipëri vazhdon të jetë i përqëndruar tek familja bërthamë së cilës ata i përkasin (nga të rinjtë e intervistuar ajo vlerësohet me 10 pikë maksimale të mundshme). Nivele të larta besimi gëzojnë dhe të afërmit. Ndërkohë ky nivel vjen duke ulur për kategori të tjera si miqtë, kolegët dhe njerëz të ndryshëm nga përkatësia fetare apo politike, me të cilët ndërveprimi i përditshëm është i shpeshtë (4-5 nga 10 pikë të mundshme). Nivelin më të ulët të besimit të rinjtë e shfaqin për fqinjët (3/10 pikë) duke pasqyruar në këtë mënyrë ndryshimet demografike apo të vlerave si rezultat i tranzicionit. Përsa i përket diskriminimit janë të ulëta përqindjet e të rinjve shqiptarë që shfaqin shenja të tilla ndaj kategorive të ndryshme shoqërore, por paragjykimi më i fortë që ushqejnë të rinjtë në Shqipëri është homofobia. Nga ana tjetër ata shfaqen shumë mikpritës dhe të hapur ndaj të huajve që vinë nga vendet Perëndimore. Në lidhje me vullnetarizmin ai vazhdon të mbetet sërish një pikë e dobët mes të rinjve pasi vetëm një ndër pesë të rinj në Shqipëri ka pasur një angazhim vullnetar gjatë vitit 2014. Vlerat kryesore që kanë rëndësi për të rinjtë shqiptarë janë dinjiteti vetjak, besnikëria dhe korrektësia ndërsa tek ato më pak të rëndësishme përfshihen shpirti inovator, konkurrenca dhe pasurimi. Nivelet e identifikimit të të rinjve me besimet fetare tradicionale janë të larta (mbi 95 përqind në total shprehen që i përkasin një besim të caktuar) por ndërkohë niveli i praktikimit të fesë nga ana e tyre është shumë i ulët, i përqëndruar kryesisht gjatë festave kryesore fetare 2-3 herë në vit. Të rinjtë vijojnë traditën e vizitave në vende të shenjta (pavarsisht nëse ato lidhen ose jo me besimin e tyre fetar dhe rreth 50% e të rinjve të pyetur e pohojnë këtë).

Ndërsa kapitulli **“Familja dhe shoqëria** paraqet një sërë të dhënash ku vërejmë sërish se roli i familjes si një mjedis social i rëndësishëm mbetet ende i fortë dhe ndikimi i saj në vendimmarrjen e të rinjve është mjaft i dukshëm.

Përballja e të rinjve me koncepte të reja të marrëdhënies në çift si bashkëjetesa nuk e ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore parapëlqimin e tyre ndaj formës tradicionale të martesës e cila mbetet mbizotëruese mes tyre. Nga ana tjetër, ndryshimet e vazhdueshme social-ekonomike dhe niveli i teknologjive të informacionit e ka zvogëluar së tepërmi dallimin

mes të rinjve të zonave urbane dhe rurale lidhur me qëndrimin e tyre ndaj çështjeve të tilla si virgjëria, martesë, bashkëjetesa apo numri i fëmijëve në një familje të ardhshme.

Marrëdhëniet shoqërore mes të rinjve kanë pësuar një shndërrim të dukshëm për shkak se është shtuar numri i mjediseve sociale jashtë shkollës ku ata mbledhen dhe forcojnë shoqërinë mes tyre të tilla si klubet, bingot, restorantet, pubet, diskot apo palestra.

Megjithëse niveli i përfshirjes së të rinjve në konflikte apo akte dhune në këto mjedise është i ulët, përkundrajt këtij fakti vërejmë se të rinjtë pohojnë se shkolla është një hapësirë ku ata janë ndeshur më shumë me fenomene të tilla. Si konkluzion përfundimtar mund të themi se raporti i të rinjve shqiptarë ndaj familjes, lidhjeve shoqërore dhe elementëve të veçantë të sipërmendur, përbën një dëshmi të gjithë atyre faktorëve socialë, ekonomikë e kulturorë që kanë ndikuar gjatë këtyre 25 viteve të tranzicionit.

Në lidhje me kapitullin **“Arsimi dhe Punësimi”** ai konsiderohet shtylla kurrizore e interpretimit të interesave rinore.

Nga të dhënat vërejmë se interesi për mbarëvajtjen e cilësinë e arsimit mbetet shqetësimi kryesor i të rinjve shqiptarë. Megjithëse është shtuar niveli i informimit mbi rëndësinë e dobinë e arsimit profesional për punësim, të rinjtë vazhdojnë të tërhiqen nga ideja e studimeve universitare pavarësisht perspektivës së punësimit.

Ndërkohë që cilësia e mësimdhënies në shkolla e universitete vazhdon të shqërohet nga perceptimet e pandryshuara të të rinjve për praninë e elementeve të korrupsionit, blerjes së notës dhe provimeve duke cënuar reputacionin e tyre. Kjo pasqyrohet në parapëlqimet e tyre për të ndjekur studimet e larta në shkolla jashtë vendit.

Ndërkohë roli i faktorëve ekonomikë përcakton një seri të sjelljeve e qëndrimeve të të rinjve karshi perspektivave të tyre për arsim dhe ndikon tek lidhja me punësimin.

Në këtë drejtim Punësimi është kryefjala e shqetësimeve të rinjve sidomos për ata që kanë mbaruar studimet ose janë në vitin e fundit të tyre. Nga të dhënat e studimit rezulton se praktika e të pasurit një stazhi paraprak pune, apo sic njihet ndryshe internshipi, nuk është e përhapur tek të rinjtë, pasi vetëm 17 përqind e tyre pohojnë se janë angazhuar në një aktivitet të tillë. Pjesa më e madhe e të rinjve mendojnë se do tju duhet të presin për të gjetur një vend pune pas mbarimit të studimeve, ndërkohë që x përqind janë pesimistë përsa i përket punësimit të tyre. Aktualisht në Shqipëri punon një ndër pesë të rinj, një fakt që tregon një rënie të punësimit të rinjve përkundër rezultateve të vitit 2011 kur shifra ishte 35 përqind. Vetëm 30 përqind e atyre që janë të punësuar kanë një vend pune që përputhet me profilin e studimeve apo profesionin. Administrata publike vazhdon të jetë mjaft tërheqëse për të rinjtë pasi gjysma e tyre pohojnë se do të zgjidhte pikërisht të punësohej në sektorin publik. Në krahasim me të dhënat e vitit 2011 ka një rritje të lehtë nga 25 në 33 përqind të të rinjve që duan të punësohen në sektorin privat. Ndërkohë të rinjtë mendojnë se rolin më të rëndësishëm në gjetjen e një vendi pune e luajnë njohjet e miqësitë ndryshme që mund ti favorizojnë. Sipas tyre arsimi dhe përgatitja profesionale luajnë rol dytësor dhe kanë të njëjtën vlerë si njohjet politike. Përsa i përket zgjedhjes së një profesioni të caktuar faktori që ka më shumë rëndësi për të rinjtë janë të ardhurat e më pas qëndrueshmëria e vendit të punës.

Një element interesant paraqet Kapitulli “**Shqetësimet dhe Aspiratat**” ku të dhënat e anketimit na tregojnë se pavarësisht prirjes në rënie të migrimit të brendshëm ka sërish një nivel të lartë për emigrim. Shoqëria shqiptare ka pësuar në këto vite ndryshime dhe zhvendosje të mëdha nga fshati në qytet dhe nga Shqipëria jashtë saj. Këto ndryshime të vendbanimit kanë sjellë ndryshime të shumta në mënyrën e jetesës së të rinjve e për pasojë edhe të vlerave dhe koncepteve të përgjithshme nga të cilat shoqëria përcakton se çfarë është e keqe apo e mirë, e dëshirueshme apo jo, e vlefshme apo e kotë. Ndonëse këto lëvizje kanë qenë të shpeshta dhe pothuajse të pakontrolluara tashmë të dhënat na dëshmojnë se tashmë po bëhen të gati të padukshme dallimet ndërmjet vlerave dhe besimeve të zonave rurale me ato urbane.

Megjithatë pasojat e kësaj lëvizje kanë sjellë çrregullime sociale , rritje të kriminalitetit, paqartësi dhe vështirësi të të rinjve në përshtatje me jetesën në zonat urbane. Edhe pse të dhënat tregojnë se të rinjtë në Shqipëri

besojnë në vlera si guximi, altruizmi dhe të qenit i hapur në shoqëri, sërish mendojnë se lidhjet e ngushta miqësore dhe familjare janë shumë të rëndësishme në mënyrë që të kesh sukses në jetë.

“Miku”, i cili zgjidh një pjesë të mirë të halleve, duke filluar nga punësimi e deri tek ato familjare është një ndër “pasuritë” më të rëndësishme të individit në Shqipëri pa të cilin pak të rinj besojnë se mund të arrijn atë që dëshiron në jetë. Ky tregues pasqyron një nivel të ulët të institucionalizimit të shoqërisë dhe pavarësisë së individit për të zgjidhur problemet e tij përballë institucioneve apo edhe pjesës së “huaj”, të panjohur. Edhe pse tek të rinjtë ky mentalitet ka prirje drejt rënies dhe po rritet besimi në aftësinë e gjithsecilit për të përballuar jetën, pavarësisht lidhjeve dhe miqësive, sërish ato shihen si element me rëndësi për mirëqenien e individit.

Nuk mund të flasësh për të rinjtë pa shqyrtuar aspektet që lidhen me stilin e tyre të jetesës. Kapitulli **“Stili i jetesës”** përpiqet të japë një panoramë të të rinjve, sjelljet në kohën e lirë dhe modelet e tyre të konsumit. Këto janë aspekte interesante për të kuptuar fushat ku mund të ndërhyhet për të pasur të rinj më të shëndetshëm dhe më aktivë. Gjithashtu të dhënat në këtë kapitull na ndihmojnë të kuptojmë mjetet e informacionit që kanë më shumë ndikim tek ata.

Alternativat kryesore që të rinjtë kanë për kalimin e kohës së lirë janë televizioni, muzika dhe frekuentimi i kafeneve dhe bareve me miqtë. Nga të dhënat vërehet se është në ulje numri i të rinjve në Shqipëri që lexojnë në kohën e lirë: rreth një e treta e meshkujve thonë se pothuajse nuk lexojnë kurrë. Të rinjtë e frekuentojnë pak kinemanë si pasojë e ekzistencës vetëm në disa qytete kryesore por dhe si pasojë e zëvendësimit të saj nga shikimi i filmave në Internet. Rreth 85 përqind e të rinjve në Shqipëri kanë akses në internet dhe ata shpenzojnë mesatarisht 3.2 orë duke naviguar Internetin, kryesisht në rrjetet sociale. Të rinjtë shpenzojnë mesatarisht 3.2 orë duke ndjekur televizor. Programet më të ndjekura nga të rinjtë janë ato me përmbajtje muzikore, filmat aksion dhe telenovelat.

Sipas të dhënave që dalin nga sondazhi të rinjtë kanë nevojë për një buxhet mesatar mujor prej 11.000 lekë të reja për të plotësuar nevojat e tyre për blerje të ndryshme të veshjeve, shërbime si palestra apo alternativat e argëtimit si kafenetë dhe baret.

Për rreth 90 përqind të të rinjve të dukesh dhe të vishesh bukur janë gjërat më në modë. Martesa po humbet terren si dicka në modë tek të rinjtë ashtu sikundër edhe konsumi i marijuanës. 17 përqind e të rinjve pohojnë se janë përdorues të rregullt të duhanit ndërsa sipas tyre përdorimi i alkolit është i rrallë ose gjatë fundjavave. Mbi gjysma e të rinjve e gjejnë të papranueshëm përdorimin e alkolit në shoqëri.

Përsa i përket sjelljeve seksuale mes të rinjve një e treta e tyre mohan të ketë kryer marrëdhënie seksuale dhe një e treta pohon se ka marrëdhënie me një partner të vetëm. Meshkujt kryesojnë grupin e të rinjve aktivë seksualë me më shumë sesa një partner. Rreth 30 përqind e të rinjve i përdorin rregullisht masat mbrojtëse në jetën e tyre seksuale përkundër 23 përqind që nuk i përdor kurrë ato. Një pjesë e konsiderueshme rreth 30 përqind i përdor masat mbrojtëse vetëm me raste. Nga ana tjetër 57 përqind e të rinjve ende e gjejnë si një vlerë të rëndësishme virgjërinë ku mbizotëron gjykimi se është një vlerë më në vlerë për femrat.

Duke qenë se të rinjë janë forca kryesore aktive në një shoqëri demokratike ka rëndësi të mësohet opinioni i tyre për funksionimin e qeverisjes e demokracisë. Për këtë arsye Kapitulli **“Qeverisja dhe Demokracia”** përpaket të analizojë qëndrimet e perceptimet e të rinjve për këto dy shtylla të shoqërisë. Qeverisja dhe zhvillimi i vendit janë dy ndër elementët kryesorë që janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe me të cilin të rinjtë përballen në jetën dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Nga të dhënat e këtij vëzhgimi vërejmë se të rinjtë e konsiderojnë moszbatimin e ligjit, krimin e rrugës dhe trafiqet e ndryshme si ndër shqetësimet kryesore për sa i përket sigurisë së tyre dhe që i prek ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, pavarësisht nivelit të tyre socio-ekonomik, arsimimit apo vendndodhjes gjeografike.

Nga ana tjetër, kërcënimet e terrorizmit ndërkombëtar apo tjetërsimi i identitetit etnik nga bashkëmoshatarët e tyre në vendet ku kanë emigruar janë shqetësime të karakterit dytësor. Vërejmë se përqindja më e lartë e natyrës së shqetësimeve të të rinjve lidhet me sfidat e jetës së tyre të përditshme që përkojnë me varfërinë, papunësinë, pasigurinë për vendin e punës apo edhe ndotjen e mjedisit ose sëmundjet kanceroze që shtohen. Këto shqetësime parësore i përcaktojnë elementët e qeverisjes dhe zhvillimit si dy nga shtyllat kryesore që të rinjtë i shohin të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së jetës në mënyrë që ata ta përjetojnë të ardhmen si tyre si mundësi dhe jo si ankth.

Megjithëse shumica e të rinjve shprehin një vlerësim të përmbajtur por shpresëdhënës për sa i përket zhvillimit ekonomik të Shqipërisë për 10 vitet e ardhshme, ajo ende përzihet me pasigurinë e vazhdueshme të një tranzicioni të gjatë e të lodhshëm. Niveli i besimit të të rinjve në institucionet publike është ende i pakët çka duhet ti nxisë këta të fundit të rishikojnë politikat e transparencës dhe llogaridhënies përballë publikut. Të rinjtë e shohin qeverisjen të lidhur ngushtë me luftën ndaj varfërisë dhe papunësisë për sa kohë këto mbeten disa prej shqetësimeve kryesore mes të rinjve si forca aktive më e madhe për punë.

Shqipëria është një vend kandidat i BE ku mosha mesatare e popullsisë është rreth 25 vjec. Në këto kushte nënkuptohet përse nuk duhet të mungonte në këtë studim Kapitulli Rinia & Integrimi European Duke qenë se projekti më i rëndësishëm i të gjithë klasës politike shqiptare është ai i integritit european, ky studim ka përfshirë matjen e pulsit të të rinjve mbi këtë çështje dhe pritshmëritë e tyre në lidhje me anëtarësimin e mundshëm në BE. Të rinjtë shqiptarë janë pjesa më pro-evropiane e popullsisë dhe 87 përqind e tyre do të votonin pro anëtarësimin të vendit të tyre në BE. Të rinjtë presin nga integrimi zhvillim të dyfishtë politik dhe ekonomik ndërkohë që një pjesë fare e vogël janë skeptikë (5 përqind) dhe i frikësohen efekteve të krizës ekonomike.

Të rinjtë janë të dyzuar dhe të paqartë në pritshmëritë e tyre në lidhje me kohën e anëtarësimin të Shqipërisë në BE. Megjithatë rreth 70% e tyre presin që ky proces të përmbillet në 5 ose 10 vitet e ardhshme.



Në mendësinë e të rinjve shqiptarë integrimi dhe anëtarësimi lidhen kryesisht me lëvizjen e lirë, me mundësinë për të jetuar, qëndruar dhe punuar pa kufizime në hapësirën e përbashkët europiane.

Gjithashtu vërehet një rritje e vlerësimit pozitiv të të rinjve për angazhimin e qeverisë shqiptare ndaj përmbushjes së detyrimeve për integrimin evropian. Kështu 50 përqind e të rinjve të intervistuar gjatë vitit 2014 janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me rolin e ekzekutivit në procesin e integritit evropian të Shqipërisë cka duket se pasqyron optimizmin e tyre pas marrjes së statusit të vendit kandidat në Qershor 2014.

# KAPITULLI I:

TË RINJTË DHE KOMUNITETI  
BESIMI & VLERAT

Përgatitur nga: **Alba Çela**

## 1. Hyrje

Besimi dhe përkatësia në grupe shoqërore të ndryshme përcaktojnë një pjesë të madhe të sjelljeve dhe qëndrimeve të njerëzve në jetën e tyre duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në vendimet që ata marrin. Literatura akademike tregon se vendet që kalojnë ose sapo kanë kaluar periudha tranzicioni të rëndësishme kanë nivele besimi të larta vetëm tek rrethi i ngushtë familjar dhe shohin me dyshim cdo kategori tjetër. Sondazhet e deritanishme në Shqipëri e vertetojnë këtë hipotezë dhe do të jetë interesante nëse studimet mbi qëndrimet e sjelljet e të rinjve do të mund të shënojnë më vonë një prirje të ndryshme. Shqipëria ashtu si dhe vende të tjera në rajon dhe në Europë ka përjetuar në dy vitet e fundit simptoma të fenomenit të radikalizimit fetar dhe madje rreth 80 shqiptarë kanë zgjedhur ti bashkohen grupimit terrorist ISIS në luftën në Irak dhe Siri. Nga raportimet e ndryshme pjesa kryesore (por jo e vetme) e këtyre personave të radikalizuar është në moshë të re. Për këtë arsye mes të tjerave merr një rëndësi e vecantë matja e pulsit të të rinjve në lidhje me perceptimet dhe përvojat e tyre që kanë të bëjnë me fenë dhe nëse harmonia fetare është ende kryefjala e sjelljes së tyre.

## 2. Gjetjet kryesore

- Familja mbetet institucioni ku të rinjtë besojnë më shumë dhe niveli i besimit tek ajo arrin në 99 nga 100 pikë. Të afërmit janë kategoria e dytë që ka nivelin më të lartë të besimit nga të rinjtë, të cilët ata i vlerësojnë me 74 pikë. Pas këtij niveli të rinjtë shfaqin tregues besimi neutral ose të ulëta lidhur me kategori ose grupe të tjera sociale. Niveli më i ulët i besimit të të rinjve pasqyrohet tek fqinjët e tyre që vlerësohen me 33 nga 100 pikë të mundshme.
- Paragjykimi më i fortë që ndeshet tek të rinjtë shqiptarë dhe sidomos te meshkujt është homofobia. Ndërkohë janë të pranishme mes tyre edhe paragjykimet ndaj minoritetit rom. Psh nëse një familje e këtij komuniteti do të mund të ishte fqinjë e tyre kjo do të bënte që 15 përqind e të rinjve të ndiheshin keq ose shumë keq.
- Për herë të parë këtë vit të rinjtë e intervistuar janë pyetur sesi do reagonin ndaj një familje fqinjë që është praktikante e devotshme e fesë (shumë besimtare). Në këtë pikë të rinjtë shqiptarë shfaqen tolerantë dhe pa paragjykime teksa mbi 50 përqind e të rinjve pohojnë se do ta mirëprisnin atë ndërsa 38 përqind deklarojnë se do të ndiheshin indiferentë ndaj një situatë të tillë.
- Të rinjtë kanë raportuar nivele shumë të ulëta të diskriminimit në jetën e tyre. Në ndryshim nga katër vite më parë ku faktorët kryesorë të diskriminimit ishin origjina krahinore dhe prejardhja urbane/rurale këtë vit statusi ekonomik dhe përkatësia politike kanë fituar terren si faktorë diskriminimi.
- Të pyetur për vlerat, mbi 40 përqind e të rinjve mendojnë se dinjiteti vetjak është vlera më e rëndësishme. Po ashtu besnikëria dhe korrektësia janë mjaft të rëndësishme për një pjesë të konsiderueshme të tyre.
- Shumë pak të rinj përmendin si të rëndësishme për ata vlera të tilla si pasurimi, kreativiteti dhe shpirti konkurrues.

- Numri i të rinjve që përmendin statusin (prestigjin) social si vlerë është përgjysmuar: katër vite më parë rreth 25 përqind e rendisnin statusin social në vendin e dytë ose të tretë të vlerave ndërkohë që këto shifra këtë vit janë vetëm 9 përqind. Rënie kanë pasur edhe besimi i të rinjve në vlera të tilla si toleranca e altruizimi.
- Një ndër pesë të rinj në Shqipëri raporton se është angazhuar në aktivitete vullnetare gjatë 2014, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2011 ku shifra ishte 16 përqind. Aktivitetet më të zakonshme vullnetare ku të rinjtë marrin pjesë janë pastrimi i mjediseve publike por ka një rritje të angazhimit të tyre vullnetar për të dhënë mësim kompjuteri/teknologjie falas.
- Arsyet kryesore të motivimit të të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete vullnetare janë dëshira për tu ndjerë aktivë në shoqëri si dhe ndjenja e përkushtimit.
- Të rinjtë shqiptarë vetë-identifikohen me një nga besimet fetare: 76 përqind i përkasin fesë myslimane, 7 përqind fesë së krishterë ortodokse dhe 10 përqind asaj katolike. Vetëm 2 përqind thonë se nuk praktikojnë ndonjë fe të caktuar dhe 1.2 përqind janë ateistë.
- Shumica e të rinjve e praktikojnë fenë vetëm në rastet e festave fetare. Rreth 61 përqind e të rinjve thonë se praktikojnë fenë në këtë mënyrë ndërsa 23 përqind pohojnë se nuk e praktikojnë asnjëherë atë.
- Gjysma e të rinjve të pyetur raportojnë se gjatë vitit 2014 kanë vizituar një vend ose ndërtesë të shenjtë që i përket një feje/kulti të ndryshme nga feja e tyre,


## 3. Analiza e detajuar e rezultateve

### 3.1 Besimi dhe ndjenja përkatësisë

Të rinjtë shqiptarë kanë besim maksimal te familja e ngushtë dhe ky nivel besimi vlerësohet me 99 nga 100 pikë të mundshme. Ndërsa të të afërmit janë kategoria e dytë ku ata besojnë më shumë, duke e vlerësuar nivelin e besimit ndaj tyre me 74 pikë.

Pas këtij vlerësimi treguesit e tjerë të besimit ndaj kategorive apo grupeve të ndryshme shfaqen në nivele neutrale ose të ulëta. Kështu për shembull besimi te miqtë është pak sipër shifrës 50 nga 100 pikë të mundshme, me një total prej 57 pikësh. Në shifrat 40-45 pikë luhatet besimi te kolegët e punës, njerëz me bindje të ndryshme fetare dhe politike si dhe udhëheqësit fetarë, nivele që tregojnë përgjithësisht skepticizëm dhe besim të pakët. Kështu niveli i besimit ndaj kolegëve të punës vlerësohet me 41 pikë nga 100 të mundshme, njerëzit e feve të ndryshme në nivelin 43 pikë dhe ata me bindje të ndryshme politike në nivelin 40 pikë. Ndërkohë tek udhëheqësit fetarë duket sikur të rinjtë shfaqin një nivel besimi pak më të mirë në vlerën 45 pikë.

**B1.** Ju lutem imagjinoni një nivel me 10 shkallë, ku në shkallën e parë (1) do të vendosnit njerëzit të cilëve u besoni më pak dhe në të fundit (pra në të 10-tën) do të vendosnit njerëzit të cilëve u besoni më shumë. Në cilën shkallë do t'ju vendosnit njerëzit e mëposhtëm?



Niveli më i ulët i besimit të të rinjve është tek fqinjët e tyre me 33 nga 100 pikë të mundshme.

Rezultatet përkojnë me ato të studimit të para katër viteve me një ndryshim të lehtë në rritjen e besimit të udhëheqësit fetarë nga 38 në 45 pikë. Shifrat tregojnë një panoramë të përgjithshme të mungesës së besimit horizontal, pra besimit që kalon kufijtë e lidhjeve të natyrshme të familjes dhe gjakut.

Megjithë nivelet e ulëta të besimit ndaj fqinjëve sipas analizës numerike, në bisedat e tyre të rinjtë shprehen të vetëdijshëm për rëndësinë e të paturit të marrëdhënieve të mira me fqinjët. Kjo sipas tyre lidhet kryesisht me faktin se në rast nevoje, fqinjët janë të parët që mund të ofrojnë ndihmë. Nevoja për të krijuar një frymë bashkëjetese në komunitetet ku jetojnë, gjithashtu shihet si e rëndësishme nga të rinjtë.

***“Njerëzit e tu mund ti marrësh në telefon por janë goxha larg, nëse nuk të ndihmojnë ato që ke përreth atëherë është e kotë.”*** – shprehet një djalë nga zonat rurale të rrethit Tiranë duke pasqyruar një realitet kur familjet i kanë të afërmit në emigracion apo qytete të tjera dhe në rast nevoje duhet të mbështeten te fqinj

Problematika me fqinjët është krijuar nga lëvizjet masive të migracionit të brendshëm drejt qyteteve të mëdha.

***Kryesisht gjatë jetesës së tyre në shtëpi me qera të rinjtë kanë më shumë fërkime me fqinjët. Ja si shprehen dy prej tyre “Ne që kemi jetuar në qytete të vogla e ndjejmë shumë pjesën e marrëdhënies me fqinjët pasi atje kishim marrëdhënie të afërta ndërsa këtu në Tiranë është ndryshe. Unë kam shumë probleme me fqinjët, të zihet rruga etj gjëra absurde!”***

***“Shumë keq këtu në Tiranë [me fqinjët], diskutojnë për gjëra banale pa lidhje, ne diskutojmë vetëm për shkallën se gjë tjetër nuk na lidh me ta. Të ndalojnë të hapësh rroba në ballkon se i bën xhamin pis etj. Shumë keq.”***

## 3.2 Paragjykimet dhe diskriminimi

Ashtu sic është vënë re edhe katër vite më parë, paragjykimi më i fortë dhe më i hapur tek të rinjtë shqiptarë është homofobia. Të pyetur sesi do të ndiheshin nëse pranë tyre do të kishin fqinjë një familje të përbërë nga një çift homoseksual, shumica e të rinjve 55% thonë se kjo do ti bënte të ndiheshin keq ose shumë keq. Ndërsa 34% prej tyre thonë se do ishin indiferent ndaj kësaj gjëje nga ana tjetër 11 përqind thonë se do ndiheshin mirë ose shumë mirë. Në këtë drejtim të rinjtë meshkujt janë shumë më paragjykses sesa femrat. Ndërkohë që 45 përqind e meshkujve raporton se do të ndiheshin keq në një situatë të tillë, janë vetëm 26 përqind e femrave që pohojnë të njëjtin vlerësim. Në lidhje me këtë situatë vërehet se tek femrat mbizotëron ndjesia e indiferencës pasi 40 përqind të tyre shprehen se do të qëndronin indiferentë ndaj fqinjëve tëmundshëm homoseksualë.

Po ashtu ka dallime të mëdha ndaj kësaj situatë midis përgjigjeve të të rinjve që jetojnë në Tiranë me ato që jetojnë në qytetet e tjera. Në Tiranë ndjesia e pranimit apo indiferencës për këtë situatë është më e lartë në raport me atë të qyteteve dhe fshatrave të tjera ku duket se mbizotëron ndjesia e fortë negative ndaj personave homoseksualë.



## Përshkrime ekstreme dhe mite për komunitetin LGBT

Nivelit të lartë të homofobisë mes të rinjve shqiptarë u shtohen edhe keqinterpretimet e tyre. Gjatë bisedave ata përmendin disa mendime ekstreme dhe krejtësisht absurde lidhur me “rreziqet” e hamendësuara që do të paraqiste një çift i të njëjtit seks nëse do të jetonte afër tyre.

Të rinjtë e intervistuar shprehen se do e kishin problem praninë si fqinj të një çifti homoseksualësh për shkak të sjelljes e ndikimit që mund të kishin ata tek fëmijët e tyre, duke demonstruar një mungesë informimi dhe ndërgjegjësimit mbi këtë çështje.

Të rinj nga zonat rurale shprehen:

***“Në këtë rast [ku fqinjët janë një çift homoseksual] unë do ta kisha pak problem sepse domosdoshmërisht në qoftë se je fqinj me ata do të përballesh diku në rrugë, dhe ata janë, më falni për shprehjen, perversë.”***

Një i ri tjetër shprehet në mënyrë të paqartë kur pohon se ***“Tek unë nuk ka ndonjë ndikim të madh por... më shumë mund të ndikojë tek familja, tek të vegjëlit. Sot fëmijët kanë pyetje për çdo gjë dhe këto çifte i kanë të qarta fare mirë përgjigjet që mund ti kthejnë fëmijëve.”***

Në këtë rast nuk kuptohet qartë se cili do të ishte sipas tij ‘rreziku’ prania e tyre afër fëmijëve apo dhënia e informacionit ‘të gabuar’.

Është e qartë dhe e dukshme se të rinjtë flasin me këto shprehje si pasojë e mosinformimit dhe ndërgjegjësimit mbi individët LGBT, duke mbartur disa të pavërteta të skajshme në mendësinë e tyre përsa i përket këtij komuniteti.


Në një nivel më të ulët por ende të pranishme janë edhe paragjykimet mes të rinjve ndaj minoritetit rom. Nëse një familje rome do të ishte fqinjë e tyre 15 përqind të të rinjve pohojnë se do të ndiheshin keq ose shumë keq. Ndërkohë gjysma e të rinjve shprehen se janë indiferentë ndaj kësaj situatë ndërsa 36 përqind thonë se do ndiheshin mirë.

Po ashtu 15 përqind e të rinjve nuk do ta mirëprisnin ardhjen e një familjeje nga Ballkani si fqinjë të tyre. Por ky zhvillim do ti linte indiferentë një të tretën e të rinjve ndërkohë që mbi 50 përqind e tyre thonë se do ndiheshin mirë.

Reagimi i të rinjve ndaj familjeve nga krahina të ndryshme të vendit (Jug/Veri), pensionistëve apo studentëve nuk tregon ndonjë paragjykim duke qenë se është përgjithësisht pozitiv ose asnjanes.

Fqinjët më të mirëpritur që do ti lumturonin të rinjtë janë të huajt nga Europa Perëndimore ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë kategori mbi 70 përqind e të rinjve shprehen se do të ndiheshin mirë ose shumë mirë po ti kishin fqinjë ndërsa pjesa tjetër ose 30 përqind kanë një reagim indiferent ndaj një fakti të tillë.

**B2.** Si do të ndiheshit nëse në ndërtesën, pranë shtëpisë tuaj do të vinte të banonte secila nga këto familje?



Të pyetur për herë të parë këtë vit si do reagonin ndaj një familje fqinjë që është prakticante e devotshme e fesë dhe shumë besimtare mbi 50 përqind e të rinjve janë përgjigjur se do ta mirëprisnin atë, 38 përqind pohojnë se do të ndiheshin neutral ndërsa një pakicë e vogël prej 8 përqind deklarojnë se do të ndiheshin keq.


## Përjetimi i diskriminimit

Diskriminimi duket se nuk është një problem që shqetëson të rinjtë në jetën e tyre të përditshme. Kështu për të gjitha kategoritë që janë pyetur, pra nëse janë ndër të diskriminuar në bazë të karakteristikave të tyre të ndryshme si gjinia, origjina, pasuria, etniciteti, ata kanë raportuar nivele shumë të ulëta ose pothuajse të padukshme të këtij fenomeni.

Në shifra të vogla por gjithsesi interesante të rinjtë tregojnë për raste të rralla të diskriminimit si pasojë e bindjeve të tyre politike si dhe të statusit ekonomik. Kështu 15 përqind e të rinjve pohojnë se kanë qenë të diskriminuar në lidhje me bindjet politike por shumica e ka ndër të këtij diskriminim rrallë ose vetëm ndonjëherë ( 6 përqind secila).

Nga ana tjetër ndonëse 19 përqind e të rinjve kanë ndër të këtij diskriminim si pasojë e gjendjes së tyre ekonomike, shumica e këtij grupimi ose 8% e tyre e ka përjetuar rrallë atë ndërsa 7 përqind vetëm ndonjëherë.

**B3. Diskriminimi nga faktorët e ndryshim-Rinia Shqiptare 2014 N=[1200]**




Gjinia ka qenë baza e diskriminimit për afro 11 përqind të të rinjve dhe pak a shumë me një eksperiencë të ngjashme janë përballur për shkak të nivelit arsimor edhe një në dhjetë të rinj. Në të gjitha rastet prirjet e diskriminimit tregojnë shifra të ulëta.

Në ndryshim nga sondazhi i katër viteve më parë ku faktorët kryesorë të diskriminimit ishin origjina krahinore dhe prejardhja urbane/rurale, këtë vit duket se statusi ekonomik dhe përkatësia politike kanë fituar më lehtë terren si faktorë në bazë të së cilëve të rinjtë diskriminojnë të rinjtë.

### 3.3 Hierarkia e vlerave

Të pyetur se çfarë rëndësie i japin vlerave të ndryshme, të rinjtë shqiptarë në masë të madhe vlerësojnë dinjitetin vetjak. Mbi 40 përqind e tyre mendojnë se dinjiteti vetjak është vlera më e rëndësishme për ta. Si vlerën e parë më të rëndësishme atë e kanë zgjedhur 43 përqind të rinjve; ndërkohë 10 përqind dhe 7 përqind të tyre e kanë renditur atë në vend të dytë dhe të tretë. Pra në total për 60 përqind të të rinjve dinjiteti vetjak përfshihet në tre vlerat e tyre më të cmuara.

**B4. Cilat janë tre vlerat që çmoni më shumë nga këto?**



Femrat janë të prirura më shumë sesa meshkujt qe të zgjedhin dinjitetin vetjak si vlerën më të rëndësishme në listën e vlerave të përmendura. 47 përqind e tyre e cilësojnë dinjitetin si vlerën kryesore mbi të gjitha në krahasim me 37 përqind të meshkujve. Po ashtu besnikëria dhe korrektësia janë mjaft të rëndësishme për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve.

Një e treta e të rinjve të intervistuar e konsideron vlerën numër një besnikërin ndaj partnerit, miqve, punëdhënësit dhe në përgjithësi ndaj njerëzve me të cilët ndan jetën dhe po ashtu ajo përbën vlerën e dytë më të rëndësishme për 26 përqind të tyre. Një grup prej 6 përqind kanë thënë se besnikëria është vlera e tretë më e rëndësishme për ta.

Rreth 28 përqind e të rinjve e vlerësojnë korrektësinë si vlerën e tretë më të rëndësishme ndërkohë që grupe më të vogla të rinjsh e rendisin atë si vlerën e parë dhe të dytë.

Ndërkohë vlera të tjera me rëndësi për të rinjtë janë përgjegjësia dhe toleranca.

Përsa i përket tolerancës 9 përqind të të rinjve të intervistuar e konsiderojnë atë si vlerën e dytë më të rëndësishme ndërsa për 14 përqind të tyre ajo renditet në vend të tretë në hierarkinë e vlerave bazë. Lidhur me përgjegjësinë vërehet se janë 20 përqind e të rinjve që e cilësojnë atë si vlerën e parë ose të dytë më të rëndësishme dhe këtyre ju shtohet një përqindje e vogël e që e rendisin atë si vlerë të parë.

Vlerat e tjera duken se nuk përbëjnë shumë interes për të rinjtë dhe përqindja e atyre që i vlerëson ato mbetet e pakët. Kështu është vetëm një pakicë të rinjsh që kanë pohuar rëndësinë ndaj vlerave të tilla si pasurimi, kreativiteti dhe shpirti konkurrues. Këto lloj vlerash janë drejtpërdrejt të lidhura me faktorë që konsiderohen shumë të rëndësishme për të pasur sukses personal edhe sipas debateve të sotshme publike.

Nëse krahasojmë të dhënat e sondazhit të vitit 2014 me ato të vitit 2011 lidhur me renditjen e këtyre vlerave, në bazë të rëndësisë që u japin atyre të rinjtë e vendit, vërejmë se është ulur përqindja e të rinjve ndaj vlerësimit që ata kanë për vlera të caktuara. Psh nëse në sondazhin e parë dinjiteti vetjak ishte i zgjedhur si vlera numër një nga 62 përqind e të rinjve këtë vit atë e kishin përzgjedhur vetëm 43 përqind të tyre. Po ashtu ka një rënie të përqindjes së të rinjve që e rendisin tolerancën në vend të dytë në hierarkinë e vlerave të tyre më të rëndësishme teksa në vitin 2011 atë e kishin përzgjedhur 20 përqind e të rinjve dhe në vitin 2014 numri

i tyre është ulur në 9 përqind. Vendin e tolerancës si vlera e dytë më e rëndësishme për të rinjtë duket se tashmë e ka zënë besnikëria.


Gjithashtu edhe numri i të rinjve që përmendin statusin (prestigjin) social në shoqëri si vlerë pothuajse është përgjysmuar në krahasim me të dhënat e vitit 2011: katër vite më parë rreth 25 përqind e të rinjve e kishin renditur statusin social si vlerën e dytë apo të tretë më të rëndësishme ndërkohë që për vitin 2014 kjo shifër është vetëm 9 përqind.

Të njëjtin nivel ulje të përqindjes mes të rinjve vëmë re edhe kur është fjala për një vlerë të tillë si altruizmi, të cilën në vitin 2011 e rendisnin si vlerën e dytë dhe të tretë më të rëndësishme rreth 24 përqind e të rinjve ndërsa në vitin 2014 këtë e kanë bërë vetëm 14 përqind e tyre. Zgjedhja e të rinjve për tu përqëndruar në vlerat tradicionale përkundrejt atyre moderne është një nga aspektet më interesante të profilit të tyre dhe në pamje të parë duket në kundërshti me qasjen që ata kanë ndaj medias dhe globalizmit.

## Vullnetarizmi

Një ndër pesë të rinj në Shqipëri raporton se është angazhuar në aktivitete vullnetare gjatë këtij viti (2014), cka shënon një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2011 ku vetëm 16 përqind e të rinjve pohonin se kishin kontribuar vullnetarisht në mënyra të ndryshme.

**B5.** A jeni angazhuar në aktivitete vullnetare/ punë për të cilat nuk ka qenë e nevojshme të paguheni gjatë 12 muajve të fundit?



Aktivitetet më të zakonshme ku të rinjtë kanë kontribuar në mënyrë vullnetare janë ato që lidhen me pastrimin e mjediseve publike. Mbi 60 përqind e atyre të rinjve që deklarojnë se janë përfshirë në aktivitete vullnetare gjatë 2014 u përkasin këtyre të fundit. Ndërkohë rreth 14 përqind e të rinjve janë marrë me aktivitete vullnetare duke dhënë mësimë informatike falas, një fushë e re dhe me mundësi interesante për inkurajimin e vullnetarizmit tek të rinjtë. Nga ana tjetër një në dhjetë vullnetarë të rinj ka ndihmuar në gjelbërimin e mjediseve të ndryshme.



**B6.** Në cilat lloje të veprimtarive vullnetare nga veprimtaritë e poshtëshënuara jeni angazhuar gjatë 12 muajve të fundit?




Duket se me rritjen e moshës angazhimi vullnetar ulët: kështu nëse nga të rinjtë e grupmoshës më të vogël (16-17 vjeç) rezultojnë se janë angazhuar me aktivitete vullnetare rreth 29 përqind e tyre, tek të rinjtë e grupmoshës 18-22 vjeç kjo shifër zbritet në 22 përqind. Përqindja më e ulët vjen nga grupmosha 23 vjeç e sipër ku vetëm 14 përqind raportojnë se janë marrë me iniciativë vullnetarizmi. Përsa u përket të rinjve të shkollës së mesme (18-22) kjo prirje korrespondon pjesërisht me kërkesat në nivel shkolle ku u kërkohet të marrin pjesë në angazhime vullnetare. Me rritjen e moshës dhe kapërcimin e kësaj etape ku vullnetarizmi nuk shihet më si pjesë e programit mësimor aktivitetet vullnetare mes të rinjve janë më të pakta.

Arsyet e motivimit të të rinjve për tu përfshirë në aktivitete vullnetare janë të ndryshme, por ashtu sikundër në përgjigjet e dhëna në vitin 2011 mbizotëron dëshira për tu ndjerë aktivë në shoqëri. Kështu mbi 50 përqind e të rinjve pohojnë se janë motivuar pikërisht nga kjo dëshirë. Një arsye tjetër është ndjenja e përkushtimit ndaj të tjerëve. Nëse në vitin 2011 ishte rreth 18 përqind e të rinjve që deklarorin se ishin të shtyrë kah vullnetarizmi për shkak të kësaj ndjenje këtë vit ajo përbënte arsye për 23 përqind prej tyre, duke shënuar një rritje të lehtë. Ndërkohë një

përqindje shumë e vogël e të rinjve shprehin si arsye për vullnetarizmin e tyre traditën familjare apo dëshirën për të praktikuar aftësi dhe njohuri të ndryshme.


**B7. Cila është arsyeja kryesore që ju nxit të angazhoheni në veprimtari vullnetare?**



## Feja: Besimi dhe praktika


Kur janë pyetur se cilës fe i përkasin të rinjtë shqiptarë zgjedhin në masë dërrmuese të vetëidentifikohen me një nga besimet tradicionale fetare në Shqipëri. Kështu 76 përqind thonë se i përkasin fesë myslimane, 7 përqind fesë së krishterë ortodokse, 10 përqind asaj katolike si dhe 2 përqind thonë se janë bektashinjë. Vetëm 2 përqind thonë se nuk praktikojnë ndonjë fe të caktuar dhe 1.2 përqind janë ateistë.

### B8. Ciles fe i perkisni?



Megjithatë duket se përkatësia fetare ngelet më së shumti si mjet identifikimi sepse shumica e të rinjve të pyetur e praktikojnë fenë vetëm në raste festash fetare, pra vetëm disa ditë në vit. Rreth 61 përqind e të rinjve pohojnë se praktikojnë fenë në këtë mënyrë, të ndjekur nga 23 përqind që deklarojnë se nuk e praktikojnë asnjëherë fenë e tyre. Vetëm 11 përqind e të rinjve e praktikojnë fenë një ose dy herë në javë dhe një grup shumë i vogël prej 5 përqind janë praktikantë të përditshëm të fesë së tyre. Në total mbi 80 përqind e të rinjve në Shqipëri nuk janë praktikantë të fesë dhe më së shumti kujtohen për të në festat e mëdha përgjatë vitit.

## B8.1 Sa shpesh e praktikoni fene tuaj



Zërat e rinj konfirmojnë bashkë-ekzistencën dhe harmoninë tradicionale

Në një kohë kur bota rrëqethet nga shfaqjet ekstreme të radikalizmit dhe dhunës me bazë fetare në mediat globale, është një fakt ngushëllues që pjesa më e madhe e të rinjve të rinjtë në Shqipëri u qëndrojnë larg ndasive e konflikteve fetare. Këto janë disa prej zërave të tyre mbi këtë temë:

***“Edhe unë do të thosha që[harmonia fetare] është një gjë e mirë dhe e bukur që... e pranon tjetrin e beson tjetrin.”***

***“Gjëja e fundit që më intereson është feja, të paktën për mua, por ka edhe njerëz radikal që merren.”***


***“Për mua besimi fetar nuk është i rëndësishëm në një marrëdhënie me një shok apo shoqe...”***

***“Unë kam një rast të veçantë, mamin dhe babi janë të feve të ndryshme dhe të dy e respektojnë njëri-tjetrin, i festojmë të gjitha festat.”***

Sidoqoftë harmonia nuk mund të merret si një konstante e sigurt. Megjithëse në një numër të vogël, disa të rinj janë rekrutuar nga ekstremistë dhe janë përfshirë në konfliktet e rënda në Siri dhe Irak.

Po ashtu gjysma e të rinjve të pyetur (47 përqind) raportojnë se gjatë vitit 2014 kanë vizituar një vend ose ndërtesë të shenjtë që i përket një feje/kulti të ndryshme nga feja e tyre. Kjo është një praktikë e përhapur në Shqipëri. Ashtu si në vitin 2011 këtë lloj vizite janë femrat që e praktikojnë më shpesh. Gjatë vitit 2014 rreth 52 përqind e femrave të reja deklarojnë se kanë vizituar një vend të shenjtë të ndryshëm nga feja e tyre në krahasim me 43 përqind të meshkujve.

*B9. A ju ka ndodhur të frekuentoni vende të shenjta të një feje të ndryshme nga e juaja?*



---

## 4. Përfundime

Nga analiza e të dhënave të sondazhit vërehet se familja është një faktor i pazëvendësueshëm përse i përket besimit të plotë që ajo gëzon mes të rinjve në Shqipëri. Besimi te çdokush tjetër është i luhatshtëm. Në këtë drejtim nuk gëzojnë shumë besim as miqtë e as kolegët. Ndërkohë më keq duket gjendja e nivelit të besimi që kanë të rinjtë ndaj fqinjve, një komunitet me të cilin ndërveprohet kryesisht nga 'halli', atëherë kur duhen administruar çështje të përbashkëta. Të rinjtë shqiptarë duken me fat sepse e përjetojnë shumë rrallë diskriminimin. Gjithashtu ata rrëfejnë se nuk para kanë paragjykime, deri sa fillojnë të flasin për qëndrimet e tyre homofobe. Vlerat më të rëndësishme të të rinjve shqiptarë lidhen me karakterin personal si dinjiteti dhe besnikëria. Nga ana tjetër vlerat e ndërveprimit shoqëror si toleranca apo statusi në shoqëri janë në plan të dytë. Ndërsa vlerat e të pasurit më shumë, të lidhura me konkurrueshmërinë apo pasurimin duket se nuk janë pjesë e psikologjisë së të rinjve shqiptarë.

Fatmirësisht rinia shqiptare mbetet nën mbrojtjen e harmonisë fetare tradicionale në Shqipëri, ku qasja ndaj besimit tregon tolerancë dhe nuk ka shfaqje radikalizimi apo eskstremizmi. Të rinjtë e praktikojnë fenë zakonisht gjatë festave fetare dhe shpesh vizitojnë vende kulti që janë të ndryshme nga përkatësia e tyre fetare. Përballë fenomeneve globale të rritjes së konfliktit fetar, kjo është një dëshmi e forcës së bashkëjetesës fetare në shoqërinë shqiptare që gjithsesi nuk duhet marrë si e mirëqenë por duhet monitoruar dhe ruajtur me kujdes.

## 5. Rekomandime

- Edukimi për të drejtat e njeriut dhe inkurajimi i respektit për komunitete dhe individë të ndryshëm nga vetja është thelbësor për formimin e qytetarëve të lirë nga urrejtja dhe për parandalimin e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes apo krimeve të urrejtjes. Homofobia e lartë e treguar nga të rinjtë shqiptarë duhet të jetë në qendër të përpjekjeve shumëpalëshe për ti informuar dhe cliruar nga paragjykimet apo mitet e rrezikshme që bartin në lidhje me personat LGBT.
- Vullnetarizmi në rininë shqiptare, por dhe në shoqëri në përgjithësi, vijon të mbetet në nivele të ulëta , i përqëndruar kryesisht te pastrimi i ambienteve publike dhe i praktikuar nga moshat më të vogla. Aktivitetet vullnetare krijojnë ndjenjën e komunitetit, forcojnë vlera pozitive për shoqërinë dhe rrisin ndjenjën e përgjegjësisë tek të rriturit e ardhshëm. Ndaj vullnetarizmi duhet inkurajuar në vazhdimësi dhe përmes mënyrave të larmishme nga sektori i arsimit, shoqëria civile apo media.



## KAPITULLI II:

FAMILJA DHE LIDHJET  
SHOQËRORE

Përgatitur nga: **Geron Kamberi**



## 1. Hyrje

Shqipëri po përjeton vitin e 25 - të të tranzicionit të saj post-komunist që prej vitet 90. Brezi i sotëm të rinjve shqiptarë të moshës 16-25 vjeç ka lindur dhe është rritur përgjatë kësaj periudhe e cila vazhdon të shoqërohet nga një tranzicion i stërzgatur jo vetëm politik dhe ekonomik, por edhe social. Modelet, normat e stereotipet e ndryshme sociale që ishin trashëguar nga periudha e para viteve 90 tashmë ka vite që i janë nënshtruar ndryshimit të tyre ku për një pjesë spikat qëndrueshmëria dhe vazhdimësia ndërsa vlerat e tjera po i përshtaten kushteve të të reja social-ekonomike. Vlerat tradicionale të shoqërisë shqiptare si familja, marrëdhëniet me prindërit, martesat, rrethi shoqëror po përpiqen të rezistojnë por edhe të përshtaten ndaj fenomeneve të tjera duke filluar me lëvizjet e mëdha të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, fillimi i shtresëzimit social në bazë të të ardhurave dhe pasurisë. Të gjitha këto kanë krijuar për të rinjtë shqiptarë makro e mikro mjedise të ndryshme sociale ku ata po formojnë sistemin e tyre të vlerave në raport me familjen dhe shoqërinë. Këto ndryshime kanë prekur e vazhdojnë të shtohen edhe përgjatë zonave rurale ku zhvillimi i sistemit të transportit, emigracioni, rrjetet e komunikimit masiv kanë filluar të përshpejtojnë ndryshimin e mënyrës së të menduarit duke synuar tu afrohen zonave urbane.

Pavarësisht ndryshimeve të vullshme, familja shqiptare dhe pesha e saj në jetën dhe vendim-marrjen e të rinjve vazhdon të mbetet një faktor i rëndësishëm që përcakton veprimet e tyre në raport me mikromjedise të tjera sociale si shkolla, shoqëria. Në tërësinë e sistemit të vlerave që ata mbështesin është i dukshëm roli dhe ndikimi i saj përmes lidhjeve të dyanshme dhe të qëndrueshme që krijohen përgjatë viteve. Ndërkohë raportet e të rinjve me shoqërinë dhe rrethin miqësor që krijojnë janë pjesë e një sërë ndryshimesh që përkojnë me realitetin e ri të pas viteve 90. Larmia e formave dhe mënyrave për të jetuar në shoqërinë e bashkëmoshatarëve është shoqëruar me rënien e paragjyqimeve të ndryshme që kanë lehtësuar një komunikim më të shpeshtë mes të rinjve duke pasqyruar në këtë mënyrë edhe dinamikën e shoqërisë shqiptare.

## 2. Gjetjet kryesore

- 80% e të rinjve shqiptarë vazhdojnë ta konsiderojnë jetesën me familjen si një element të qëndrueshëm të stabilitetit të tyre emocional dhe ekonomik.
- Edhe të rinjtë nga shtresat e pasura synojnë të mos shkëputen nga familja por të jetojnë bashkë me të.
- Familja vazhdon të ketë ndikim në vendimmarrjen e tyre në vendimet më të rëndësishme duke përfshirë edhe zgjedhjen e partnerit.
- 61.5% e të rinjve pohojnë se babai vazhdon të konsiderohet si një nga personat më me ndikim brenda familjes nga të rinjtë ku pesha e tij është më e madhe në zonën e Veriut dhe në fshat.
- 80.1% e të rinjve e përfytyrojnë veten e tyre në të ardhmen të martuar dhe të lidhur në një familje.
- Përballë përparësive të bashkëjetesës dhe martesës të rinjtë shqiptarë shohin tek kjo e fundit si elementin më kryesor ndarjen e përgjegjësisë mes njëri - tjetrit.
- Ndër karakteristikat parësore të partnerit që do të zgjidhnin për martesë, personaliteti dhe interesat e përbashkëta janë ato që kanë rëndësi më të madhe, por një rol të madh po merr edhe ndikimi i pamjes së jashtme.
- Shoqëria dhe lidhjet miqësore krijohen dhe konsumohen mes të rinjve si në zonat urbane dhe rurale pavarësisht nivelit ekonomik mes tyre.

## 3. Analiza e detajuar e rezultateve

### 3.1 Marrëdhënia me prindërit dhe familjen

Të dhënat e studimit tregojnë se familja vazhdon të mbetet një strehë e sigurt për të rinjtë teksa 80% e tyre të intervistuar në nivel kombëtar pohojnë se jetojnë bashkë me ta. Përkundër të dhënave të vitit 2011 ku kjo shifër ishte 84% vërehet re një rënie e lehtë cka dëshmon për ecjen drejt një prirje që i bën të rinjtë më të pavarur nga familja. Përsa i përket këtij raporti mes të rinjve që jetojnë në fshat dhe atyre që jetojnë në qytet kjo ka mbetur e pandryshuar. Në këtë rast përqindjen më të madhe e zënë të rinjtë nga zonat rurale por ndërkohë në fshat vihet re një rënie e kësaj përqindje nga 88% në 82% krahasuar me të dhënat e vitit 2011. Kjo tregon se edhe të rinjtë e zonave rurale po krijojnë sjelljet e reja sociale në përputhje me ndryshimet social-ekonomike.


Në krahasim me vitin 2011 vazhdon të mbetet e dukshme dhe e pandryshuar, përqindja shtresave të pasura që jetojnë me prindërit ku 83% të rinjve të këtyre shtresave deklarojnë sërish se parapëlqejnë të jetojnë me prindërit

Ndonëse të rinjtë që jetojnë në Tiranë vazhdojnë të jenë përkrahës të qëndrimit me prindërit gjithësesi vërehet re një rënie e numrit të tyre në raport me vitin 2011 ku tashmë nga 79% vetëm 70% parapëlqejnë të jetojnë me prindërit, duke rritur kështu distancën me të rinjtë nga qytetet e tjera ku kjo përqindje është 87%. Kjo është dëshmi e sjelljeve dhe qëndrimeve të ndryshme sociale të të rinjve që jetojnë në një metropol ku modelet, modernizimi dhe ndryshimi i qasjeve tradicionale vazhdon me shpejtësi. Ndërkohë në raport me studimin e vitit 2011 vihet re një rritje e numrit të të rinjve me arsim të lartë nga 66% në 75%, të cilët parapëlqejnë të jetojnë me prindërit cka mund të jetë e lidhur me pasigurinë e krizën ekonomike


Në krahasim me vitin 2011 vihet re një rritje prej 8% e të rinjve që e shohin këtë si zgjidhjen me të përshtatshme, pra rreth 82% e tyre krahasuar me 74% të tyre para disa viteve. Në të njëjtën kohë ka një rritje me 13% edhe të numrit të rinjve nga shtresat e pasura përkundër atyre në vitin

2011 që e konsiderojnë këtë si zgjidhjen më të përshtatshme, pavarësisht mundësive ekonomike për të zgjedhur një jetë ku të jenë më të pavarur nga familja.

**C1. Aktualisht, me cilin jetoni? Jetoni vetëm, me prindërit, me partnerin/partneren apo me miq/të afërm?**



**C2. Cili nga keto pohimet ju pershtatet me mire**



***Të jetuarit me prindërit, mundësia më e mirë për të rinjtë shqiptarë***

Në bazë të dhënave në 2014, shumica e të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit, jetojnë me prindërit. Të dhënat e grupeve të diskutimit vërtetojnë rezultatet e sondazhit në terren sipas të cilit pothuajse 4 në 5 të rinj të intervistuar jetojnë aktualisht me prindërit. Mundësitë financiare, dhe vështirësitë e hasura gjatë kohës që disa prej tyre janë përpjekur të jetojnë vetëm (gatim, pastrim, etj.) janë arsyt kryesore përse shumë të rinj, vijnë ta shohin jetesën me prindërit si alternativën më të mirë të mundshme.


***“Nuk e di, përderisa nuk e kam provuar nuk mund të them, po ndoshta ka momente që mund të dëshiroj të jetoj me shoqërinë, por ama familja është ajo që të mbledh.” (Tiranë, Rural)***

***‘Edhe po të punosh këtu në Tiranë, rroga nuk të mjafton që ta perballosh jetesën vetëm. Më mirë është që të jetosh me prindërit dhe të japësh një pjesë të të ardhurave në familje duke plotësuar ata dhe veten’ (Tiranë, Urban)***

Nga ana tjetër vihet re se është thelluar diferenca mes të rinjve që shkojnë mirë me prindërit me afro 63.6% në vitin 2014 përkundër 48% e të rinjve të intervistuar në vitin 2011 duke rritur kështu shkallën e “konformizimit të brezave” brenda familjes. Ndërkohë që është ulur me 33% numri i të rinjve që pohojnë se marrëdhëniet me prindërit është e mirë megjithëse kanë pikëpamje të ndryshme krahasuar me 47% në vitin 2011. Kjo prirje lidhet me pamundësinë e daljes nga familja si rrjedhojë e vështirësive ekonomike dhe papunësisë duke i bërë të rinjtë më të ndërvuar nga familjet e tyre.


Ende vihet re dhe mbetet e pandryshuar një ndarje mes të rinjve të qytetit dhe fshatit lidhur me marrëdhëniet shumë të mira me prindërit pasi ata në fshat shfaqin një përqindje më të madhe me 64% përkundër 58% në qytet. Kjo dëshmon një autoritet prindëror më të fortë falë formave tradicionale e mentalitetit lidhur me to në zonat rurale. Rritja e moshës mes të rinjve dëshmon për një prirje ku sërish mbizotërojnë marrëdhëniet e mira me prindërit por ka përpjekje për të pasur qëndrimet e tyre sic e pohojnë 34.5% e të rinjve të moshës 18-22 përkundër 28.2% e të atyre 16-17 vjeç

## C3. Cili nga këto pohime përshkruan më mirë marrëdhënien që keni me prindërit tuaj?



Ndërkohë vërehet një rritje e numrit të rinjve që i kanë forcuar marrëdhëniet e mira me motrat e vëllezërit teksa 67,8% pohojnë se kanë marrëdhënie të mira me motrat e vëllezërit përkundër 56% e të rinjve të intervistuar në vitin 2011. Forcimi i lidhjeve familjare dhe solidaritetit familjar është dëshmi e gjetjes së një strehe mbrojtëse dhe mirëbesimit të ngushtë përballë shoqërisë që ndryshon me shpejtësi. Nga ana tjetër këto prirje e këto rreziqe kanë bërë që marrëdhëniet e mira mes motrave e vëllezërve të mos kenë dallim nga të rinjtë e qytetit e të fshatit sic pohoj në vitin 2011, por të jenë të njëjlojta. Në këtë mënyrë afro 66.2% e të rinjve në qytet dhe 68.2% e të rinjve në fshat deklarojnë se shkojnë shumë mirë me motrat e vëllezërit e tyre. Ndërkohë që në sondazhin e vitit 2011 vihej re një diferencë prej 12% mes këtyre grupe (50% vs 62% në fshat). Nga ana tjetër vihet re një ndarje mes të rinjve të shtresave të pasura dhe të varfërve në raport me marrëdhëniet mes motrave e vëllezërve. Përkundrajt 75.4% e të rinjve të varfër që pohojnë se kanë marrëdhënie të mira me motrat e vëllezërit, nga shtresat e pasura janë vetëm 65.8% , çka dëshmon prirjen drejt ndarjes së pasurisë. Megjithatë ky dallim është zvogëluar me afro 13% nëse e krahasojme me të dhënat e vitit 2011 ku përqindja e të rinjve të varfër që jepnin këtë përgjigje ishte 66.7% ndërsa atyre të pasur vetëm 47.9%.

**C4. Cili nga këto pohime, përshkruan më mirë marrëdhënien që keni me vëllezërit/motrat tuaja?**




Kjo prirje për një rrafshim social mes të rinjve shfaqet edhe te të rinjtë në universitet, që kanë pak a shumë një qëndrim të unifikuar me rreth 63.6% me ato me shkollë të mesme me 63.8%

Të dhënat e vitit 2014 përkundër atyre të vitit 2011 dëshmojnë se roli i babait mbetet i pandryshuar përsa i përket peshës që ai ka në vendim-marrjen e tyre pasi 61.5% e të rinjve në nivel kombëtar pohojnë se është babai ai që ka më shumë ndikim në vendim-marrjen e tyre. Kjo dëshmon se pesha e babait në familjen shqiptare mbetet e rëndësishme si rrjedhojë e përqëndrimit të fuqisë së tij social-ekonomike. Gjithnjë ndeshet një ndryshim i këtij raporti mes meshkujve e femrave ku vetëm 49.2% e femrave ndikohen nga babai në vendimmarrje përkundërt 73% të meshkujve. Por nga ana tjetër vazhdon të rritet pesha dhe roli i nënës për vajzat ku nga 22.3% e tyre në vitin 2011 tashmë janë rreth 29.9% që ndikohen nga nënat në vendimmarrje përkundërt 16.3% të djemve. Nëse shikojmë sesi pasqyrohet kjo prirje mes të rinjve në zonat urbane e rurale vihet re një rënie e lehtë e këtij ndikimi me 65.8% tek të rinjtë e zonave rurale përkundër 71.7% që ishte në vitin 2011. Nga ana tjetër përkundër rezultateve të vitit 2011, në vitin 2014 nuk vihet re ndonjë dallim lidhur me ndikimin e babait mes të rinjve që vijnë nga shtresa të ndryshme social-ekonomike. Nëse 64.2% e të rinjve nga shtresat e varfra pohojnë se babai

ka rol të ndjeshëm në vendim-marrjen e tyre po në të njëtin nivel janë edhe të rinjtë që vijnë nga familjet e pasura me 62.9%


*C5. Cili prej anëtarëve të familjes suaj, ka më shumë ndikim në vendime që merrni për çështje të rëndësishme?*



Përsa i përket procesit të vendimmarrjes, të rinjtë sërish vazhdojnë ti marrin vendimet e rëndësishme në bashkëpunim me prindërit. Ndërkohë mbetet i pandryshuar dallimi interesant mes të rinjve të Tiranës përkundër atyre të qyteteve të tjera. Të rinjtë nga Tirana duken disi më të pavarur teksa 67.5% e tyre shprehin mbështetjeje për ti marrë vendimet bashkë me prindërit përkundërt 76.2% të të rinjve nga qytetet e tjera. Të dhënat e studimit për vitin 2014 dëshmojnë një dallim mes kufijve ekstremë të arsimit përsa i përket marrjes së vendimeve në bashkëpunim me prindërit. Në këtë rast rritja e nivelit të arsimit i bën të rinjtë më bashkëpunues me prindërit për vendimarrjet e rëndësishme, ku psh 73.7% e të rinjve në universitet i marrin ato me prindërit, përkundërt 63.4% të atyre që janë me arsim 8-vjeçar




**C6. Si i merrni vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën tuaj?**



### 3.2 Martesa dhe lidhja në çift.

Vlera e martesës vazhdon të mbetet një tregues i pandryshueshëm për të rinjtë ku sërish të dhënat në nivel kombëtar për vitin 2014 tregojnë se 80.1% e të rinjve të intervistuar e shohin të ardhmen përmes martesës dhe krijimit të familjes. Kjo prirje e qëndrueshme dhe vlerësim të institucionit të martesës dhe familjes është një sjellje sociale që duket se ka rrënjë të forta në shoqërinë shqiptare. Në lidhje me dallimet gjinore karshi këtij institucioni social femrat vazhdojnë të jenë sërish mbështetëse të kësaj zgjidhje për jetën e tyre me 83.6% përkundër djemve me 76.7%. Në zonat rurale kjo mbështetje është më e fortë mes të rinjve që jetojnë atje krahasuar me të rinjtë e zonave urbane, duke patur parasysh sjelljet më tradicionale në këto zona vecanërisht ndaj një institucioni të tillë si martesa. Ndikimi që luan statusi ekonomik apo shtresëzimi pasuror mes të rinjve në lidhje me martesën ka ardhur duke u zvogëluar në krahasim me vitin 2011. Në këtë rast vihet re se të rinjtë nga të dy grupet nuk kanë shumë dallime në këtë mes, ku 79.2% e të rinjve ë pasur janë për martesë përkundër 82.9% të atyre nga shtresat e varfra.

## C7. Si e përfytyroni veten tuaj në të ardhmen?




Nga të dhënat e studimit është mjaft interesante të vihet re rënia e mbështetjes për martesën mes të rinjve të zonës veriore. Nëse në vitin 2011 për këtë shpreheshin 89.1% e këtyre të rinjve në vitin 2014 janë 71,8% ku faktorët e rënduar ekonomikë, pesha e përgjegjësisë dhe detyrimeve që ka lidhja e familjes në këtë zonë mund të jenë parë si pengesa prej tyre.

Përsa i përket përparësive të martesës vihet re se mbizotëron sërish pikëpamja mes të rinjve se ajo rrit përgjegjësistë mbi gjithsecilin por në vitin 2014 janë afro 45% e të rinjve që mendojnë në këtë mënyrë përkundër 54.9% të atyre që mendonin në të njëjtën mënyrë në vitin 2011. Në këtë rast është barazuar edhe raporti gjinor mes tyre ku vërehet se meshkujt dhe femrat mendojnë pak a shumë në të njëjtën mënyrë, pra 45.3% e meshkujve dhe 46.9% e femrave e mbështesin këtë pohim ndërkohë që në vitin 2011 numri i meshkujve që besonin në këtë parim të martesës ishte më i lartë me rreth 57.4%. Njëkohësisht vërehet se është rrafshuar ky dallim edhe mes të rinjve nga Tirana me ato që vinë nga zonat rurale ku përqëndindja e vlerësimit mbi përparësitë e martesës është e njëjtë, respektivisht me 46.5% për të rinjtë që banojnë në Tiranë me 46.6% të atyre që banojnë në zonat rurale. Ndërkohë përkundër vitit 2011 është thelluar dallimi mes të rinjve që vijnë nga shtresat e pasura me ato që u përkasin shtresave të varfra pasi të dhënat dëshmojnë se 54.2% e të rinjve nga familjet e pasura e shohin përparësinë e martesës

tek rritja e përgjegjësive të gjithsecilit ndërsa janë vetëm 42% e të rinjve nga shtresave e varfra që e mbështesin këtë.


Ky mund të jetë një tregues i strukturës së familjeve të shtreave të varfra nga vijnë këta të rinj, ku niveli i formimit social kulturor e arsimor të prindërve të tyre krijon modele e steriotipe ku përgjegjësitë i ka vetëm njëri prej anëtarëve.

**C8.** Cila mendoni se është përparësia KRYESORE e martesës në krahasim me bashkëjetesën?



Përkundrajt vlerësimeve të mësipërme për martesën si institucion tradicional për krijimin e familjes të rinjtë kanë vlerësimin e tyre edhe për format e reja të krijimit të lidhjeve në çift siç është bashkëjetesa. Në këtë kuadër mbetet e pandryshuar bindja mes të rinjve se përparësia e bashkëjetesës qëndron tek pavarësia e partnerëve ndaj njëri-tjetrit me rreth 39%. Këtë qëndrim e thekson edhe një element tjetër që ka rëndësi për të rinjtë sic është përparësia që të krijon bashkëjetesa për tu ndarë më lehtë nga partneri.

## C9. Cila mendoni se është përparësia KRYESORE e bashkëjetesës në krahasim me martesën?




Në vijim të opinioneve të tyre për institucionin social të martesës të rinjtë kanë edhe një sërë qëndrimesh që lidhen me ato elementë që e shoqërojnë atë që nga mendimet rreth moshës më të përshtatshme për martesë në të dy gjinitë, numrit të fëmijëve si edhe parapëlqimet ndaj karakteristikave që duhet të plotësojë partneri i tyre i ardhshëm

Në nivel kombëtar shumica e të rinjve të intervistuar vazhdojnë të parapëlqejnë moshën 24 vjeç, si më të përshtatshme për martesën e vajzave, çka dëshmon deri diku vijimësinë e traditës së martesës së tyre në moshë relativisht të re. Kjo moshë shihet si më e përshtatshme edhe nga vetë femrat e reja të intervistuar, të cilat japin sërish pak a shumë të njëjtën kufi moshe prej 25 vjeç për martesën e vajzave. Kjo prirje nuk ka ndonjë dallim të dukshëm edhe mes të rinjve nga Tirana apo zonat e tjera urbane dhe rurale. Madje kjo mesatare nuk ndryshon as për shkak të nivelit të të ardhurave pasi që nga të rinjtë me të ardhura të pakta e deri tek ata që konsiderohen të pasur vendosin si kufi moshe për martesë 24-25 vjeç. Kjo nuk ndryshon as nga diferencat e moshës, ndarjet gjeografike si edhe nga niveli i arsimimit.

Përsa i përket moshës më të përshtatshme për martesë të djemve, shumica e të rinjve të intervistuar kanë parapëlqyer si moshë mesatare atë 28 vjeç duke treguar sërish prirjen e përgjithshme drejt një moshe martesore më të vonshme për djemtë çka lidhet me pjekurinë e nevojshme për marrjen e përgjegjësiave dhe veçanërisht mundësinë për të garantuar mbarëvajtjen ekonomike të familjes nëpërmjet punës. Nuk vihen re dallime thelbësore për moshën e martesës për djemtë mes të rinjve të intervistuar të Tiranës, zonave të tjera urbane apo atyre që jetojnë në zonat rurale. Vetëm për të rinjtë që vinë nga shtresat e pasura ky kufi moshe rritet me në 1 vit, pra 29 cka dëshmon për prirje e tyre që të shijojnë për një kohë më të gjatë jetën e vetme nën kujdesin e prindërve të pasur. Ashtu sikurse tek të rinjtë e shtresave të varfra ky kufi zbret në moshën 27 vjeç si një tregues se ata duan ti dalin zot vetes më herët duke lehtësuar nënjëfarë mënyre prindërit e tyre. Ndërsa lidhur me ndarjen gjeografike mbizotëron i njëjti parapëlqim mes të rinjve që deklarojnë se mosha më e përshtatshme për martesën e djemve është mes kufijve 27-29 vjeç. Ndërkohë vihet re një prirje e lehtë për rritjen e kufirit të kësaj moshe mes të rinjve nga Tirana dhe veçanërisht atyre me nivel arsimimi universitar dhe pasuniversitar. Kjo shpjegohet me mënyrën sesi të rinjtë e këtyre zonave dhe grupeve sociale synojnë ta zgjasin moshën e martesës, qoftë për shkak të mentalitetit metropolitan apo edhe përmbushjes fillimisht të detyrimeve që lidhen me kualifikimin e tyre për të krijuar një familje me qëndrueshmëri më të madhe ekonomike


**C10. Mosha optimale për tu martuar**



Në rastin kur të rinjtë e intervistuar janë pyetur rreth numrit të fëmijëve që ata do të dëshironin të kishin në familjet e tyre, shumica e tyre janë përgjigjur se do të donin të kishin 2 fëmijë. Ndërkohë vihet re një rritje e parapëlqimit të meshkujve, ku shumica e tyre kërkojnë të kenë më shumë se 2 por ndërkohë tek femrat ky numër mbetet e njëjtë. Ky dallim mes tyre tregon ende një lloj mbizotërimi të psikologjisë mes të rinjve meshkuj për ta konsideruar numrin e fëmijëve si një lloj statusi social, ndërsa përgjigja e shumicës së femrave se nuk do të dëshironin më shumë se 2 fëmijë tregon se ata ende mbartin mbi vete pjesën më të madhe të lodhjes dhe përgjegjësisë ndaj mirërritjes së fëmijëve. Nga ana tjetër, vërehet një rritje e lehtë e kufirit të numrit të fëmijëve mes të rinjve me nivel të ndryshëm ekonomik ku ata më të pasurit parapëlqejnë të kenë deri në 3 fëmijë.

Në nivel kombëtar të gjithë të rinjtë e pyetur parapëlqejnë të kenë vetëm 1 vajzë dhe kjo prirje nuk ndryshon pavarësisht përkatësisë gjeografike, moshës apo nivelit të të ardhurave. Ndërkohë edhe për fëmijët e gjinisë mashkullore të gjithë të rinjtë e pyetur do të donin të kishin një djalë duke krijuar tashmë modelin e ekuilibrit gjinor në mesataren prej 2 fëmijësh që do të donin të kishin në familjet e tyre (1 djalë + 1 vajzë). Nga ana tjetër vihet re që të rinjtë meshkuj kanë dëshirë të kenë 2 djem dhe kjo vihet re edhe te të rinjtë nga veriu që flet ende për mbizotërimin e rolit dhe peshës së fëmijës mashkull në mentalitetin tradicional të shqiptarëve. Karakteristikat e partnerit të ardhshëm për martesë mes të rinjve përbëjnë një element mjaft të rëndësishëm që lidhet me personalitetin, përkatësinë fetare, gjeografike, gjendjen social-ekonomike, pamjen e jashtme, etj.

C 12.1/12.2/12.3 Sa fëmijë do të donit të kishit? Sa prej tyre do të donit të ishin vajza dhe sa djem?



**Lidhur me përkatësinë fetare të partnerit** 28.9% e të rinjve të pyetur e konsiderojnë të parëndësishme, ndërsa 29.2% krejtësisht të parëndësishme. Pra, për afro 58% të të rinjve të intervistuar përkatësia fetare e partnerit për tu lidhur në martesë nuk luan asnjë rol në përzgjedhjen e tyre. Përkundër të dhënave të vitit 2011 kur kjo prirje ishte afro 64% vërehet një ulje cka dëshmon se ndoshta jemi në fillimet e një faze kur ky element mund të marrë rëndësi në zgjedhjen e partnerit. Megjithatë të dhënat dëshmojnë se tek të rinjtë nga kryeqyteti ku element ngelet sërish i papërfillshëm ku paragjykime të tilla janë fare të parëndësishme përballë peshës të madhe që ushtron metropoli ndaj identitetit fetar të të rinjve. Kështu, nëse në zonat e tjera urbane dhe rurale kjo përqindje është respektivisht 20.2% dhe 27.0%, në Tiranë është 58%, madje me një rritje të dukshme përkundërt të dhënave të vitit 2011 kur kjo shifër tek të rinjtë e kryeqytetit ishte 40.5%.

**Përsa i përket gjendjes ekonomike të partnerit** rreth, 42% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar e vlerësojnë si faktor të rëndësishëm dhe shumë të rëndësishëm gjendjen ekonomike të partnerit të ardhshëm çka tregon rëndësinë e nivelit të të ardhurave ekonomike në krijimin e familjes. Përkundër të dhënave të vitit 2011 kur kjo përqindje ishte 40.9%

vihet re se ajo ka mbetur e pandryshuar ndërkohë që kriza e stërzgatur ekonomike e ka shtuar më tej peshën e këtij elementi. Vërejmë se kjo prirje thellohet tek femrat përkundrejt meshkujve pasi teksa përqindja e femrave që e konsiderojnë të rëndësishëm e pjesërisht të rëndësishëm gjendjen ekonomike të partnerit është 61%, tek meshkujt ajo është vetëm 52.3%. Ky është një tregues që dëshmon se tek femrat po merr gjithnjë e më shumë përparësi ky element që lidhet me nivelin e tyre të kërkesave në jetën familjare dhe sigurinë që kërkojnë për plotësimin e tyre. Ndërkohë vihet re një dallim në këtë përzgjedhje mes të rinjve nga Tirana dhe atyre nga qendrat e tjera urbane e veçanërisht të zonave rurale ku përqindja e të rinjve nga Tirana që e konsiderojnë atë të rëndësishëm e pjesërisht të rëndësishëm është 57.5% përkundrejt 61.9% në fshat çka nënkupton se presionin që ka filluar të ushtrojë edhe në fshat pesha e faktorit ekonomik në drejtim të përzgjedhjes së partnerit për të krijuar një familje

**Ndërkohë vazhdon të thellohet roli i familjes në këtë vendimmarrje duke përbërë një peshë të konsiderueshme.** Kështu 76% e të rinjve të pyetur e konsiderojnë të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme miratimin e familjes për të vendosur lidhjen me një partner dhe kjo shifër është me e lartë se në vitin 2011 kur këtë e pohonin 72.3% e të rinjve në nivel kombëtar. Kjo varësi kaq e lartë lidhet jo vetëm me respektin tradicional ndaj prindërve, por edhe me ndikimin e hershëm të familjes shqiptare në vendimet e rëndësishme të fëmijëve të tyre siç është lidhja në martesë. Kjo përqindje është më e madhë tej vajzat me afro 82.1% në raport me djemtë me afro 74.3%. Në këtë prirje vihet re një shkallë më e lartë tek të rinjtë e zonave të veriut me 80.5% përkundër të rinjve nga Tirana me afro 76.5%. Një përqindje më e ulët vërehet tek të rinjtë që vinë nga shtresat e pasura ku vetëm afro 68.7% e quajnë të rëndësishëm rolin e familjes në vendim-marrjen për martesë. Të rinjtë e kësaj shtrese kanë filluar të kenë një pavarësi më të madhe përballë kushteve ekonomike si rezultat i statusit social të familjeve të tyre.

Pavarësisht lirisë së marrëdhënieve mes tyre dhe çlirimit nga tabutë e seksit të dhënat tregojnë se 51.3% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar e konsiderojnë **virgjërinë** si të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme përkundrejt 14.3% të atyre që e konsiderojnë atë si më pak të rëndësishme apo 20.5% që konsiderojnë atë të parëndësishme në lidhjen martesore. Përkundër vitit 2011 kur kjo shifër ka qenë 45% vërehet



se ka një prirje për ta theksuar më shumë këtë tipar të sjelljes e normave tradicionale. Ajo çfarë vihet re është thellimi i dallimeve të mëtejshme mes meshkujve dhe femrave ku meshkujt zënë një përqindje më të madhe, afro 66.5% përkundrejt 34.5% të femrave. Madje në krahasim me vitin 2011 këto shifra janë rritur dukshëm tek djemtë nga 27.9% në 66.% ndërsa tek vajzat është rritur nga 14.4% në 34.5% çka sjelljet e lira në këtë fushë djemtë i shohin si 'kërcënim' të krenarisë tyre sociale në të ardhmen, ndërsa vajzat si një prirje për ta thelluar lirinë e sjelljeve të tyre para martesës.

**Në lidhje me personalitetin të rinjtë e kanë thelluar akoma shumë rëndësinën e tij të veçantë në zgjedhjen e partnerit.** Madje në nivel kombëtar 95.6% e të rinjve të intervistuar vlerësojnë se personaliteti është shumë i rëndësishëm në përzgjedhjen e kandidatit për martesë duke shënuar në një rritje të dukshme të saj në raport me vitin 2011 ku kjo përqindje ishte 60.9%. Rëndësia e personalitetit shihet si një garanci për të përballur sfidat e ndryshme social-ekonomike me të cilat mund të përballen në një shoqëri që ndryshon vazhdimisht e që mund të kapërcehen duke patur në krah një partner me personalitet të qëndrueshëm. Kjo rritje e rëndësisë së personalitetit, si faktor përcaktues në zgjedhjen e partnerit, ka zbehur dallimet përsa i përket femrave, meshkujve apo të rinjve nga zona të ndryshme gjeografike apo shtresa të ndryshme shoqërore. Unifikimi i këtij qëndrimi mund të konsiderohet një risi që meriton një analizë më të thelluar.


**"Kulti i bukurisë fizike"** vazhdon të luajë rolin e tij tek të rinjtë, **I shumëfishuar nga mediat e stereotipet e veta.** Në këtë mënyrë ai shfaq rëndësinë që merr pamja e jashtme në përzgjedhjen e partnerit. Kjo prirje vjen në rritje edhe në raport me të dhënat e vitit 2011 kur këtë e pohonin 68.1% e të rinjve ndërsa në vitin 2014 janë 75% e të rinjve të pyetur në nivel kombëtar që e konsiderojnë pamjen e jashtme si të rëndësishme e shumë të rëndësishme, përkundrejt 19.6% që e shohin atë si më pak të rëndësishme në raport me partnerin. Sërish ajo ndikon më shumë tek meshkujt sesa tek femrat. Në këtë rast risia qëndron tek fakti se edhe të rinjtë në fshat kanë filluar ti kushtojnë vëmendje këtij elementi. Madje në raport me të dhënat e vitit 2011 tashmë ky raport është përmbysur pasi në vitin 2014 janë 75.4% e të rinjve të fshatit që e konsiderojnë pamjen e jashtme të rëndësishme në zgjedhjen e partnerit përkundër 69.5% të rinjve nga kryeqyteti.

**Në lidhje me nivelin arsimor dhe ndikimin që ai ka në përzgjedhjen e partnerit nga ana e të rinjve,** të dhënat na tregojnë se ky kriter ka mbetur i pandryshuar në gjykimin e të rinjve. Ashtu si në vitin 2011 afro 76.4% e të rinjve vlerësojnë sërish atë si shumë të rëndësishëm. Në këtë rast dallimet gjinore janë bërë të barazvlefshme dhe 74.4% e djemve dhe 77.5% e vajzave e konsiderojnë atë një element të rëndësishëm në zgjedhjen e partnerit për martesë. Përkundrejt të dhënave të vitit 2011 vihet re një dallim dhe ndryshim tek rinjtë që banojnë në zonat rurale ku në vitin 2014 janë 82.5% e tyre e vlerësojnë nivelin arsimor të partnerit për martesë si të rëndësishëm e shumë të rëndësishëm. Madje nëpërmjet këtij vlerësimi ata kalojnë edhe të rinjtë nga kryeqyteti ku tashmë janë 74% e tyre e mbështesin këtë qëndrim.

**Nga ana tjetër ato që marrin përparësi mes të rinjve në lidhje me zgjedhjen e partnerit për martesë janë edhe interesat e përbashkëta.** Në nivel kombëtar, 79.4% e të rinjve të intervistuar i konsiderojnë të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme interesat e përbashkëta mes partnerëve. Kjo nënkupton se të rinjtë parapëlqejnë të kalojnë përmes një procesi lidhjeje për martesë ku interesat e përbashkëta janë parësore. Ndërsa në vitin 2011 ishin 84.1% e të rinjve në nivel kombëtar që e konsideronin këtë element të rëndësishëm, vihet re një rënie e lehtë e mbështetjes për këtë element duke shkuar drejt elementëve me praktikë. Ky raport tashmë anon më shumë nga femrat ku respektivisht 83.1% e tyre që e vlerësojnë me rëndësi këtë element përkundër 76.1% e djemve. Nga pikëpamja e dallimeve gjeografike vihet re sërish një ndryshim mes të rinjve nga zonat rurale ku tashmë është rritur në 82.8% përqindja e tyre që e vlerësojnë këtë faktor të rëndësishëm përkundër të rinjve nga Tirana me 74%.

Ashtu sikurse tregonin të dhënat e vitit 2011 edhe në vitin 2014 vazhdon **prirja e të rinjve për të hequr dorë nga paragjykimet që lidhen me prejardhjen krahinore**. Ato mund të konsiderohen të papërfillshme çka tregon edhe se lëvizjet e ndryshme demografike brenda vendit i kanë çliruar të rinjtë nga këto dallime që mund të kushtëzojnë përzgjedhjen e partnerit të tyre. Vetëm 7% e të rinjve në shkallë vendi e konsiderojnë prejardhjen gjeografike shumë të rëndësishme, ndërkohë që 54.9% e të rinjve e konsiderojnë atë të parëndësishme ose krejtësisht të parëndësishme.

**C13.** Nëse jeni, do të ishit beqar/e, sa të rëndësishëm i konsideroni secilin nga faktorët e mëposhtëm në momentin që do të vendosni për bashkëshortin/bashkëshorten tuaj?




### 3.3 Shoqëria dhe rrethi shoqëror.

Krijimi i lidhjeve miqësore me bashkëmoshatarë të tyre përbën një ndër elementët më të spikatur të të rinjve të sotëm, të cilët përveç shkollës kanë edhe një sërë mjedisesh të tjera sociale ku konsolidojnë lidhjet e tyre shoqërore. Nga ana tjetër, në këtë tërësi marrëdhëniesh dhe lidhjesh ata krijojnë jo vetëm idetë dhe vlerësimin mbi natyrën e tyre, por edhe modelet e sjelljes sociale në të gjithë ato ambiente ku konsumohen këto lidhje të tilla si shkolla, klubi, palestra, etj.


Në vijim të këtyre lidhjeve të krijuara, vërejmë se kjo prirje vazhdon të rritet mes të rinjve dhe tashmë 99.08% e të rinjve të intervistuar në rang vendi kanë pohuar se janë pjesë e **një grupi të caktuar miqsh** ku të gjithë e njohin njëri - tjetrin dhe dalin me njëri tjetrin. Kjo tregon për forcën dhe peshën e madhe që kanë lidhjet miqësore apo shoqërore mes të rinjve dhe natyrën sesi ato materializohen në praktikë. Në krahasim me vitin 2011 vërejmë se tashmë janë zhdukur edhe dallimet gjinore pasi edhe femrat (99.7%) dhe meshkujt(99.8%) pohojnë në të njëjtin nivel që janë pjesë e një grupi të caktuar miqsh. Rrafshimi i këtyre dallimeve përta i përket rrethit të miqve që ka cdo grup të rinjsh ka përfshirë edhe të rinjtë që vijnë nga shtresat e varfra e të pasura pasi të dy grupet kanë të njëjtën përqindje (99.6%) përta i përket pohimit që janë pjesë e një grupi miqsh

**C14.** Duke ndryshuar pak temën, a jeni pjesë e një grupi të caktuar miqsh ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin dhe dilni shpesh bashkë?

Anëtar i një grupi shoqëror- Rinia Shqiptare 2011 N=[1200]




Anëtar i një grupi shoqëror- Rinia Shqiptare 2014 N=[1200]



Ky zgjerim i miqësisë mes të rinjve shprehet edhe **nivelin e kënaqësisë që kanë brenda rrethit të tyre shoqëror** pasi 90.9% e të rinjve të intervistuar shprehen se janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur me rrethin shoqëror dhe shoqërinë e tyre. Në këtë rast, përqindja është pothuajse e njëjtë si për djemtë, ashtu edhe për vajzat që dëshmon se përzgjedhja e shoqërisë nuk është e rastësishme mes të rinjve. Ndërkohë në raport me Tiranën dhe zonat tjera urbane dhe rurale dallimet mes të rinjve janë zbehur dhe përqindjet për shkallën e kënaqësisë që ndejme brenda rrethit të tyre shoqëror janë pak a shumë në masën 90%.

Përsa kohë shoqëria dhe miqësia mes të rinjve nënkupton dhe modele të caktuara të sjelljes sociale, konflikti verbal apo fizik në rrethana të caktuara mbetet një element mjaft i rëndësishëm për të përcaktuar sjelljet e tyre në raport me mjedise të ndryshme ku bashkëjetojnë me moshatarët

C15. Në përgjithësi, sa i/e kënaqur jeni me rrethin tuaj shoqëror/ shoqërinë tuaj?



Në lidhje me ambientet e banimit ku jetojnë përditë të dhënat tregojnë se në nivel kombëtar, **86.4% e të rinjve të intervistuar pohojnë se nuk janë konfliktuar ndonjëherë në lagje** me të rinj të tjerë. Në këtë rast nuk vihen re dallime mes të rinjve që vijnë nga prejardhje të ndryshme social-kulturore apo rajonale.


Edhe mjediset e tjera të argëtimit si pub-et, diskot apo klubet nuk duket se përbëjnë një ambient ku të rinjtë synojnë të shfaqin forcën fizike përmes konfliktit me të tjerët përkundrejt një perceptimi të përgjithshëm nga ana e opinionit publik. Nga të dhënat e të rinjve të intervistuar 92.4% e tyre në nivel kombëtar kanë pohuar se nuk janë konfliktuar me të rinj të tjerë në pube, disko apo klube. Edhe në rastet kur të rinjtë janë përgjigjur se janë përfshirë në konflikte të tilla dallojmë se të rinjtë nga zonat e tjera urbane dhe rurale e kanë ulur përqindjen e përfshirjes në to në raport me vitin 2011 nga 14.3% dhe 9.2% ashtu sikurse ka ndodhur edhe me të rinjtë nga Tirana përqindja e të cilëve nga 8.9% ka rënë në 4.5%

Ndërsa në ambientet sportive si palestrat apo fushat e futbollit vazhdon të dëshmohet prej të rinjve një frymë solidariteti e miqësie ku 92.5% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar pohojnë se nuk janë përfshirë në konflikt në këto ambiente. Për shkak të frymës së grupit dhe pjesëmarrjes që ato ofrojnë i pakësojnë në mënyrë të dukshme mundësitë që të rinjtë të përfshihen në konflikt. Nga ana tjetër, kjo përqindje është e njëjtë pavarësisht nivelit ekonomik apo përkatësisë gjeografike të të rinjve të intervistuar. Lidhur me shkollën që është një mikromjedis shumë i rëndësishëm social, 85.5% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar janë përgjigjur se nuk kanë patur konflikte në shkollë, përkundër 76.9% që kanë pohuar të njëjtën gjë në vitin 2011. Megjithëse 13.5% deklarojnë se janë përfshirë në konflikte në shkollë, kjo është një përqindje më e ulët se në vitin 2011 me 22.8% por sërish duket se në këto konflikte mbizotërojnë të rinjtë nga familjet e pasura me 18% e ata të moshës 16-17 vjeç me 21.1%. Ky është një tregues se dhuna në shkollë mbetet ende një problem

Megjithëse Shqipëria ka një luftë të fortë politike, politika vazhdon të mos jetë një motiv që të rinjtë të konfliktohen fizikisht mes tyre për arsye të këtyre pikëpamjeve. Kështu 97.3% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar janë përgjigjur se nuk janë konfliktuar me të rinj me përkatësi të ndryshme politike. Kjo nënkupton mungesën e pranisë së debateve të ashpra politike mes të rinjve si edhe pranimin më të natyrshëm të bindjeve politike të njëri-tjetrit në rrethin shoqëror apo grupin e miqve. Në tërësi kjo përqindje është e njëjtë pavarësisht nivelit ekonomik apo shpërndarjes gjeografike

Gjithashtu të dhënat tregojnë sërish mungesën e konfliktit dhe përplasjes së të rinjve me policinë në demonstrata apo tubime të ndryshme. Rreth 96.3% e tyre deklarojnë se nuk janë konfliktuar me policinë nëpër demonstrata. Kjo përqindje është e njëjtë si në Tiranë ashtu edhe në zona të tjera urbane. Përveç një ndërgjegjësimi mbi pasojat e dhunës në lëvizjet politike, kjo prirje e të rinjve për të unifikuar qëndrimet e tyre karshi këtij fenomeni nënkupton një vetëdije më të madhe për rolin e lëvizjeve paqësore në politikë.

**C16.** Gjatë vitit të kaluar a ju ka ndodhur të përfshiheni në konflikte të dhunshme sipas situatave të mëposhtme?





## 4. Përfundime

Nga përfundimet e këtij vëzhgimi vihet re se lidhur me aspektet e familjes dhe të rrethit shoqëror të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të pasqyrojnë përmes vlerësimeve ato ndryshime që kanë ndodhur në shoqërinë shqiptare gjatë këtij çerekshekulli të tranzicionit. Të rinjtë e përzgjedhur për tu intervistuar i përkasin grupmoshës 16-27 vjeç e cila përbën atë pjesë të shoqërisë që është rritur tërësisht dhe i ka formuar vlerësimet e saj në raport me elementë të tillë si familja, shoqëria, martesja, konflikti përgjatë gjithë periudhës të stërzgatur të tranzicionit politiko - ekonomik. Nga te dhenat vërejmë serish se roli i familjes si një mjedis social i rëndësishëm mbetet ende i fortë dhe ndikimi i saj në vendimmarrjen e të rinjve është mjaft i dukshëm. Përballja e të rinjve me koncepte të reja të marrëdhënies në çift si bashkëjetesa nuk e ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore parapëlqimin e tyre ndaj formës tradicionale të martesës e cila mbetet mbizotëruese mes tyre. Nga ana tjetër, ndryshimet e vazhdueshme social-ekonomike dhe niveli i teknologjive të informacionit e ka zvogëluar së tepërmi dallimin mes të rinjve të zonave urbane dhe rurale lidhur me qëndrimin e tyre ndaj çështjeve të tilla si virgjëria, martesja, bashkëjetesa apo numri i fëmijëve në një familje të ardhshme. Marrëdhëniet shoqërore mes të rinjve kanë pësuar një shndërrim të dukshëm për shkak se është shtuar numri i mjediseve sociale jashtë shkollës ku ata mblidhen dhe forcojnë shoqërinë mes tyre të tilla si klubet, bingot, restorantet, pubet, diskot apo palestra. Megjithëse niveli i përfshirjes së të rinjve në konflikte apo akte dhune në këto mjedise është i ulët, përkundrajt këtij fakti vërejmë se të rinjtë pohojnë se shkolla është një hapësirë ku ata janë ndeshur më shumë me fenomene të tilla. Si konkluzion përfundimtar mund të themi se raporti i të rinjve shqiptarë ndaj familjes, lidhjeve shoqërore dhe elementëve të veçantë të sipërmendur, përbën një dëshmi të gjithë atyre faktorëve socialë, ekonomikë e kulturorë që kanë ndikuar gjatë këtyre 20 viteve për të formësuar këto qëndrime

## 5. Rekomandime

- Duhet të ndërmarren iniciativa konkrete lidhur me ndërgjegjësimin e të rinjve për t'u larguar dhunës në cdo ambient dhe veçanërisht në shkolla.
- Mjedise të tilla publike si fushat e sportit, bibliotekat, ambientet e hapura për vrapim duhet të jenë më të pranishme për shkak se përbëjnë mjedise sociale që pakësojnë nivelin e dhunës mes të rinjve dhe forcojnë në mënyrë më të qëndrueshme lidhjet shoqërore mes tyre
- Programet shkollore dhe fushatat e veçanta ndërgjegjësuese duhet të ruajnë dhe të forcojnë pikëpamjen e qëndrueshme mes të rinjve për rolin dhe vlerat e familjes dhe domosdoshmërinë e saj si një strukturë e rëndësishme për mbarëvajtjen e kohezionit social.
- Arsimi përbën një ndër fushat kryesore të aktivitetit të rinjve dhe është një prej treguesve thelbësor të politikave publike rinore. Cilësia e arsimit, përzgjedhja e universitetit, raporti i të rinjve me arsimin e lartë dhe profesional, janë disa nga pyetjet që shqetësojnë vazhdimisht komunitetet rinore. Nga ana tjetër lidhja e ngushtë e shkollës me punësimin e të rinjve vazhdon të mbetet një sfidë e tranzicionit shqiptar. Tregu i punës dhe dijes në vend duket sikur nuk përputhet me njëri-tjetrin dhe të rinjtë vazhdojnë të përballen me papunësi të larta që shpesh justifikojnë edhe me mungesën e një sistemi meritokratik të punësimit. Modeli ekonomik shqiptar i deritanishëm nuk po arrin të prodhojë punësim afatgjatë dhe të qëndrueshëm e për këtë arsye të rinjtë kanë një qasje drejt punëve e profesioneve të sigurta.





# KAPITULLI III:



ARSIMI  
&  
PUNËSIMI

Përgatitur nga: Alba Çela & Geron Kamberi

## 1. Hyrje

Arsimi përbën një ndër fushat kryesore të aktivitetit të rinjve dhe është një prej treguesve thelbësor të politikave publike rinore. Cilësia e arsimit, përzgjedhja e universitetit, raporti i të rinjve me arsimin e lartë dhe profesional, janë disa nga pyetjet që shqetësojnë vazhdimisht komunitetet rinore. Nga ana tjetër lidhja e ngushtë e shkollës me punësimin e të rinjve vazhdon të mbetet një sfidë e tranzicionit shqiptar. Tregu i punës dhe dijes në vend duket sikur nuk përputhet me njëri-tjetrin dhe të rinjtë vazhdojnë të përballen me papunësi të larta që shpesh justifikojnë edhe me mungesën e një sistemi meritokratik të punësimit. Modeli ekonomik shqiptar i deritanishëm nuk po arrin të prodhojë punësim afatgjatë dhe të qëndrueshëm e për këtë arsye të rinjtë kanë një qasje drejt punëve e profesioneve të sigurta.

## 2. Gjetjet kryesore

- Të rinjtë shqiptarë ende e shohin arsimin e lartë si një mundësi për të rritur aftësitë e tyre megjithëse nivelin e lartë të papunësisë mes të rinjve të diplomuar
- Rreth 58.6% e të rinjve shprehen të pakënaqur me cilësinë e arsimit në Shqipëri
- Vetëm 17 përqind e të rinjve janë përfshirë në një stazh ose periudhe praktike pune.
- Shumica e të rinjve shqiptarë mbeten optimistë për gjetjen e një vendi pune pas mbarimit të shkollës, megjithëse pranojnë se kjo do të ndodhë pas njëfarë kohe dhe jo menjëherë.
- Sipas të dhënave të vitit 2014 rreth 22 përqind e të rinjve shqiptarë pohojnë se janë të punësuar (me kohë të plotë ose të pjesshme) në krahasim me 35 përqind që raportonin se ishin të punësuar në 2011.
- Shumica e të rinjve, mbi 40 përqind, nuk janë të punësuar në profesionin e tyre. Ata që punojnë në fushën e profesionit të tyre janë në masën 30 përqind.
- Gjysma e të rinjve shqiptarë parapëlqen të punësohet në administratën publike ndërsa një e treta në sektorin privat.
- Të rinjtë kanë dëshira nga më të ndryshmet për profesionet e tyre të ardhshme por vazhdojnë të pëlqejnë ato tradicionale si mësues, ekonomist, mjek dhe arkitekt/inxhinier.
- Përsa i përket punësimit, të rinjtë rendisin si faktorin më të rëndësishëm njohjet dhe miqtë e ndryshëm, të ndjekur më pas nga aftësitë profesionale, arsimin dhe lidhjet politike. Ndërkohë ata vlerësojnë fatin ose rastësinë si faktorin më pak të rëndësishëm.

## 3. Analiza e detajuar e rezultateve

### 3.1 Arsimi – rëndësia dhe preferencat

Të dhënat tregojnë se në nivel kombëtar, se 56.4% e të rinjve të intervistuar ishin duke vazhduar studimet, nga të cilët 27.5% në shkollë të mesme, 23.9% në universitet dhe 4.8% master/doktoraturë. Ndër të rinjtë e intervistuar në grupmoshën 16-17 vjeç, 87.6 përqind ndjekin shkollën e mesme, ndërsa në grupmoshën 18-22 vjeç afro 38.6 përqind ndjekin shkollën e lartë. Përkundër të dhënave të vitit 2011 vihet re një rënie me 10% e numrit të të rinjve që ndjekin shkollën e lartë

Nga ana tjetër vazhdon prirja ku femrat rezultojnë të përbëjnë shumicën në ndjekjen e arsimit të lartë me 26.5%, ndërsa meshkujt 21.5


Bie në sy fakti që përqindja mbizotëruese e femrave në arsim dyfishohet me rritjen e nivelit të studimeve. Në këtë kuadër për studimet e nivelit master dhe doktoraturë rezultuan të studionin 6.7% e femrave përkundëjt 2.9% që janë meshkuj.

Nëndarja e më të varfërve vazhdon të ketë numrin më të lartë të atyre që nuk marrin pjesë në arsim me 44.9 përqind, por ka një rënie të lehtë përkundër vitit 2011 kur kjo shifër ishte 51.9%.


Arsimi i lartë mbetet një qëllim i rëndësishëm për tu arritur nga të rinjtë shqiptarë. 54.8% e tyre shprehin se kanë vazhduar ose do të vazhdojnë studimet e larta. Në këtë kuadër vërejmë një dallim me vitin 2011 kur përqindja e të rinjve që shpreheshin në këtë mënyrë ishte 77.9%. Sic duket për këtë ka ndikuar politikat e qeverisë ndaj universiteteve private e nxitjes së arsimit profesional.

Megjithatë numri i të rinjve që ndjekin arsimin profesional mbetet i ulët. Nga 1200 të rinj të intervistuar në nivel kombëtar rreth 71% e e tyre nuk ndjekin arsim profesional por drejtime të tjera të arsimit të mesëm. Ndërkohë të rinjtë janë të vetëdijshëm se arsimi profesional është një mundësi më e mirë për punësim. Afro 77.1% e tyre deklarojnë se arsyet që do ti shtynin të zgjidhnin arsimin profesional kishin të bëjnë me shanset për punësim.

E4. A keni vazhduar/ndërmend të vazhdoni shkollën profesionale/ kurset e formimit profesional?



E5. Arsytet e vazhimit të arsimit profesional?





Dallimet gjinore pasqyrojnë faktin që femrat rezultojnë më të prirura për të vazhduar arsimin e lartë përkundrejt meshkujve teksa 57.7% e tyre i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes për të ndjekur universitetin në raport me 52% të gjinisë tjetër.


Përkundër të dhënave të vitit 2011 tashmë vihet re se dëshira për të vazhduar studimet e larta është më e madhe në qytetet e tjera sesa në Tiranë. Kështu, 45.7% e të rinjve që vazhdojnë/duan të vazhdojnë studimet e larta jetojnë në Tiranë, ndërsa 56.4% në zonat e tjera urbane dhe 53.6% në zonat rurale. Rënia e këtij interesi mund të jetë ndikuar nga ndryshimet që po ndodhin në arsimin e lartë dhe papunësinë e lartë mes 'të diplomuarve'

Nëngrupi i më të pasurve ka ndjekur ose dëshiron në masë të madhe të ndjekë arsimin e lartë, me rreth 69.8 përqind ose 15.7% me shumë se mesatarja kombëtare. Në nëngrupin më të varfër rreth

41.9 përqind kanë ndjekur ose dëshirojnë të ndjekin arsimin e lartë, çka përbën një grup që është 13.4 përqind më i vogël se mesatarja kombëtare.

Nga ana tjetër rreth 40% e të rinjve të intervistuar pohojnë se nuk mund ta ndjekin arsimin e lartë për shkak të mundësive financiare të kufizuara. Kjo është një dëshmi se arsimi i lartë çënohet si një e drejtë për të rinjtë e varfër për shkak të shtrëngesave ekonomike.

## E3. Arsytet për mos vazhdimin e shkollës së lartë- Rinia Shqiptare 2014




Një rezultat interesant dhe krejt i kundërt nga të dhënat e vitit 2011 vërehet nga përgjigjet e të rinjve në vitin 2014. Të pyetur se cila është arsyeja që ndjekin ose dëshirojnë të ndjekin arsimin e lartë, rreth 65% e tyre tashmë pohojnë se e bëjnë këtë për të plotësuar një dëshirë të prindërve. Ky kapërcim i përqindjeve të kësaj përgjigjeje nga 9.9 përqind (2011) në 65 përqind (2014) është dëshmi e një luhatje të madhe të arsyeve të motivimit për të ndjekur universitetin, Megjithatë 30 përqind e të rinjve përgjigjen se e bëjnë këtë për të marrë një diplomë që do t'ju rrisë mundësitë e punësimit.

Një zgjedhje e tillë vërehet më e shpeshtë mes të rinjve nga zonat rurale se ato urbane, por një gjetje interesante është se të rinjtë nga Tirana, do të preferonin më shumë arsimin profesional, sesa të rinjtë nga zonat e tjera urbane të vendit.

Zgjedhja e degës së studimit në arsimin e lartë është një ndër vendimet më të rëndësishme, që përcakton të ardhmen e një të riu. Ky vendim përmbledh tre faktorë të mundshëm, së pari dëshirën për të ndjekur një karrierë të caktuar, së dyti përfytyrimin mbi mundësitë që ofron një degë

studimi për punësim apo burim të ardhurash, dhe së fundmi hapësira për të fituar të drejtën për arsim të lartë. Pjesa më e madhe, rreth 67.6 përqind e të anketuarve përgjigjen se kanë zgjedhur ose do të zgjedhin degën që dëshirojnë, ndërsa 18.1 përqind atë degë që besojnë se do tu sigurojë më shumë të ardhura, pavarësisht se nuk është pikërisht ajo që do të dëshironin. Ndërkohë, 9.8 përqind pohojnë se kanë zgjedhur degën ku kishin më shumë mundësi për të fituar të drejtën e studimit

**E6.** Cila nga alternativat e mëposhtme në lidhje me zgjedhjen tuaj për shkollën e lartë ju përshtatet më shumë?




Nga të dhënat shohim se të rinjtë nga Tirana vazhdojnë të shfaqin një prirje paksa më pragmatike se të rinjtë nga zonat e tjera urbane apo ato rurale lidhur me përzgjedhjen e degës së studimit. Nga të dhënat vërejmë se vetëm 55.1 përqind prej tyre zgjedhin degën e preferuar, çka përbën rreth 12.5 përqind më pak se mesatarja kombëtare, ndërkohë që 29.7 përqind prej tyre, apo rreth 6.7 përqind më shumë se mesatarja, zgjedhin degën që besojnë se do tu ofrojë më shumë të ardhura.

Lidhur me kohën e studimit vërejmë se të rinjtë shqiptarë shpenzojnë mesatarisht 2 orë e 43 minuta në ditë për të mësuar. Në përgjithësi, 43.5 përqind e të anketuarve shpenzojnë më pak se dy orë në ditë për të studiuar, 24.1 përqind rreth 2-3 orë në ditë, ndërsa ata që shpenzojnë më

shumë se 3 orë në ditë përbëjnë 14.1 përqind të të rinjve. Në krahasim me të dhënat e vitit 2011 vihet re një ulje graduale të atyre të rinjve që studiojnë më shumë se 3 orë.

Të dhënat tregojnë një dallim të madh përsa i përket kohës së shpenzuar për studim mes vajzave dhe djemve. Shumica e djemve, rreth 62.5 përqind shpenzojnë më pak se dy orë për të mësuar, madje rreth 35 përqind e tyre edhe më pak se një orë. Ndërkohë që vetëm 24.4 përqind e femrave shpenzojnë më pak se dy orë për tu përgatitur për shkollë, numri i tyre rritet ndjeshëm dhe e tejkalon atë të djemve që shpenzojnë mesatarisht 2-3 orë në ditë për mësim. Gati një e treta e vajzave përfshihen në grupin e atyre të rinjve që shpenzojnë mesatarisht 2-3 orë në ditë për mësim përkundrejt një të pestës së meshkujve. Dallimi mes djemve dhe vajzave bëhet më i thellë ndër ata që shpenzojnë më shumë se 3 orë në ditë, prej të cilëve meshkujt përbëjnë vetëm 15.7 përqind ndërsa femrat 42.7 përqind.


**E12.** Mesatarisht sa orë në ditë shpenzoni duke studiuar?



## 3.2 Vlerësimi mbi sistemin arsimor

Lidhur me rezultatet e arritura në mësimet sërish mbizotëron niveli i pandryshuar prej 48.1 përqind e të rinjve që i përkasin nivelit mesatar, me shumicën e notave 7 dhe 8. Nga ana tjetër, 16.2 përqind e tyre i përkasin nivelit të lartë me shumicën e notave 9-10 dhe 17.6 përqind nivelit të ulët me shumicën e notave më pak se 6. Mes të intervistuarve me shumicën e notave 9 dhe 10 vërehet një dallim mjaft i thellë, ku femrat përbëjnë 24.7 përqind të këtij grupimi përkundrejt meshkujve që përfaqësojnë 7.7 përqind të të rinjve me këto rezultate


E10. Cila ka qenë mesatarja e rezultateve tuaja në shkollë vitin e kaluar?



Përsa i përket korrupsionit në arsim, nëpërmjet “pagesës për note” apo “blerjes së provimeve” në universitete, të rinjtë kanë një ndjesi të forte për praninë e tij çka vërtetohet edhe nga të dhënat e anketës. Të pyetur rreth fenomenit të blerjes së notave dhe provimeve, 45.7 përqind e të përgjigjurve shprehën se ato blihen shpesh; 29.1 përqind shprehën se ai ndodh me raste, 8.8 përqind se ato blihen rrallë dhe vetëm 5.5 përqind pohojnë se kjo nuk ndodh asnjëherë. Ndonëse ka një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2011 sërish më shumë se 85 përqind e të rinjve të intervistuar që shkojnë në shkollë, deklarojnë se fenomeni i blerjes së notës apo provimeve është i pranishëm në shkollat e tyre. Ky perceptim

tashmë është unifikuar në të gjitha zonat urbane, rurale ku mesatarisht 44.5% e të rinjve besojnë se notat blihen shpesh. Në këtë rast ka një dallim të dukshëm me të dhënat e vitit 2011 kur ky përfytyrim mbizoteronte më shumë mes të rinjve të Tiranës.


**E11.** A e mendoni se ekziston fenomeni i blerjes së notave dhe provimeve në shkollë?



Në lidhje me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri, shumica e të intervistuarve, 55.5% e tyre shprehen se janë “deri diku të kënaqur”, të ndjekur nga 23.3% që janë të pakënaqur dhe 19.4% të kënaqur.

Në lidhje me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri, shumica e të intervistuarve, ose 43.2% e tyre shprehen se janë “deri diku të kënaqur”, duke shënuar një rënie prej 12% me të dhënat e vitit 2011 kur kjo shifër ishte 55.5%. Ky vlerësim të ndjekur nga 17.3% që janë të pakënaqur ndërkohë që është rritur disi numri i tyre që janë të kënaqur nga 19.4% në 25.3%

E7. Sa i kenaqur jeni nga cilesia e arsimit ne Shqiperi?




Niveli i pakënaqësisë me cilësinë e arsimit është më i lartë në qytetin e Tiranës krahasuar me zonat e tjera urbane e rurale, edhe pse të dhëna të tjera na sugjerojnë që Tirana ofron më shumë cilësi. Tirana përfaqëson nivel më të ulët kënaqësie mes të rinjve për cilësinë e arsimit ku vetëm rreth 15.9% e të rinjve të intervistuar shprehen se janë të kënaqur me të përkundrajt 20.6% të atyre nga zonat e tjera urbane dhe 20% nga atorurale. Kjo prirje vërtetohet kur krahasojmë nivelin e pakënaqësisë me cilësinë e arsimit i cili është më i lartë në Tiranë me 23.3% dhe ka një prirje të jetë më i pakët në zonat e tjera urbane me 13.5.3%, ndërsa në ato rurale me 15.7%.

Nga të dhënat e sondazhit të vitit 2014 vërejmë që tashmë shumica e të rinjve ose 74.4% e tyre kërkojnë të arsimohen në një shkollë private brenda vendit. Më së shumti të rinjtë synojnë arsimimin në shkollat publike dhe private Brenda vendit dhe ky është një ndryshim thelbësor në krahasim me të dhënat e vitit 2011. Edhe në këtë rast Tirana përfaqëson numrin më të lartë të të rinjve që synojnë të ndjekin shkolla private jashtë vendit krahasuar me pjesën tjetër të të rinjve nga zonat urbane e rurale.

Përqindjen më të lartë të atyre që shprehin dëshirën për të studiuar në një shkollë publike shqiptare e përbëjnë të rinjtë nga zonat rurale me 29.4 përqind, të ndjekur nga ata atë zonave të tjera urbane me 27.6 përqind dhe në fund ata nga Tirana me 25.3 përqind.


**E8.** Nëse do t'ju jepej mundësia të zgjidhnit, ku do te preferonit të arsimoheshit?




Një nga treguesit e cilësisë së arsimit në vend, ka qenë e lidhur me shpeshësinë e kurseve private të lëndeve të ndryshme, të cilat ishin të detyruar të ndiqnin nxënës të caktuar. Nga të dhënat e sondazhit rreth 60% e të rinjve pohojnë se nuk kanë ndjekur kurse private gjatë vitit të fundit por kur janë pyetur për ato afro 29% deklarojnë se nuk mund ta kuptojnë mësimin pa shpjegim plotësues.



**E13. Çfarë kursesh keni ndjekur gjatë vitit të fundit shkollor?**




**E14. Cila është arsyeja KRYESORE që ju shtyn të merrni mësim në kurse private?**



### 3.3 Punësimi


Vetëm 17 përqind e të rinjve janë përgjigjur pozitivisht kur janë pyetur nëse kanë kryer ndonjë praktikë pune (internship) gjatë vitit të fundit. Kjo shifër shënon një rënie të lehtë krahasuar me rezultatet e katër viteve më parë kur kësaj pyetje i janë përgjigjur pozitivisht rreth 20 përqind e të rinjve.

*E15. A keni kryer ndonjë praktikë/stazh/internship?*



Punësimi është sfida e menjëhershme e të rinjve pasi mbarojnë shkollën dhe përbën një shqetësim që shpesh angazhon gjithë familjen. Të pyetur nëse janë optimistë për të gjetur një vend pune mbas përfundimit të studimeve, shumica e të rinjve, rreth 40 përqind, mendon se punësimi do të vijë pas njëfarë kohe, pra do të ketë një periudhë pritjeje para se ata të fillojnë punë. Nga ana tjetër 13 përqind e të rinjve janë shumë optimistë kur pohojnë se do të fillojnë punë menjëherë. Ndërsa një e katërta e të rinjve mendojnë se nuk do të gjejnë punë duke pasqyruar një farë pesimizmi. Gjithashtu vihet re se ka një rritje të numrit të të rinjve që nuk japin përgjigje lidhur me perspektivën e tyre të punësimit ose thjesht pasqyrojnë një shpresë të vakët. Nëse në vitin 2011 kjo shifër ishte 15 përqind këtë vit janë një ndër pesë të rinj ose 22 përqind e tyre që zgjedhin pikërisht këtë përgjigje.


*E16. A mendon se pas përfundimit të studimeve universitare do të gjejsh shpejt pune?*




Numri i të rinjve të punësuar shënon një rënie të ndjeshme në vitin 2014 krahasuar me të dhënat e katër viteve më parë. Të pyetur nëse janë të punësuar qoftë me kohë të plotë apo të pjesshme, 78 përqind e të rinjve pohojnë se nuk kanë patur asnjërën prej këtyre eksperiencave. Vetëm 22 përqind e të rinjve raportojnë të jenë të punësuar në 2014 në krahasim me 35 përqind në vitin 2011.

E17. Aktualisht a jeni i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme?

### Punësimi me kohë të plotë/të pjesshme- Rinia Shqiptare 2011




### Punësimi me kohë të plotë/të pjesshme- Rinia Shqiptare 2014




Gjithashtu ka rënë numri i orëve që të rinjtë duhet tja kushtojnë punës gjatë javës nga 44.1 orë që ishte në 2011 në 38 orë në javë në 2014.

E18. Mesatarisht, sa ore ne jave punoni?




Rrethanat e ndryshme i kanë detyruar një pjesë e madhe të rinjve që të pranojnë një punë që nuk i përket profilit të tyre të studimeve, pra nuk ka lidhje me profesionin që kanë fituar ose janë duke përvetësuar nëpërmjet shkollës. Për të kuptuar dinamikat konkrete të këtij fenomeni të rinjtë u pyetën nëse janë përfshirë apo jo në këtë situatë. Rreth 30 përqind e të rinjve pohojnë se janë duke punuar në profesionin e tyre, pra ai përputhet me studimet dhe formimin e tyre. Ndërkohë rreth 41 përqind pohojnë se nuk janë të punësuar në profesionin që kanë marrë por në një fushë krejt tjetër. Nga ana tjetër janë vetëm 7 përqind e të rinjve të cilët deklarojnë se janë deri diku brenda profesionit ndërsa 17 përqind thonë se nuk kanë marrë ndonjë profesion të caktuar. Në krahasim me vitin 2011 vihet re një rritje e lehtë prej 5 përqind të numrit të atyre të rinjve që nuk janë duke punuar në profesionin e tyre por në një fushë tjetër.

E19. A punoni në profesionin që keni marrë ose po merrni?




Të rinjtë arrijnë ti formësojnë shpresat dhe dëshirat për të punuar në sektorë të ndryshëm, duke menduar mbi realitetin dhe eksperiencat e ndryshme të atyre që njohin. Lidhur me parapëlqimet e të rinjve në fushën e punësimit, rreth 48 përqind e tyre janë përgjigjur se do të kishin dëshirë të punonin në sektorin publik. Ndërsa 33 përqind e të rinjve, ose një e treta, pëlqen të punësohet në sektorin privat dhe këtij grupi i bashkëngjitet një pakicë prej 9 përqind që parapëlqen punësimin në organizatat e mëdha ndërkombëtare si OSBE, Banka Botërore etj. Nëse bëjmë një krahasim me të dhënat e vitit 2011, vërejmë se numri i atyre që dëshirojnë të punësohen në administratë, pra në sektorin publik ka mbetur i pandryshueshëm, ndërkohë që numri i atyre që dëshirojnë sektorin privat është rritur nga 25 në 33 përqind. Nga ana tjetër numri i të rinjve që dëshirojnë të punësohen në organizatat ndërkombëtare është përgjysmuar (nga 18 në 9 përqind) në krahasim me vitin 2011. Ndërkohë ka një përqindje shumë të ulët të të rinjve shqiptarë nën 3 përqind që kanë shprehur dëshirën të angazhohen në shoqërinë civile lokale, pra në sektorin jo fitimprurës vendas.

E20. Në cilin prej sektorëve të mëposhtëm do të donit të punësoheshit?



**‘Çfarë profesioni do të donit të kishit’** është një pyetje mjaft interesante që hedh dritë mbi aspiratën dhe vlerat e të rinjve. Të rinjtë shqiptarë kanë shprehur dëshira të ndryshme duke filluar me ata që duan të bëhen mësues ( 12 përqind), ekonomistë/financierë (10 përqind), arkitektë/inxhinjerë (8 përqind), avokatë/juristë ( 6 përqind) e deri te grupet pak më të vogla rreth 4-5 përqind secila që kanë synimin te profesione mjek, mekanik, menaxher, nëpunës administrate etj. Në të vërtetë përgjigjet janë shumë të ndryshme me profesione nga më të larmishmet dhe vërehet se përqindjet më të ulëta i kanë profesione të tilla si parukierët ( 3 përqind), biznesmenët (1 përqind), etj. Profesionin e mësuesisë është zgjedhur më shumë nga vajzat, ndërkohë që vihet re një prirje e kundërt për profesionin e menaxherit që parapëlqehet nga djemtë.

## E21. Çfarë profesioni do të donit të kishit?



Nga parapëlqimet e shprehura prej të rinjve duket se shumë pak prej tyre dëshirojnë që të merren me politikë ( më pak se 1 përqind).

Për të kuptuar më shumë vlerësimet dhe perceptimet që kanë të rinjtë në lidhje me profesione të caktuara ata janë vënë përballë një serie pyetjesh për të analizuar secilin profesion në detaje. Kështu për profesione të caktuara atyre ju janë përmendur disa faktorë të cilët njerëzit i konsiderojnë të rëndësishëm kur vendosin për të pranuar një punë të caktuar: të ardhurat, siguria e vendit të punës apo qëndrueshmëria, vështirësia e punës ose lodhja që shkakton si dhe respekti apo statusi në shoqëri që ky profesion u jep njerëzve. Të rinjtë i kanë renditur këto faktorë sipas rëndësisë që ata do të kishin duke përdorur një sistem vlerësimi nga 0-100 pikë ku 100 tregon rëndësinë maksimale.



**E.23\_1** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Mesues

**E.23\_2** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Ekspert IT/Komputerash







**E.23\_3** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Mjek

**E.23\_4** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Mekanik/Elektracist/Hidraulik

**E.23\_5** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Menaxher Biznesi

**E.23\_6** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Arkitekt/Inxhinier

**E.23\_7** Faktoret kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit Nënpunës Administrate



Përsa i përket profesionit të mësuesit, të rinjtë vlerësojnë se përparësia e tij lidhet me dy faktorë kyç si rroga dhe qëndrueshmërinë e vendit të punës, pra në këndvështrimin e tyre e gjykojnë një punë të sigurtë. Shumica e të rinjve i kanë renditur këta faktorë për nga rëndësia në vendin e parë dhe të dytë e i kanë vlerësuar respektivisht me 78 dhe 58 pikë nga 100. Vështirësia dhe statusi social i profesionit të mësuesit nuk janë konsideruar faktorë që do të kishin shumë peshë në zgjedhjen e tij duke qenë se renditen në vendin e tretë dhe të katërt. Nëse dikur profesioni i mësuesit gëzonte shumë respekt në shoqëri duket se tashmë ai e ka humbur pjesërisht këtë prestigj social përse kohë të rinjtë e vlerësojnë këtë faktor vetëm me 36 pikë

Një profesion relativisht i ri është ai i ekspertit të teknologjisë së informacionit ose sic njihet shkurtimisht IT. Një përqindje mjaft e lartë e të rinjve të intervistuar mendojnë se të ardhurat mujore nga ky profesion përbëjnë faktorin kryesor që do ti shtynte drejt zgjedhjes së tij. Ky faktor është vlerësuar me 83 pikë nga 100 duke konfirmuar perceptimin e përgjithshëm se IT është një fushë ku paguhesh mirë. Gjithashtu të rinjtë besojnë se ky është profesion i mirë përse i përket qëndrueshmërisë në punë duke e vlerësuar këtë faktor me 53 pikë.

Disa profesione kohët e fundit kanë marrë më shumë vëmendje nga të rinjtë për shkak të interesit që po tregohet ndaj shkollave profesionale. Në këtë grup përfshihen profesione të tilla si mekanikut, hidraulikut dhe elektrikistit që ofrojnë shërbime specifike shumë të kërkuara. Një nga elementët kryesorë të këtij vlerësimi është se ato perceptohen si fitimprurëse. Kjo vërtetohet edhe nga përgjigjet e të rinjve që i konsiderojnë të ardhurat që sjellin këto profesione si faktorin kryesor, duke e renditur atë në vend të parë me 78 pikë nga 100 maksimale, në një nivel gati të përafërt me atë të ekspertit të IT. Por nga ana tjetër të rinjtë janë të vetëdijshëm se këto profesione nuk sjellin prestigj social, duke e renditur këtë faktor në vend të fundit me vetëm 22 pikë. Nga ana tjetër një përparësi e këtyre profesioneve është qëndrueshmëria në punë që të rinjtë e kanë renditur në vend të dytë me plot 59 pikë. Duke qenë se këto profesione zhvillohen kryesisht në forma vetëpunësimi dhe biznesesh individuale ato konsiderohen si zanate të sigurta.

Përse i përket profesionit të Menaxherit biznesit të rinjtë e shohin atë si shumë fitimprurës duke renditur në vend të parë faktorin e rrogës dhe të

ardhurat. Ai ka marrë vlerësimin më të lartë sesa cdo lloj profesioni tjetër, nga 86 pikë nga 100. Përveç kësaj të qënurit menaxher biznesi duket se nuk vlerësohet nga të rinjtë si një vend pune me prestigj social, pasi ky faktor ka marrë vetëm 35 pikë nga 100.


Ndërkohë të rinjtë do ta përzgjidhnin profesionin e arkitektit dhe inxhinierit kryesisht për shkak të faktorit të të ardhurave të cilin e kanë vlerësuar me 82 pikë, ndërsa prestigji social dhe qëndrueshmërinë në punë të këtyre profesioneve i kanë vlerësuar respektivisht me 41 pikë dhe 48 pikë.

Nëse krahasojmë përgjigjet e dhëna nga të rinjtë lidhur me faktorët që i shtyjnë të zgjedhin nëpunësin e administratës publike ato përngjasojnë mjaft me ato për mësuesinë. Të dyja këto profesione vlerësohen nga të rinjtë si të sigurta, të qëndrueshme dhe me të ardhura të mjaftueshme. Përgjigjet e tyre lidhur me profesionin e nëpunësit publik janë përqëndruar kryesisht tek këto dy faktorë, ku të ardhurat vlerësohen me 79 pikë ndërsa siguria e vendit të punës me 59 pikë.

Duke ndjekur përgjigjet e vlerësimet e të rinjve lidhur me faktorët përcaktues që ndikojnë tek ata në përzgjidhjen e secilit nga 7 profesionet e sipërmendura, verëjmë se pikët më të mëdha i ka marrë faktori i të ardhurave (ose rroga). Ky faktor pasohet nga qëndrueshmëria e vendit të punës ndërkohë që vështirësia apo respekti në shoqëri që sjell një profesion i caktuar kalojnë në plan të dytë për të rinjtë.

Të rinjve iu është kërkuar të rendisin sipas rëndësisë faktorë të ndryshëm që kanë një rol të caktuar në punësimin e tyre. Sipas përgjigjeve të tyre ata mendojnë se një peshë të madhe në punësimin e tyre kanë njohjet, pra miqtë e ndryshëm. Ky faktor është vlerësuar si më i rëndësishmi me 76 nga 100 pikë të mundshme. Ndërsa një rol dytësor luajnë faktorë të tillë si lidhjet politike, niveli i arsimit dhe aftësitë profesionale të cilët janë vlerësuar të gjithë në të njëjtin nivel mesatar me respektivisht 56, 51 dhe 50 pikë nga 100 maksimale. Pra lidhjet politike perceptohen nga të rinjtë se kanë të njëjtën vlerë si arsimit apo aftësia. Në vend të fundit ata rendisin fatin, pra rastësinë me vetëm 17 pikë nga 100. Në një analizë të renditjes së këtyre faktorëve të punësimit duket se faktorë të jashtëm të tillë si njohjet apo lidhjet politike kanë të njëjtën vlerë apo vlerë më të madhe sesa përgatitja e individit nëpërmjet arsimit apo fitimit të aftësive.

## E22. Faktorët kryesorë që ndikojnë në gjetjen e një pune

***Mangësitë në informacion dhe institucione***

Përvec vështirësive që të rinjtë hasin duke kërkuar punë për shkak të rëndësisë që kanë faktorë si njohjet, miqësitë dhe favoret, ata ankohen dhe për faktin se shpesh **nuk kanë informacionin e duhur apo nuk gjejnë përkrahjen e duhur nga institucionet përgjegjëse**. Kështu një i ri nga Tirana thotë se ***“Ka mungesë informimi, duhet të kesh njohje. Unë për vete nuk di ku të drejtohem për të gjetur një punë.”***

Zyrat e punës, apo zyrat e këshillimit të karrierës, sipas të rinjve mungojnë, janë jo efikase, si dhe shpesh herë mjaft të vështira për tu gjetur. Ashtu si thonë të rinjtë, ***“Këtu zyrat e punës të kërkosh nuk i gjen dot me lehtësi, duhet të levizësh sa andej – këtej.”*** Madje edhe ata që duan të angazhohen në mënyrë vullnetare hasin të njëjtën vështirësi. Ja si shprehet një tjetër i ri nga kryeqyteti: ***“Po flas për pamundësinë e informimit, unë dua të punoj dhe vullnetarisht por nuk di ku, nuk kam ku të informohem.”***

## 4. Përfundime

Nga të dhënat vërejmë se interesi për mbarëvajtjen e cilësinë e arsimit mbetet shqetësimi kryesor i të rinjve shqiptarë. Megjithëse është shtuar niveli i informimit mbi rëndësinë e dobisë e arsimit profesional për punësim, të rinjtë vazhdojnë të tërhiqen nga ideja e studimeve universitare pavarësisht perspektivës së punësimit. Ndërkohë që cilësia e mësimdhënies në shkolla e universitete vazhdon të shoqërohet nga perceptimet e pandryshuara të të rinjve për praninë e elementeve të korrupsionit, blerjes së notës dhe provimeve duke cënuar reputacionin e tyre. Kjo pasqyrohet në parapëlqimet e tyre për të ndjekur studimet e larta në shkolla jashtë vendit. Ndërkohë roli i faktorëve ekonomikë përcakton një seri të sjelljeve e qëndrimeve të të rinjve karshi perspektivave të tyre për arsim.

## 5. Rekomandime

- Ngritja e një sistemi të mirfilltë për zhvillimin e karrierës pranë shkollave të mesme dhe të larta për të përputhur sa më mire aftësitë e të rinjve me kërkesat e tregut të punës.
- Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes investimeve publike duke ndërtuar mekanizmat e duhur të nxitjes e vlerësimit të karrierave akademike
- Ndërgjegjëmi dhe zbatimii masave shtrënguese që luftojnë korrupsionin e shitblerjen e notës në të gjitha nivelet e arsimit
- Të rinjtë duhet të kenë më shumë mundësi për të zhvilluar praktika të ndryshme pune(stazhe) nëpërmjet internshipeve. Në këtë mënyrë ata do të zgjerohin rrethin e njohjeve profesionale, fitonin më shumë eksperiencë e do të lehtësonin sfidën e tyre të punësimit.
- Meritokracia nuk shihet nga të rinjtë si një sistem që i shpërblen ata me punësim. Për këtë arsye duhet të nxiten praktika korrekte dhe transparente të aplikimeve e pranimeve në administratën publike si parakusht për shmangien e militantizmit partiak apo nepotizmit.





# KAPITULLI IV:



# SHQETËSIMET & ASPIRATAT

Përgatitur nga: **Geron Kamberi**



## 1. Hyrje

Shqetësimet dhe synimet e të rinjve shqiptarë ndërlidhen me këndvështrimin që ata kanë për të tashmen dhe ardhmen e tyre e janë rezultat i një sërë fenomenesh që i kanë shoqëruar përgjatë këtyre viteve. Një nga ato dukuri që ushtron një ndikim të madh tek të rinjtë është migrimi dhe emigrimi. Valët e mëdha të emigrimit të pas viteve 90 ku më shumë se 1/3 e popullsisë shqiptare u largua për në vendet e Evropës Perëndimore, SHBA, e Kanada ka bërë të mundur një shpërndarje tërësore të kësaj dukurie në të gjithë Shqipërinë duke prekur familje, zona e shtresa shoqërore të gjithë niveleve.. Megjithëse emigracioni masiv është në rënie, nuk është ulur dëshira mes të rinjve shqiptarë për të zgjedhur sërish një vend jashtë Shqipërisë për punësim apo jetesë. Nga pikëpamja sociale Shqipëria vazhdon të jetë një vend patriarkal, ku mbizotërojnë norma morale relativisht konservatore. Familja dhe miqtë janë forca kryesore e individit po aq sa edhe aftësia e tij për t'u përshtatur dhe mbijetuar në shoqëri. Megjithëse kanë një ndikim relativ, normat morale zënë një vend të rëndësishëm në mënyrën e jetesës dhe zgjedhjet e të rinjve në Shqipëri. Pavarësisht kategorive sociale ku të rinjtë bëjnë pjesë, nuk vërehen dallime thelbësore për sa i takon këtij aspekti të jetës. Megjithatë gjatë këtyre viteve të rinjtë shqiptarë i kanë ndërtuar gjykimet dhe vlerësimet e tyre mbi normat morale duke qenë në dyluftim me brezat e prindërve të tyre që kanë jetuar në epoka thellësisht të ndryshme të zhvillimit social, ekonomik e kulturor të vendit. Ky ballafaqimi është rrekur të përcaktojë raportin me vlerat e reja që po krijohen në shoqërinë shqiptare, por edhe qëndrimin e tyre ndaj synimeve për të ardhmen.

## 2. Gjetjet kryesore:


- Shumica e të rinjve shqiptarë nuk synojnë të largohen nga vendbanimi i tyre aktual drejt një qyteti apo fshati tjetër të Shqipërisë, por thuhet 59.8 përqind e tyre duan të emigrojnë jashtë vendit.
- Arsyeja ekonomike është shkaku kryesor që i shtyn të rinjtë shqiptarë të largohen drejt një vendbanimi të ri brenda Shqipërisë ose edhe jashtë saj.
- Të rinjtë shqiptarë parapëlqejnë si vendet më të mira për të emigruar Anglinë dhe SHBA.. Në raport me meshkujt, femrat kanë dëshirë të emigrojnë më shumë për arsye arsimimi.
- Shumica e të rinjve në Shqipëri janë optimistë për të ardhmen dhe e shohin atë më të mirë përgjatë 10 viteve në vazhdim.
- Në Shqipëri kanë filluar të mos i besojnë më guximit si faktor që të shtyn drejt fitores pasi 51.8 % e tyre në nivel kombëtar nuk janë dakortme këtë parim. Përkundër të dhënave të vitit 2011 kur kjo përqindja e të rinjve që besonin tek kjo shprehje ishte 80 % kjo rënie drastike dëshmon për një frymë pesimizmi që ka pëfshirë të rinjtë.
- 83% përqind e të rinjve shqiptarë i konsiderojnë shumë të rëndësishme normat morale në shoqëri.
- Miqtë nuk shihen vetëm si faktor argëtimi, por edhe si bashkëbisedues me të cilët mund të ndash hidhërimin dhe përkundër vitit 2011 ku këtë e pohonin 44 % e të rinjve në vitin 2014 janë ku 69.1 përqind e të rinjve që besojnë se në jetë nuk është e mjaftueshme të kesh disa miq dhe të bësh çfarë ke dëshirë.

### 3. Analiza e detajuar e rezultateve

#### 3.1 Migrimi dhe emigrimi


Nga të dhënat e këtij anketimi vërejmë se dëshira dhe synimi për t'u larguar nga Shqipëria vazhdon të jetë ende e fortë mes të rinjve madje me një prirje që vjen duke u rritur në krahasim me vitet e mëparshme. Nga të dhënat e vitit 2014 janë 59.8% e të rinjve që dëshirojnë të emigrojnë jashtë Shqipërisë, përkundër 53% në vitin 2011. Djemtë vazhdojnë të kenë një përqindje më të lartë me 63.5% përkundër vajzave me 55.2%. Dëshira për tu larguar jashtë vendit nuk bën dallim mes të rinjve pavarësisht grupmoshave apo shtresave sociale që i përkasin. Kështu psh 51.7% e të rinjve që vijnë nga familjet e pasura pohojnë se duan të largohen nga vendi cka dëshmon se të rinjtë ndjejnë mungesën e shumë kushteve që garantojnë zhvillimin e tyre arsimor, ekonomik e profesional apo kulturor

**D1.** A keni dëshirë të zhvendoseni nga vendbanimi juaj ekzistues në një qytet/fshat tjetër të Shqipërisë?



Në lidhje me rrethanat dhe faktorët që i shtyjnë drejt emigrimit, të rinjtë vazhdojnë të theksojnë përmirësimin e standartit të jetësës dhe të kushteve ekonomike. Rreth 49.2 përqind e atyre që janë intervistuar në nivel kombëtar shprehen se dëshirojnë të emigrojnë për të përmirësuar jetën ekonomike dhe standardin e jetësës, ndërsa vetëm 14.9% synojnë të largohen nga vendi për arsye që lidhen me arsimin. Megjithëse të rinjtë e moshës 16-17 vjeç kanë qëllim të emigrojnë për një arsimim më të mirë, ata e shohin këtë edhe si një mundësi punësimi në vendet ku do të kryejnë studimet. Për sa i përket arsyeve për emigrim vihet re një dallim mes të rinjve të gjinive të ndryshme. Në këtë kuadër femrat e reja, rreth 22% dëshirojnë të emigrojnë më shumë për shkak të arsimit me përkundrejt meshkujve me 8.4%.

**D3.** Sa dëshirë keni të emigroni jashtë Shqipërisë?




Përveç emigrimit, Shqipëria u përball pas viteve '90 me migrimin e brendshëm të qytetarëve nga zonat rurale apo qytetet e tjera të vendit drejt Tiranës dhe Durrësit. Nga ana tjetër, vërejmë se synimi i të rinjve për të lëvizur brenda vendit nuk ka ndryshuar në mënyrë të dukshme.

Por megjithëse 39.8 përqind e të rinjve në Shqipëri shprehen se dëshirojnë të lëvizin nga vendbanimi i tyre aktual në një qytet apo fshat tjetër të Shqipërisë, pjesa tjetër prej 59 përqind pohon të kundërtën, duke treguar një qëndrueshmëri në raport me banimin apo punësimin

Ndërkohë sërish del në pah dallimi i madh mes të rinjve që jetojnë në Tiranë kur kjo dëshirë për të lëvizur në një qytet apo fshat brenda vendit përfshin 7% të tyre ndërsa në qytetet e tjera dhe në zonat rurale kjo shifër është disa herë më e lartë si 33,2% në qytetet kryesore, 55.3% në qytetet e tjera dhe rreth 47% e të rinjve që jetojnë në fshat. Këta tregues dëshmojnë për mungesën e perspektivës së të rinjve në këto zona, thellimin e dallimit mes kryeqytetit e qyteteve të tjera duke nxjerrë në pah mungesën e zhvillimit të barabartë e te qëndrueshëm në nivel rajonal e kombëtar. Këto prirje të larta të migrimit të tyre të brendshëm pasqyrojnë pesimizmin e tyre për të përmirësuar situatën ekonomike brenda zonave ku banojnë dhe besimin se jeta jashtë tyre ofron kushte më të mira.

Rreth 91.5 përqind e të rinjve që jetojnë në Tiranë nuk synon të largohet drejt një qyteti apo fshati të caktuar, cka tregon se Tirana vazhdon të mbetet vendbanimi më i parapëlqyer në Shqipëri. Edhe në qytetet e tjera kryesore apo dhe në fshat afro 50 % shprehen se nuk dëshirojnë të ndryshojnë vendbanimin e tyre ekzistues. Kjo prirje për të mos e ndryshuar vendbanimin drejt një migrimi të brendshëm në Tiranë apo qytete të tjera lidhet me shtrenjtimin e kësaj zhvendosje brenda vendit, mungesës së burimeve financiare dhe pasigurisë që ka për punësim në këto qytete për shkak të krizës ekonomike.

## D2. Cila është arsyeja KRYESORE që do ju bënte të ndryshonit vendbanim?



Gjatë këtyre viteve sjelljet dhe prirjet emigratore të të rinjve kanë qenë të lidhura me faktin se Shqipëria është fqinj me dy vende anëtare të BE siç janë Italia dhe Greqia. Por kriza e stërzgatur ekonomike në këto dy vende ka bërë që 46.9% të shprehen se parapëlqejnë të emigrojnë Britaninë e Madhe dhe SHBA. Tashmë edhe të rinjtë e zonave jugore që dikur parapëlqenin Greqinë si vendin më të afërt për emigrim, rreth 29.4% e tyre kanë si vend të pëlqyer SHBA


Arsyet për emigrim nga ana e të rinjve lidhen me një sërë elementesh por vërejmë se tek femrat mbizotëron më shumë dëshira për një arsimim më të mirë. Në këtë drejtim 22.8 përqind e të rejave femra shprehen se synimi për të emigruar lidhet me dëshirën për një arsimim më të mirë përkundrejt 8.4 përqind e të rinjve meshkuj që shprehin të njëjtën dëshirë. Kjo arsye shërben sërish si kriter për të vënë në dukje dallimin mes të rinjve që jetojnë në Tiranë në raport me të rinjtë që jetojnë në zonat rurale. Rreth 20.9 përqind e të rinjve që jetojnë në Tiranë shprehen se arsyeja për të emigruar lidhet me synimin e tyre për të pasur një arsim më të mirë përkundrejt 12.6 përqind e të rinjve nga qytetet e tjera apo nga zonat rurale

Pesha e faktorit nxitës të emigrimit që lidhet me shmangiene konflikteve në fshatin apo qytezën ku jetojnë të rinjtë vazhdon të zbehet gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve e

Por vazhdojnë të thellohen faktorët ekonomikë si shtysë për emigrim ku mungesa e punësimit mbetet elementi më i rëndësishëm.

Këto të dhëna dëshmojnë se emigrimi apo migrimi mes të rinjve shqiptarë nxitet nga një sërë arsyesh duke filluar nga dëshira për një jetë më të mirë, arsimimi dhe mungesa e mundësive për punësim. Ky element vazhdon të përcaktojë në mënyrë të dukshme raportin e tyre me të ardhmen dhe bën pjesë tek një prej rrugëzgjidhjeve të parapëlqyera për të ndryshuar jetën e tyre.

**D5. Cila është arsyeja KRYESORE që do ju bënte të emigronit jashtë Shqipërisë?**



### **Të rinjtë shqiptarë, të gatshëm për tu larguar nga Shqipëria**

Përsa i përket dëshirës së të rinjve për tu larguar nga vendi, situata mbetet e pandryshuar krahasuar me 2011. Kështu, edhe në 2014, shumica e të rinjve në grupet e diskutimit shprehen se do të largoheshin nga Shqipëria nëse do tju jepej një mundësi e tillë.. Sipas rezultateve, rreth 9 në 10 të rinj të intervistuar do të dëshironin të emigronin nëse do të ju jepej mundësia.

Arsyet e dhëna nga të rinjtë për largimin nga Shqipëria, lidhen kryesisht me shpresën për mundësi më të mira studimi jashtë Shqipërisë, i dhe garantimin e një standardi më të mirë jetese. Mungesa e një sistemi meritokratik për punësimin, varfëria dhe papunësia janë disa prej arsyeve të tjera të renditura nga të rinjtë shqiptarë. Pavarësisht dëshirës së pandryshuar për të emigruar, një numër i konsiderueshëm i të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit shprehen të gatshëm për tu rikthyer dhe të investojnë në Shqipëri të ardhurat nga emigracioni.

*“Dua të largohem sepse jam mërzitur me përditshmërinë këtu. Më pëlqen të jem i pavarur dhe të jetoj vetëm. Për të krijuar të ardhura ekonomike më të mira.”*

(Tiranë, Urban)

*“Unë do të emigroja për mundësi më të mira shkollimi, që në një të ardhme të largët të kthehem këtu dhe të bëj diçka. Ndërsa këtu me këtë shkollim dhe këto rrethana që kam ndihem shumë inferiore. Jashtë do mundohem të njoh më shumë, do kem një kulturë dhe mentalitet tjetër.”*

(Tiranë, Urban)

*“Arsyeja e parë [pse do të emigroja] është ekonomike dhe nuk ka një të ardhme të sigurt këtu në vendin tone. Unë aktualisht studioj por mesa kemi dëgjuar duhet paguar për një vend pune dhe nuk varet nga aftësitë.”*

(Tiranë, Urban)

*“Dhe unë për vete do doja te largohesha biles jam penduar që kam zgjedhur të vazhdoj masterin këtu në Shqipëri. Kam dëshirë ta vazhdoj jashtë sepse ka më shumë mundësi për tu punësuar dhe për tu integruar në shoqërinë europiane. Do të ishte akoma më mirë nëse do ta vazhdoja ne Amerikë.”*

(Tiranë, Rural)




## 3.2 E ardhmja dhe qëllimi në jetë

E ardhmja shihet prej të rinjve si një tërësi elementesh social dhe ekonomikë që ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e prioriteteve dhe qëllimeve të tyre në jetë. Në përgjithësi të rinjtë shqiptarë e karakterizojnë të ardhmen e vendit me nota pozitive dhe shprehen në mënyrë optimiste. Megjithatë, përballë optimizmit të tyre, të rinjtë janë peng i dilemave, dyshimeve apo kontradiktave ku përzihet shpresa afatgjatë me pasigurinë afatshkurtër të së nesërme.

Kjo dilemë apo kundërthënie vlerësimesh për të ardhmen shfaqet edhe në përgjigjet e të rinjve të intervistuar ku ndonëse 87.3 përqind e tyre besojnë se pas 10 vitesh e ardhmja e Shqipërisë do të jetë më e mirë, shumica e tyre sërish dëshirojnë largimin dhe punësimin në një vend tjetër larg Shqipërisë. Në të këtë rast vëmë re një prirje më të lartë optimizmi për të ardhmen tek femrat e reja me 89.5 përqind, përkundrajt 85.1 përqind të meshkujve.

**D6. Si e shikoni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?**



Përveç mënyrës sesi e shohin të ardhmen, shumica e të rinjve shqiptarë besojnë se është e rëndësishme të dish se çfarë synon të arrish në jetë.

Në këtë drejtim 50.7 përqind e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar janë shumë dakord me këtë pohim. Edhe në këtë rast vërejmë se femrat kanë një prirje për të qenë më të orientuara drejt qëllimeve të përcaktuara në raport me meshkujt, ku 52.3 përqind e tyre besojnë se duhet të dish çfarë kërkon të arrish në jetë përkundrejt 41.8 përqind të meshkujve

Shqipëri kanë filluar të mos i besojnë më guximit si faktor që të shtyn drejt fitores pasi 51.8% e tyre në nivel kombëtar nuk janë dakort me këtë parim. Përkundër të dhënave të vitit 2011 kur kjo përqindja e të rinjve që besonin tek kjo shprehje ishte 80% kjo rënie drastike dëshmon për një frymë pesimizmi që ka pëfshirë të rinjtë duke i rënë ndesh një kulture dhe popullatë relativisht aktive që duhet të besojë tek parimi se në jetë duhet të guxosh dhe rrezikosh.

Përkundër këtij përcmimi të të rinjve ndaj guximit si faktor i suksesit në jetë një numër i madh i tyre e konsideron fatin si përcaktues për arritjen synimeve të tyre. Në këtë kuadër, 61.8 përqind e të rinjve të intervistuar besojnë pjesërisht ose plotësisht se duhet të mbështetesh tek fati dhe të marrësh nga jeta çfarë të mundesh apo jepet. Nga ana tjetër janë 20 përqind e tyre që pohojnë se nuk duhet të besosh në fat dhe të marrësh nga jeta çfarë të jepet. Ky është një tregues i besimit se fati nuk është përcaktues në jetën dhe mirëqenien sipas të rinjve shqiptarë,

### 3.3 Altruizmi dhe morali

Në kulturën shqiptare kujdesi për të tjerët është lidhur gjithmonë me detyrime të ngushta familjare dhe mentalitetin që buron nga tradita e lidhjeve të gjakut e fisit. Në këtë rast shumica e të rinjve shqiptarë e lidhin kujdesin e tyre për të tjerët me ata individë që i përkasin familjes, prindërve të afërmve si edhe prindërve të bashkëshortes apo bashkëshortit. Në shumicën e zonave rurale apo urbane fenomeni i jetesës në familje të mëdha, kërkon edhe kujdesin për të tjerët si një formë bashkëjetese dhe si normë sociale. Kjo vihet re në formën e kujdesit të gruas ndaj burrit, ndaj prindërve apo edhe gjyshërve.

Për të rinjtë normat morale vazhdojnë të konsiderohen një element shumë i rëndësishëm i një shoqërie në mënyrë që ajo të funksionojë siç duhet. Në këtë drejtim të dhënat e anketimit tregojnë se 83 përqind e të rinjve në nivel kombëtar besojnë se ato janë të qenësishme për vetë funksionimin e shoqërisë

Ndonëse në realitetin shqiptar përcaktimi i normave morale ka ende paqartësi, në shumicën e rasteve ato nënkuptojnë tërësinë e atyre elementëve që drejtojnë jetën sociale në zonat përkatëse

### 3.4 Raporti me të tjerët


Mbështetja tek të tjerët shihet si një faktor shumë i rëndësishëm në jetë nga shumica e të rinjve. Në shoqërinë shqiptare vazhdon të mbizotërojë mendimi se miqtë dhe të afërmit janë ata që në shumicën e rasteve i japin zgjidhje problemeve apo krijojnë kushte të favorshme jetese. Kjo pasqyrohet në faktin se 89.6 përqind e të rinjve besojnë se në jetë duhet të jesh i rrethuar nga njerëz të cilët mund të mbështetesh. Kjo është një prirje e përgjithshme ku vërehen dallime të pakta mes të rinjve që u përkasin kategorive të ndryshme ekonomike, sociale apo gjeografike.

Nga ana tjetër miqtë nuk shihen vetëm si faktor argëtimi, por edhe si bashkëbisedues me të cilët mund të ndash hidhërimin dhe përkundër vitit

2011 ku këtë e pohonin 44% e të rinjve në vitin 2014 janë ku 69.1 përqind e të rinjve që besojnë se në jetë nuk është e mjaftueshme të kesh disa miq dhe të bësh çfarë ke dëshirë

Një nga të dhënat e anketimit na tregon se 66.8% e të rinjve besojnë se nuk është e rëndësishme të ndjekësh rrjedhën e të tjerëve cka dëshmon për përpjekjet e tyre për një identitet individual dhe përpjekje për të qenë vetvetja. Nga ana tjetër 78.3% besojnë se nuk dihet të mbyllesh në botën tënde e të izolohesh nga të tjerër duke krijuar një drejtpeshim të drejtë mes përfshirjes social dhe identitetit individual.

**D7. Sa dakord jeni me secilën nga këto thënie? Do të thonit se jeni shumë dakord, dakord, deri diku dakord, jo dakord apo aspak dakord ?**



## 4. Përfundime

Në këtë kapitull të dhënat e anketimit mes të rinjve na tregojnë se pavarësisht prirjes në rënie të migrimin dhe nivelin sërish të lartë për emigrim, shoqëria shqiptare ka pësuar në këto vite ndryshime dhe zhvendosje të mëdha nga fshati në qytet dhe nga Shqipëria jashtë saj. Këto ndryshime të vendbanimit kanë sjellë ndryshime të shumta në mënyrën e jetesës së të rinjve e për pasojë edhe të vlerave dhe koncepteve të përgjithshme nga të cilat shoqëria përcakton se çfarë është e keqe apo e mirë, e dëshirueshme apo jo, e vlefshme apo e kotë. Ndonëse këto lëvizje kanë qenë të shpeshta dhe pothuajse të pakontrolluara tashmë të dhënat na dëshmojnë se ka dallime të pakonsiderueshme ndërmjet vlerave dhe besimeve të zonave rurale me ato urbane. Megjithatë pasojat e kësaj lëvizje kanë sjellë çrregullime sociale, rritje të kriminalitetit, paqartësi dhe vështirësi të të rinjve në përshtatje me jetesën në zonat urbane. Edhe pse të dhënat tregojnë se të rinjtë në Shqipëri besojnë në vlera si guximi, altruizmi dhe të qenit i hapur në shoqëri, sërish mendojnë se lidhjet e ngushta miqësore dhe familjare janë shumë të rëndësishme në mënyrë që të kesh sukses në jetë. “Miku”, i cili zgjidh një pjesë të mirë të halleve, duke filluar nga punësimi e deri tek ato familjare është një ndër “pasuritë” më të rëndësishme të individit në Shqipëri pa të cilin pak të rinj besojnë se mund të arrijn atë që dëshiron në jetë. Ky tregues pasqyron një nivel të ulët të institucionalizimit të shoqërisë dhe pavarësisë së individit për të zgjidhur problemet e tij përballë institucioneve apo edhe pjesës së “huaj”, të panjohur. Edhe pse tek të rinjtë ky mentalitet ka prirje drejt rënies dhe po rritet besimi në aftësinë e gjithsecilit për të përballuar jetën, pavarësisht lidhjeve dhe miqësive, sërish ato shihen si element me rëndësi për mirëqenien e individit.

## 5. Rekomandime

- Ndërmarrja e politikave integruese për përballimin e lëvizjeve migratore brenda vendit dhe zbatimi i strategjisë për zhvillimin e zonave rurale duke zvogëluar dallimet social- ekonomike ndërmjet zonave të vendit.
- Hartimi dhe zbatimi i efektshëm i politikave që mbështesin emigrantët e kthyer të cilët sjellin kapitalin financiar, social dhe transferojnë aftësitë e tyre në biznese të ndryshme
- Diskutimi dhe hartimi i një plani kombëtar dhe rajonal efektiv dhe të matshëm për punësimin e të rinjve në vend, duke marrë në konsideratë edhe krizën globale.
- Nxitja dhe krijimi i një atmosfere meritokracie në të gjithë sektorët e punësimit, veçanërisht atij publik.
- Ministria , Çështjeve Sociale dhe Rinisë së bashku me Ministrinë e Brendshme, duhet të hartojnë një strategji përfshirje sociale dhe punësimi të të rinjve që vijnë nga zonat e thella të vendit , për të shmangur nga emigrimi i paligjshëm dhe përfshirja në aktivitete të tilla





**KAPITULLI V:**

STILI I JETËS  
KONSUMI  
ARGËTIMI

Përgatitur nga: **Alba Çela**



## 1. Hyrje

Shpeshherë në faqet sociale të medias shqiptare rinia stigmatizohet si pasive, indiferente dhe konsumatore e shfrenuar. Këto raportime rrallëherë marrin parasysh mundësitë e ofruara në zonat e ndryshme urbane e rurale të vendit apo dallimet midis shtresave të ndryshme. Në këtë kuadër rinia shqiptare nuk ndryshon shumë në tendencat e saj të konsumit apo dhe kalimit të kohës së lirë nga bashkëmoshatarët në gjithë botën. Shkalla e lartë e përdorimit të teknologjive të informacionit e lidh natyrshëm rininë shqiptare me tendencat e konsumit global. Megjithatë përballë sfidave të reja të punësimit dhe fuqizimit ekonomik të rinjtë duhet të gjejnë një kompromis. Ky kompromis nënkupton një lidhje mes dëshirave të tyre që ushqehen nga një marketing i parreshtur mediatik dhe buxheteve familjare nga të cilët vazhdojnë të jenë të ndërvarur.

Ky kapitull përpiqet të analizojë edhe një aspekt interesant të jetës së të rinjve që lidhet me jetën, sjelljet dhe tabutë e tyre seksuale. Kjo pjesë e rëndësishme e jetës rinore është pak e njohur dhe e studiuar cka bie ndesh me nevojat e tyre për informim dhe ndërgjegjësim për të qenë të shëndetshëm e të përgjegjshëm.

## 2. Gjetjet kryesore

- Televizioni, muzika dhe daljet me miqtë mbeten alternativat kryesore të të rinjve për kalimin e kohës së lirë. Më pak praktikohet leximi, sporti dhe kinemaja.
- Ka një rritje të ndjekjes së lajmeve nga të rinjtë : Në 2011, vetëm 34 përqind e të rinjve pohonte se ndiqte lajmet cdo ditë krahasuar me 47 përqind në 2014. Debatet politike nuk i interesojnë një pjese të konsiderueshme të të rinjve, rreth 34 përqind thonë se nuk i ndjekin kurrë ato dhe 18 përqind i ndjekin rrallë.
- Aksesit të rinjve shqiptarë në Internet në katër vite ka mbetur i pandryshuar dhe 15 përqind e tyre ende nuk e kanë këtë mundësi. Koha që të rinjtë shpenzojnë në Internet është rritur. Në 2011 mesatarisht të rinjtë kalonin 2.9 orë në Internet ndërkohë që në 2014 kalojnë 3.2 orë.
- Përdorimi më i shpeshtë i Internetit nga 85 përqind e të rinjve lidhet me zgjerimin e rrjeteve sociale (Facebook, Tëitter, etj). Kjo prirje pasohet nga përdorimi i Internetit prej ¼ e të rinjve për të chatuar (biseduar online) me miqtë
- Martesa nuk shihet si dicka në modë nga ana e të rinjve. 30 përqind e tyre deklarojnë se martesa nuk është aq shumë në modë dhe 25 përqind e cilësojnë martesën krejtësisht jashtë mode.
- Një e katërta e të rinjve të intervistuar pohojnë se përdorimi i marijuanës është në modë.
- Në krahasim me vitin 2011 është ulur konsumimi i duhanit nga të rinjtë në vitin 2014: tashmë janë vetëm rreth 17 përqind e të rinjve të intervistuar që thonë se janë përdorues të përditshëm të duhanit ndërsa 10 përqind deklarohen si duhanpirës me raste.

- Përsa i përket konsumimit të alkolit janë 56 përqind e të rinjve që e mohojnë përdorimin e tij, të ndjekur nga 29 përqind e tyre që pohojnë se pinë rrallë alkool apo 6.6 përqind e të rinjve që deklarojnë se përdorin alkool vetëm gjatë fundjavave. Shumica e të rinjve, 57 përqind e gjerë, përdorin alkoolin të papranueshëm për normat shoqërore ndërsa 12 përqind e shohin të nevojshëm konsumin e tij si një mënyrë për të mbajtur rrethin shoqëror.
- Lidhur me sjelljet e tyre seksuale afro 36 përqind e të rinjve mohojnë të kenë kryer marrëdhënie seksuale. Nga ana tjetër janë një e treta e të rinjve që deklarojnë se kanë kryer marrëdhënie me një partner ndërkohë që rreth 19 përqind e tyre pohojnë se ka marrëdhënie me më shumë sesa një partner. Meshkujt kanë shifra shumë të larta të aktivitetit seksual dhe në krahasim me femrat kanë më shumë se një partner.
- Përsa i përket përdorimit të masave mbrojtëse gjatë aktivitetit seksual, të rinjtë meshkuj kryesojnë në përqindje. Rreth 40 përqind e tyre pohojnë që përdorin masa mbrojtëse në mënyrë të rregullt në krahasim me vetëm 16.6 përqind të femrave. Ndërkohë numri i femrave që nuk përdorin kurrë masa mbrojtëse është shumë më i lartë sesa ai i meshkujve, 36.6 përqind në krahasim me 14.5 përqind.
- Rreth 22 përqind e të rinjve beson se virgjëria është një vlerë e rëndësishme për të dyja gjinitë. Gjithsesi afro, 35.5 përqind e tyre e shohin virgjërinë si vlerë vetëm për femrat. Megjithatë 32 përqind e të rinjve mendojnë se virgjëria nuk është vlerë përkundrazi është një koncept i vjetëruar ose akoma më keq një barrë psikologjike mbi individin.


## 3. Analiza e detajuar e gjetjeve

### 3.1 Koha e lirë

Të rinjtë shqiptarë janë ‘peng’ i një numri të vogël alternativash për të kaluar kohën e lirë ku prioritet merr muzika dhe televizioni. Rreth 83 përqind e tyre deklarojnë se dëgjojnë muzikë gjatë kohës së lirë ndërsa 81 përqind ndjek programet në televizor. Rreth 17-18 përqind e të rinjve dëgjojnë muzikë dhe shohin televizion sipas rastit.

Të dhënat e sondazhit tregojnë se 68 përqind e të rinjve dalin shpesh me miqtë e tyre si një mënyrë e zakonshme për të kaluar kohën e lirë ndërkohë që 26 përqind dalin më rrallë. Ndërkohë dalja me miqtë nuk është një alternativë gjithnjë e lehtë për vajzat. Ndërsa 81 përqind e meshkujve del me miqtë shumë shpesh, vetëm gjysma e vajzave e bën këtë. Nga ana tjetër 10 përqind e vajzave të anketuara raporton se nuk del asnjëherë me miqtë, një realitet që nuk ekziston për djemtë. Për të dalë me miqtë jashtë shtëpisë luan një rol edhe statusi ekonomik i të rinjve., Kështu rreth 14 përqind e të rinjve të intervistuar që vijnë nga shtresa më e varfër e shoqërisë thotë se nuk del asnjëherë me miqtë. Gjithashtu shifra e të rinjve që dalin rregullisht me miqtë ulet gradualisht kur largohemi nga kryeqyteti drejt zonave të tjera urbane e më tej rurale, ku nga 77 përqind në Tiranë ajo zbret në 60 përqind nëpër fshatra.

A1. Sa shpesh kryeni secilin prej këtyre aktiviteteve



Leximi duket se është një aktivitet që kryhet rregullisht vetëm nga 30 përqind e të rinjve që pohojnë se janë lexues të rregullt ndërsa afërsisht gjysma e tyre deklarojnë se lexojnë ndonjëherë. Në krahasim me sondazhin e kaluar vihet re një prirje e lehtë e rritjes së lexuesve të rregullt mes të rinjve përkundër atyre rastësorë. Kështu në vitin 2011 ishin 23 përqind e të rinjve të intervistuar që lexonin rregullisht, ndërsa në vitin 2014 kjo shifër është 30 përqind. Sërish përbën një të dhënë shqetësuese fakti se 22 përqind e tyre deklarojnë se nuk lexojnë kurrë në kohën e tyre të lirë, shifër që mbetet e pandryshuar në raport me katër vite më parë. Ndarja gjinore është një tregues tjetër që pasqyron dallimet mes të rinjve lidhur me leximin: psh 43 përqind e femrave pohojnë se lexojnë rregullisht përkundër 18 përqind të meshkujve, ndërsa në grupin e të rinjve që nuk lexojnë kurrë meshkujt përbëjnë 30 përqind në krahasim me 12 përqind të femrave që bëjnë këtë pohim.

Praktikimi i sportit, si një ndër mënyrat e shëndetshme dhe aktive të shpenzimit të kohës së lirë, është një aktivitet që kryhet me raste nga të rinjtë ose nuk kryhet fare. Sipas të dhënave të sondazhit vërejmë se 38 përqind e të rinjve thonë se i praktikojnë ndonjëherë sportet ndërsa 35 përqind nuk merren fare me të. Vetëm një e katërta e të rinjve rezultojnë se janë praktikantë të shpeshtë të aktiviteteve sportive dhe fizike.

Ndërsa shifrat e frekuentimit të kinemave nga ana e të rinjve mbeten shumë të ulëta ashtu sikundër në sondazhin e para 4 viteve. Gjatë kësaj periudhe nuk është hapur asnjë kinema e re në jashtë Tiranës cka bën që ndjekësit e rregullt ose 4 përqind e të rinjve të jenë të përqendruar në kryeqytet. Një e treta e të rinjve frekuenton ndonjëherë kinemanë sipas mundësisë por rreth 62 përqind e tyre pohojnë se nuk ka shkuar kurrë.

### 3.1.1 Mundësitë ekonomike, vendndodhja dhe opsionet

Alternativat e të rinjve për të kaluar kohën e lirë shpesh kufizohen nga vendndodhja (sidomos në rastin e të rinjve që banojnë në fshat), mundësitë ekonomike, hapësirat dhe aktivitetet e organizuara nga strukturat përgjegjëse.

Nga ana tjetër zhvillimi i teknologjisë mundet që të zëvendësojë në mënyrë të natyrshme disa alternativa me të tjerat.

Kështu një i ri nga fshati thotë se ***“Unë kinemanë e frekuentoj 2 herë në vit. Sepse teknologjia siç e shohim ka arritur zhvillime shumë të larta dhe ne mund të shohim mjaft kollaj një film. Hapim laptopin e përmes internetit shikojmë filmin që dëshirojmë.”***

Në përgjithësi duket se të rinjtë kërkojnë më shumë angazhim nga qeveritë qendrore dhe lokale për biblioteka, fusha sportive, etj por inkurajojnë edhe iniciativa qytetare spontane. Ja si shprehen dy të rinj nga zonat rurale dhe urbane në Tiranë:

***“Biblioteka është e papërshtatëshme këtu tek ne. Unë personalisht jam studente dhe kam kërkuar libra duke shkuar në të gjitha bibliotekat e mundëshme por ambjenti është i papërshtatshëm. Librat janë të kufizuar, nuk ka libra.” “Këtu në Shqipëri përveç atyre që u thanë, nuk ka as aktivitete sportive të organizuar nga pushteti lokal, apo nga vetë njerëzit.”***


Së fundmi institucionet kulturore duhen të angazhohen për të bërë të ditur programet e tyre përmes atyre formave moderne të informimit që parapëlqehen sot nga të rinjtë.

Një i ri nga një fshat i Tiranës ankohet se **“Për teatrin është vështirë të marrësh informacion, më shumë duhet ta marrë atë duke u paraqitur fizikisht pranë teatrit.**

**Ndërsa faqet web të kinemave në Tiranë janë të përfshira në rrjetet sociale dhe e ke më të thjeshtë për të parë se çfarë filmi duhet të ndjekësh.”**

Ndërsa televizori konsiderohet një element ku të rinjtë shpenzojnë një pjesë të mirë të kohës së lirë. Të rinjtë shqiptarë shpenzojnë mesatarisht 3.2 orë duke ndjekur programet në televizor. Një ndryshim i vogël vërehet tek të rinjtë në kryeqytet që harxhojnë më pak kohë përpara ekranit të televizorit, rreth 2.6 orë. Ndërkohë vihet re një rritje e lehtë prej 0.1 orësh pra rreth 6 minuta në ndjekjen e televizorit nga viti 2011 në 2014.

A2. Mesatarisht, gjatë një dite të zakonshme sa orë shikoni televizor?



### 3.1.2 Përsa i përket programeve të ndjekura në televizor, interesat e të rinjve janë të ndryshme.

Tipologjia e programeve që ofrohen përmes televizionit dhe përqindjet e ndryshme të parapëlqimeve të të rinjve ndaj tyre dëshmon për shije social kulturore të larmishme. Muzika, lajmet, filmat, dokumentarët e aktivitetet sportive vazhdojnë të përbëjnë një strukturë që konsumon një pjesë të mirë të kohës së lirë të rinjve.

Një shikueshmëri të lartë kanë programet me muzikë të huaj që ndiqen përditë nga 51 përqind e të rinjve, 24 përqind e tyre i ndjekin ato disa herë në javë ndërsa 12 përqind e tyre i ndjekin këto programe një herë në javë.

Ndërsa edicionet e lajmeve ndiqen rregullisht cdo ditë nga 47 përqind e të rinjve dhe disa herë në javë nga 22 përqind e tyre. Sidoqoftë rreth 19 përqind e të rinjve është shumë pak e interesuar në përcjelljen e aktualitetit përmes lajmeve. Një pjesë e tyre nuk i ndjekin fare ato ose më rrallë se një herë në javë. Megjithatë në krahasim me katër vite me parë, ka një ndryshim të qenësishëm lidhur me rritjen e përqindjes së të rinjve që ndjekin lajmet. Ndërsa në vitin 2011 ishin vetëm 34 përqind e të rinjve që pohonte se ndiqte lajmet cdo ditë, në vitin 2014 kjo shifër është 47 përqind.

Në lidhje me zhanrin kinematografik më të ndjekur nga të rinjtë në televizion, ai i përket filmave aksion. Rreth 37 përqind e të rinjve pohon se i ndjek këto lloj filmash cdo ditë, ndërsa 30 përqind të tjerë deklarohet që i sheh ato disa herë gjatë javës. Filmat aksion janë më shumë dobësi e djemve, duke qenë se rreth 50 përqind e tyre janë ndjekës të përditshëm të tyre në krahasim me 23 përqind të femrave. Nëse 12 përqind e femrave të intervistuar nuk i ndjekin këto filma asnjëherë, numri imeshkujve që nuk ndjekin ato është i papërfillshëm.

Filmat e huaj më të ndjekur pas atyre aksion, janë filmat me tema shoqërore të shikuar përditë nga 24 përqind e të rinjve dhe disa herë në javë nga 33 përqind e tyre. Filmat e huaj thriller ndiqen pak më rrallë, 23 përqind thonë se i ndjekin ato përditë dhe 28 përqind disa herë në javë.




Programet me muzikë të lehtë shqiptare ndiqen rregullisht nga një e treta e të rinjve dhe ndiqen disa herë në javë nga 29 përqind e tyre. Ndërsa programet me muzikë popullore shqiptare janë më pak të ndjekura dhe ndiqen cdo ditë nga një e katërta e të rinjve.

Gjithashtu telenovelat bëjnë pjesë në programin e përditshëm të televizioneve dhe ndiqen në mënyrë të rregullt (cdo ditë) nga 31 përqind e të rinjve të intervistuar. Përveç kësaj, 11 përqind e tyre i ndjekin telenovelat disa herë gjatë javës dhe 6 përqind vetëm një herë në javë. Dallimet gjinore edhe në këtë rast janë të dukshme. 49 përqind e femrave i ndjekin telenovelat cdo ditë krahasur me vetëm 13 përqind të meshkujve q. Po ashtu 60 përqind e meshkujve thonë se nuk i ndjekin kurrë telenovelat, ndërkohë që pjesa e femrave që pohon të njëjtën gjë është shumë më e vogël, 21 përqind. Të rinjtë në Tiranë i ndjekin më rrallë telenovelat sesa moshatarët e tyre në qytet dhe fshatra.

Programet sportive ose ato me koment sportiv ndiqen cdo ditë nga 18 përqind e të rinjve ndërsa një në pesë të rinj i ndjek ato disa herë në javë. Një pjesë emadhe e të rinjve 27 përqind nuk i ndjek kurrë këto programe. Meshkujt janë ndjekës më të apasionuar ndaj programeve sportive. Rreth gjysma e femrave të anketuara thonë senuk indjekin kurrë programet sportive ndërkohë që 64 përqind e meshkujve i ndjekin ato sëpaku disa herë gjatë javës.

**A3. Sa shpesh i ndiqni këto programe televizive?**



Përsa u përket dokumentarëve me tema historike dhe shkencore ato ndiqen nga 46 përqind e të rinjve një herë në javë ose dhe më rrallë sesa kaq. Vetëm 14 përqind e tyre janë të interesuar ti ndjekin këto dokumentarë përditë.

Programet me humor kanë ngjallur interesin e më shumë të rinjve këtë vit krahasuar me katër vite më parë. Ndërkohë që në 2011, vetëm 13.3 përqind e të rinjve i ndiqte këto programe disa herë gjatë javës, këtë vit 34 përqind e tyre e bëjnë këtë gjë. Programet humoristike kryesore janë një ose disa herë në javë në programacionin etelevizioneve kryesore.

Programet me debate politike gjithashtu kanë pësuar një rritje të lehtë shikueshmërie. Në 2011 vetëm 14 përqind i ndiqte këto debate disa herë në javë ndërkohë që tashmë rreth 22 përqind e të rinjve indjekin këto debate 2-3 herë në javë. Megjithatë duket se debatet politike nuk i interesojnë një pjese të konsiderueshme të të rinjve, pasi 34 përqind thonë se nuk i ndjekin kurrë ato ndërsa 18 përqind pohon se ndjek ato shumë rrallë.


Edhe lojërat e fatit e kuicet televizive ndiqen pak nga të rinjtë. Gjysma e të rinjve të intervistuar nuk i sheh ato apo i ndjek mjaft rrallë. Shumica e të rinjve që i ndjek këto programe, rreth 27 përqind, e bën këtë një herë në javë.

Programet me përmbajtje fetare kanë numrin më të pakët të shikuesve mes të rinjve ku 66 përqind e tyre pohojnë se nuk indjekin kurrë ato. 16 përqind thonë se i ndjekin rrallë dhe vetëm 13 përqind indjekin tëpaktën një herë gjatë javës.

### 3.1.3 Interneti

Aksesi i rinjve shqiptarë në Internet ka mbetur i pandryshuar nëse e krahasojmë me të dhënat e sondazhit të katër viteve më parë. Rreth 85 përqind të tyre pohojnë se kanë akses në Internet ndërsa 15 përqind nuk kanë akses të tillë.

#### A4. Aksesi ne internet



Meshkujt kanë një akses më të mirë në internet sesa femrat dhe këtë pohim e bëjnë afro 90 përqind e tyre përkundër 80 përqind të femrave. Duke u larguar nga kryeqyteti vërejmë se ulet përqindja e të rinjve që kanë akses në internet. Nëse në kryeqytet janë 97 përqind e të rinjve në zonat rurale kjo përqindje zbret në 79 përqind

#### Shpërqendrimi që vjen nga bota ‘www’


Aksesi në internet vijon të ngelet problematik për të rinjtë të cilët banojnë në zonat rurale/periferike. Megjithatë disa prej tyre shprehen se mungesa e aksesit të rregullt në Internet ( në shtëpi) është një zgjedhje personale apo familjare në mënyrë që mos të shpërqendrohen, më shumë sesa çështje mundësie.

**Të rinj nga zonat rurale të rrethit Tiranë thonë se *“Zgjedhja ime [të mos kem internet në shtëpi] dhe kompjuteri është në raste kur jam pushim... kur jam e ngarkuar me mësim nuk e përdor se mund të më shpërqëndroj prandaj” si dhe “Arsyeja e parë pse unë nuk e mbaj internetin në shpi është se të them të drejtën edhe nëse do e kisha do isha shumë i varur ndaj tij.”***

Opinioni i përhapur se Interneti ka fuqinë tu “vjedhë” të rinjve një pjesë të mirë nga koha që u duhet për të mësuar është mjaft i debatueshëm. Nga ana tjetër kjo është një ide interesante kur të rinj nga zonat urbane dhe ato rurale pohojnë se shpesh është vetë shkolla që kërkon përdorimin e Internetit për detyra dhe projekte të ndryshme.

Me kalimin e viteve koha që të rinjtë shpenzojnë në Internet është rritur. Në 2011 mesatarisht të rinjtë kalonin 2.9 orë në Internet ndërkohë që në vitin 2014 kjo kohë është 3.2 orë. Meshkujt shpenzojnë 3.5 orë mesatarisht në krahasim me femrat që shpenzojnë pak më pak sesa 3 orë (2.9).


**A5. Mesatarisht, sa ore ne dite shpenzoni ne internet?**



Qëllimet e përdorimit të Internetit për të rinjtë nuk kanë ndryshuar. Rreth 85 përqind e të rinjve pohojnë se përdorimi më i shpeshtë i Internetit nga ana e tyre vjen për arsye të rrjeteve sociale (Facebook, Tëitther, etj). Kjo ndiqet nga ¾ e të rinjve që deklarojnë si arsye të dytë përdorimin e Internetit për të chatuar me miqtë ndërsa 60 përqind theksojnë se e përdorin atë për të ndjekur video dhe dëgjuar muzikë online.

Ndërkohë përdorime të tjera të zakonshme të internetit nga ana e të rinjve lidhen me leximin e lajmeve (45 përqind), kërkimin e informacioneve të ndryshme për qëllime shkolle ose pune (44 përqind) si dhe lojrat online (35 përqind). Një e treta e të rinjve thonë se përmes Internetit dërgojnë postë elektronike (email) ndërsa 22 përqind e tyre shkarkojnë libra apo filma. Të rinjtë e përdorin shumë rrallë Internetin për të bërë blerje online (më pak se 10 përqind) ose për të menaxhuar llogarinë e tyre bankare (numër i papërfillshëm).

A6. Cilat janë arsyet kryesore se pse ju personalisht e përdorni internetin?



Një ndryshim që vihet re në kohë është përdorimi Internetit si burim informacioni për lajmet dhe aktualitetin. Numri i të rinjve që raporton këtë lloj përdorimi të Internetit është dyfishuar (nga 24 përqind në 2011 ka arritur 45 përqind në 2014).

## 3.2 Shpenzimi i parave

Shpenzimet mesatare mujore të të rinjve shqiptarë janë kryesisht për blerjen e veshjeve, këpucëve aksesorëve të ndryshëm dhe për frekuentimin e lokaleve, kafeneve e restoranteve. Në këtë mënyrë të rinjtë shqiptarë shpenzojnë mesatarisht 3900 lekë në muaj për blerjet dhe 4600 për daljet nëpër lokale. Blerja e kartave për telefonat celularë ju kushton të rinjve mesatarisht 1000 në muaj. Ndërkohë shifra më të vogla shpenzohen për blerjen e librave (540 lekë në muaj), DVD ose filmat në kinema (më pak se 300 lekë në muaj) si dhe shërbime të ndryshme si palestër apo estetikë (rreth 700 lekë në muaj). Nëse marrim të mirëqenë një të ri që kryen të gjitha këto shpenzime, totali i buxheti për të cilin ai ka nevojë çdo muaj i kalon 10,000 lekët.

Në këtë drejtim vihen re dallime gjinore përse i përket masës së shpenzimeve. Meshkujt konsumojnë një buxhet më të lartë sesa femrat, pasi realizojnë shpenzime dyfish më të mëdha për frekuentimin e lokaleve dhe bareve. Nëse femrat shpenzojnë 2600 lekë në muaj për këtë qëllim të rinjtë meshkuj harxhojnë rreth 5000 lekë. Gjithashtu meshkujt kryejnë shpenzime më të mëdha edhe përse i përket blerjes së veshjeve e aksesorëve teksa ata harxhojnë 4900 lekë në muaj përkundër 4100 lekë të harxhuara nga femrat.

Dallimet mes të rinjve nga shtresa të ndryshme ekonomike pasqyrohen në mënyrë të dukshme në shpenzimet e tyre mujore. Kështu të rinjtë nga shtresat më të pasura të shoqërisë harxhojnë mbi 6000 lekë në muaj qoftë për blerjet apo për frekuentimin e lokaleve, restoranteve si dhe mbi 1200 lekë për shërbime si palestër dhe estetikë. Totali i shpenzimeve të të rinjve që vinë nga shtresat e pasura është 16,000 lekë në muaj.

Kategoria e shpenzimeve	Vlerat mujore mesatare
Për të parë filma (kinema/blerje dvd-sh etj)	240
Për të frekuentuar kafenetë/baret/restorantet/pub-et	3870
Për të blerë veshje/këpucë/aksesorë	4560
Për karta telefoni /fatura telefoni	1000
Për të blerë libra	540
Për shërbime si parukeri/estetikë/palestër/pishinë	720
<b>TOTALI 10930</b>	


### 3.2.1 Çfarë është në modë

Sipas të rinjve të intervistuar dy nga karakteristikat që janë më shumë në modë mes tyre kanë të bëjnë me pamjen e jashtme. Respektivisht 93 dhe 88 përqind e të rinjve pohojnë se të dukesh dhe të vishesh bukur me rroba të firmave të njohura është dicka shumë në modë. Këto ndiqen nga karakteristika që lidhen me formimin dhe angazhimin profesional. Në këtë kuadër 82 përqind të të rinjve pohojnë se është në modë të mbarosh studimet e larta dhe të bësh karrierë ndërsa 10 dhe 12 përqind e tyre nuk i shohin këta elementë si dicka të modës për të rinjtë.

Nga ana tjetër 68 përqind të rinjve e konsiderojnë të ushqyerin në mënyrë të shëndetshme si dicka në modë por ndërkohë një e treta e tyre mendojnë të kundërtën. Në këtë rast vërejmë se ka një ulje të lehtë në numrin e të rinjve që e cilësojnë ushqyerjen e shëndetshme në modë pasi në vitin 2011 kjo shifër ka qenë 75 përqind.

Kur flitet për martesën duket se ajo nuk është në modë për shumicën e të rinjve. Rreth 30 përqind e tyre pohojnë se martesë nuk është aq në modë ndërsa 25 përqind e cilësojnë martesën komplet jashtë mode. Megjithatë janë 42 përqind e të rinjve që vazhdojnë ta konsiderojnë atë si dicka që është në modë.

**A8. Për secilën nga alternativat që do t'ju përmend, a mund të më thoni nëse janë në modë apo jashtë mode PËR JU?**



Po ashtu pjesëmarrja nëpër nisma të ndryshme qytetare shihet si dicka e modës vetëm nga 42 përqind të të rinjve ndërkohë që pjesa tjetër i cilëson ato ose si iniciativa që nuk janë shumë në modë ose jashtë mode. Megjithatë përkundër rezultateve të vitit 2011 vihet re se ka një rritje të qenësishme të numrit të të rinjve që besojnë se nismat qytetare janë në modë. Para katër vitesh ishin vetëm 28 përqind e të rinjve që besonin tek dicka e tillë.

Përsa i përket komenteve të tyre mbi pjesëmarrjen në politikë, vetëm 40 përqind e të rinjve besojnë se politika është në modë ndërsa një në pesë të rinj e cilësojnë atë si dicka jashtë mode.

Megjithë tabutë urbane dhe diskutimin mediatik konsumi i marijuanës konsiderohet jashtë mode nga 58 përqind të rinjve ndërsa 15 përqind e tyre e vlerësojnë atë si dicka jo dhe aq në modë. Gjithsesi një e katërta e të intervistuarve pohojnë se marijuana është në modë. Popullariteti i marijuanës rritet gradualisht tek të rinjtë me kalimin nga shtresat më në




nevojë të shoqërisë tek ato më të pasura ku përqindja e të rinjve që besojnë se tymosja e marijuanës është në modë. arrin në nivelin 32 përqind

### 3.3 Aspekte të tjera të stilit të jetesës

#### 3.3.1 Konsumi i duhanit dhe alkolit

Sipas të dhënave të këtij sondazhi konsumi i duhanit luhatet tek të rinjtë mes shifrave të 17 përqind të atyre që janë përdorues të përditshëm dhe 10 përqind duhanpirës rastësorë. Rreth 73 përqind e të rinjve pohojnë se nuk pinë duhan. Në këtë kuadër konsumi i duhanit është ulur ndjeshëm në të dy kategoritë në krahasim me të dhënat e viti 2011, para katër vitesh 23 përqind raportonin se ishin përdorues të rregullt dhe 14 përqind e pinin duhanin me raste.


##### A9. A pini cigare?



Gjithashtu vërehen dallime të mëdha gjinore mes duhanpirësve të rinisë shqiptare. Rreth 30 përqind e meshkujve janë përdorues të përditshëm të duhanit ndërkohë që 88 përqind e femrave thonë se nuk pinë duhan as rastësisht. Sërisht vërejmë të dhëna se duhani konsumohet edhe në moshat minorene, pasi afro 30 të rinj nën 18 vjec kanë rrëfyer se konsumojnë duhanin.


Përsa i përket konsumit të alkoolit janë më shumë sesa gjysma e të rinjve të intervistuar, rreth 56 përqind të cilët mohojnë se e përdorin alkolin. Në këtë renditje ata ndiqen nga 29 përqind e tyre që pohojnë se pinë alkolin rrallë, 6.6 përqind se e përdorin atë vetëm gjatë fundjavave dhe rreth 6 përqind të tjerë e përdorin me raste. Megjithatë numri i atyre që pohojnë se janë përdorues të rregullt të alkoolit është shumë i vogël (nën 2 përqind).

#### A10. A pini Alkol?




Në të gjitha rastet e përdorimit të akoolit nga të rinjtë femrat dallojnë nga meshkujt pasi zënë përqindjen më të madhe mes grupit që deklarojnë se nuk pinë alkol dhe më të voglën mes atyre që pohojnë se pinë me raste. Sic mund të jetë e kuptueshme vërehet një konsum pak më i madh i alkoolit nga të rinjtë në kryeqytet krahasuar me zonat e tjera urbane si dhe ato rurale.

**A11. Konsumi i alkoolit është:**



Në gjykimin e tyre mbi konsumin e alkoolit, shumica e të rinjve, 57 përqind e vlerësojnë atë si të papranueshëm për normat shoqërore. Pjesa tjetër e gjykon të nevojshëm për të mbajtur rrethin shoqëror (me 12 përqind) ose të pranueshëm (28 përqind).

**A12. Kenaqësia me pamjen e jashtme**




Shumica dërrmuese e të rinjve shqiptarë janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me pamjen e tyre të jashtme duke treguar nivel të fortë të qënurit konfort me veten e tyre. 13 përqind thonë se janë disi të kënaqur dhe vetëm një pakicë shumë e vogël tregon se është e pakënaqur.

### 3.3.2 Aktiviteti seksual

Të pyetur mbi aktivitetin e tyre seksual, 36 përqind e të rinjve mohojnë të kenë kryer marrëdhënie seksuale. Një e treta e të rinjve thonë se kanë kryer marrëdhënie me një partner ndërkohë që rreth 19 përqind pohon marrëdhënie me më shumë sesa një partner. Shifra e atyre që refuzojnë ti përgjigjen kësaj pyetjeje këtë vit është 8 përqind.


**A13.** Cila nga keto pohime percakton aktivitetin tuaj seksual?



Nga përgjigjet e të rinjve vërejmë diferenca të theksuara gjinore në raportimin e aktivitetit seksual. Kështu rreth 50 përqind e femrave mohojnë të kenë kryer marrëdhënie seksuale në krahasim me 23 përqind të meshkujve në të njëjtën situatë. Ndërkohë që 35 përqind e meshkujve rrëfejnë se kanë pasur marrëdhënie më shumë se një partner, numri i vajzave në këtë nëngrup është shumë i vogël (nën 3 përqind).

Përdorimi i masave mbrojtëse në aktivitetin e tyre seksual është tema tjetër për të cilët janë pyetur të rinjtë shqiptarë. Rreth 30 përqind e tyre pohojnë se i përdorin rregullisht këto masa ndërkohë që 29 përqind i përdor ato me raste. Plot 23 përqind thonë se nuk i përdorin masat mbrojtëse në marrëdhëniet e tyre seksuale. Këtë vit numri i atyre që refuzojnë të japin informacion mbi këtë çështje është mjaft i lartë rreth 17 përqind.

A14. Përdorimi i masave mbrojtëse




Meshkujt kryesojnë në përdorimin e masave mbrojtëse me 40 përqind të tyre që përdorin mbrojtje në mënyrë të rregullt në krahasim me vetëm 16.6 përqind të femrave që thonë të njëjtën gjë. Po ashtu numri i femrave që nuk përdorin kurrë masa mbrojtëse është shumë më i lartë, afro 36.6 përqind përkundër meshkujve me 14.5 përqind.

Vlerësimi i virgjërisë, si një aspekt shpesh tabu në shoqëri patriarkale si Shqipëria, është një mundësi për të mbledhur informacion mbi atë cka ata konsiderojnë vlerë apo mbetje nga e kaluara. Edhe pse koha ka sjellë dinamika të ndryshme për këtë koncept, rreth 22 përqind e të rinjve beson se virgjëria është një vlerë e rëndësishme për të dyja gjinitë. Shumica, 35.5 përqind, gjithsesi e sheh virgjërinë si vlerë për femrat. Rreth 32 përqind e

të rinjve mendojnë se virgjëria nuk është vlerë përkundrazi është ose një koncept i vjetëruar (19.4 përqind) ose akoma më keq një barrë psikologjike mbi individin (12.4 përqind). Rreth 10 përqind e të rinjve nuk kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje.

A15. Vlerësimi për konceptin e virgjërisë



Dallimet më të thella në këtë vlerësim janë ato midis Tiranës, zonave urbane dhe zonave rurale. Duke u larguar nga Tirana dhe duke ju afruar zonave rurale vlera e virgjërisë rritet dhe numri i atyre që mendojnë se është një koncept i vjetëruar ulet. Ndërkohë që në Tiranë plot 34 përqind e të rinjve e nxjerrin virgjërinë jashtë loje si dicka të vjetëruar por në zonat e tjera këto numra janë më të vegjël: 20 përqind për zonat e mëdha urbane, 18 përqind për qytetet e tjera dhe 14.5 përqind për zonat rurale. Po të njëjtën prirje pasqyrojnë shifat e të rinjve që e cilësojnë virgjërinë si një barrë psikologjike, ku në Tiranë përmendet nga mbi 20 përqind e të rinjve ndërkohë që në zonat e tjera maksimumi arrin në 12 përqind. Ndryshe nga pritshmëritë përkatësia gjinore në këtë rast nuk ka treguar ndryshime të qenësishme në vlerësimin e të rinjve mbi virgjërinë.

## 4. Përfundime

Një ndër rezultatet më domethënëse në këtë sondazh është që të rinjtë në Shqipëri kalojnë rreth 6.5 orë përpara ekranit të televizorit ose duke lundruar në Internet (përpara një ekrani kompjuteri apo celulari). Ky nivel i lartë i konsumit të medias dhe Internetit lë pak kohë për aktivitete të tjera cka pasqyrohet qartë tek orët e pakta të praktikimit të sportit, të leximit apo dhe angazhimit vullnetar. Qëndrimi me kohë të gjatë përballë televizorit, së bashku me faktorë të tjerë ka ndikuar që të rinjtë ta lidhin cdo gjë në modë vetëm me aspekte të pamjes së jashtme. Përballë rëndësisë që ka pamja dhe veshja të rinjtë kanë filluar të sfidojnë e nxjerrin si jashtë mode konceptet e institucione tradicionale sic është martesja. Në këtë drejtim ata kanë filluar të ndryshojnë perceptimet mbi virgjërinë, pasi e një e treta e të rinjve nuk e konsideron atë si një vlerë por si një tabu që vjen nga e kaluara dhe që nuk figuron në psikologjinë e tyre. Nga ana tjetër ndjekja e shijeve dhe plotësimi i nevojave të ndryshme që kanë të rinjtë ju kushton shtrenjtë familjeve shqiptare. Ato vazhdojnë të jenë në masë të gjerë financuesit e tyre kryesorë dhe një i ri ka nevojë për mbi 10.000 lekë në muaj për veshjen, frekuentimin e lokaleve, bareve, blerjen e librave dhe aktivitete të tilla si sporti, kinemaja apo shërbimet estetike.

## 5. Rekomandime

- Leximi po humbet pikë nga viti në vit në parapëlqimet e të rinjve dhe sidomos te meshkujt. Inkurajimi i të lexuarit tek të rinjt, mbetet një sfidë që duhet ndërmarrë nga institucionet arsimore apo aktorë të shoqërisë civile që merren me edukimin e të rinjve. Hapësirat publike ku mund të inkurajohet leximi mungojnë pothuajse plotësisht jashtë kryeqytetit, cka duhet ti jepet një rrugëzgjdhje nga pushteti lokal.
- Shumë të rinj shqiptarë ende nuk kanë kuptuar në mënyrë të mjaftueshme rëndësinë dhe të mirat e përdorimit të masave mbrojtëse gjatë jetës seksuale. Të gjitha institucionet përgjegjëse, ato të shëndetit publik, arsimit, OJF-të përkatëse dhe media duhet të angazhohen për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin sidomos mes femrave të reja.
- Të rinjtë duhet të edukohen dhe ndërgjegjësohen lidhur me elementët e një jetese aktive e të shëndetshme. Koha e tejzgjatur që kalojnë para televizionit dhe Internetit, nivelet e ulta të praktikimit të sportit si dhe përdorimi i alkolit dhe duhanit (këto të fundit në masë më të konsiderueshme te meshkujt) janë aspekte që rrezikojnë shëndetin e popullatës së re në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Për këtë arsye nevojiten politika konkrete për ti trajtuar për të parandaluar kostot sociale në të ardhmen.







**KAPITULLI VI:**

DEMOKRACIA  
&  
QEVERISJA

Përgatitur nga: **Geron Kamberi**

## 1. Hyrje

Demokracia dhe Qeverisja mbeten ndër përparësitë kryesore duke pasur parasysh se të rinjtë janë ndër shtresat dhe grupmoshat që preken drejtpërdrejt nga mbarëvajtja e këtyre treguesve. Pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar Shqipëria të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të besojnë se ata ndeshen me një sërë elementesh që burojnë nga tranzicioni i tejzgatur dhe i vështirë ku i bashkëshoqërojnë varfëria, papunësia, pasiguria për të ardhmen. Përballë këtyre sfidave e vështirësive ata përpiqen të përcaktojnë sjelljet dhe qëndrimet duke synuar të vlerësojnë realitetin dhe të dallojnë perspektivën për të ardhmen. Shqipëria ka një moshë mesatare të popullsisë së re me rreth 28 vjeç dhe në 3 milionë banorë pothuajse 420 mijë janë të moshës 18-24 vjeç.

Në këtë mënyrë sjellja e tyre elektorale dhe vlerësimi që kanë për gjendjen e qeverisjes dhe demokracisë në vend ka ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet zgjedhore dhe rotacionet e pushtetit .Nga ana tjetër cilësia e qeverisjes dhe demokracisë në vend janë tregues kryesorë që dëshmojnë nivelin e optimizmit rinor dhe qëndrimet e tyre karshi së ardhmes . Cdo nivel imosbesimit të të rinjve shqiptarë tek institucionet rrit shkallën e pesimizimit mes tyre dhe apatinë sociale duke i shtyrë drejt emigrimit. Humbja e besimit tek demokracia dhe mekanizmat e saj si mjete për ndryshim i bën të rinjtë votues pasivë dhe pa forcën e duhur. Krijimi i hapësirave dhe mundësive për të rinjtë që të përmirësojnë procesin demokratik dhe qeverisës është një sfidë e vazhdueshme për traditën e re demokratike të shoqërisë e politikës shqiptare.

## 2. Gjetjet kryesore

- 55.1 përqind e të rinjve e shohin moszbatimin e ligjit si elementin më shqetësues të shoqërisë shqiptare, ku të rinjtë e shtresave të varfra e ndjejnë më shumë këtë problematikë se të rinjtë e shtresave të pasura.
- 96.4 përqind e të rinjve në nivel kombëtar e konsiderojnë nivelin e papunësisë dhe varfërisë si shqetësimin më kryesor madje ai përfshin edhe të rinjtë e shtresave të pasura.
- 73 përqind e të rinjve nuk ndjehen të sigurt për vendin e punës mes të cilëve përfshihen edhe të rinjtë e shtresave të pasura dhe ata me arsimim pasuniversitar.
- Kërcënimi nga përhapja e HIV/AIDS mbetet i lartë mes të rinjve por në raport me nivelin e të ardhurave dhe të arsimimit ai mbetet më pak kërcënues.
- 64.1 përqind e të rinjve në nivel kombëtar besojnë se ndryshimi i gjendjes ekonomike në 10 vitet e ardhshme do të jetë modest.
- Vetëm 11 përqind e të rinjve janë shumë të interesuar në zhvillimet politike të vendit ku të rinjtë meshkuj janë më të interesuar për këto zhvillime sesa femrat.
- Të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të jenë të painteresuar për zhvillimet politike jashtë vendit ku vetëm 13.8 përqind e të rinjve janë të interesuar për ato në Ballkan dhe 15.9 përqind për zhvillimet në politikën ndërkombëtare.
- 70 përqind e të rinjve shqiptarë kanë bindje politike të cilat përputhen gjerësisht ose përafërsisht me atë të prindërve.
- Televizioni është burimi kryesor i informacionit për të rinjtë shqiptarë, por interneti po shndërrohet në mjetin e dytë më të rëndësishëm informues përvec bisedave me miqtë e të njohurit.

- Rreth 83% e të rinjve mendojnë se vota blihet gjatë procesve zgjedhore por shumë pak prej tyre deklarojnë se prindërit apo ata janë përballur me një eksperiencë të tillë
- Shkalla e besimit të të rinjve tek institucionet kryesore të demokracisë është e ulët duke cuar në apatinë e tyre sociale
- Të rinjtë besojnë se vota e tyre nuk ka ndonjë ndikim në mënyrën se si qeverisen institucionet.
- Vetëm një grup shumë i vogël të rinjsh (3.8 përqind) ndihen shumë të përfaqësuar nga të rinjtë në politikë. Pjesa më e madhe e të rinjve ndihen pak të përfaqësuar (33 përqind) ose aspak të përfaqësuar (30.8 përqind).

## 3. Analiza e detajuar e rezultateve

### 3.1 Qeverisja dhe elementët e saj

Një ndër elementët ku vërehet ndikimi që ushtron qeverisja mbi të rinjtë është moszbatimi i legjislacionit. Në nivel kombëtar të dhënat tregojnë se përkundër vitit 2011 është rritur përqindja e të rinjve të intervistuar nga 49.3% në 55.1 përqind që pohojnë se moszbatimi i legjislacionit është shumë shqetësues. Në këtë kuadër sërish vërehet se përqindja më e lartë u përket të rinjve nga Tirana me 62.5 përqind përkundërsht atyre në zonat rurale me 54.8 përqind

Një nga treguesit që moszbatimi i legjislacionit është shqetësues dhe përzgjedhës është edhe raporti mes të rinjve të varfër dhe të pasur ku këta të fundit kanë një përqindje më të ulët shqetësimi për këtë problem me 51.5 përqind përkundërsht të tjerëve me 57.1 përqind. Nga ana tjetër, me rritjen e moshës dhe nivelit të arsimit vërejmë një rritje të ndërgjegjësimit dhe shqetësimit për moszbatimin e legjislacionit si pjesë e qeverisjes. Në të njëjtën kohë vërejmë një dallim mes të rinjve nga zona e Tiranës dhe qyteteve të tjera që janë në një përqindje më të lartë për ta konsideruar moszbatimin e legjislacionit si një problem shumë shqetësues respektivisht me 69.5 përqind dhe 78.4 përqind përkundërsht atyre në veri ku ky shqetësim zbritet në 60.8 përqind. Megjithatë në raport me të dhënat e vitit 2011 vërejmë se krahasuar me treguesit e sipërpemndur është rritur përqindja e të rinjve që besojnë se moszbatimi i ligjit mbetet një problem shumë shqetësues

Për sa i përket nivelit të krimit të rrugës dhe trafikeve të ndryshme si pjesë e qeverisjes së sigurisë publike vërejmë se ato përbëjnë nivele të ndryshme shqetësimi dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë te të rinjtë. Në këtë mënyrë 49 përqind e të rinjve të intervistuar në shkallë vendi e shohin krimin e rrugës si problem shumë shqetësues përkundër 41.1% në vitin 2011. Femrat sërish ndjehen më të rrezikuara me 54 përqind përkundërsht djemve me 44 përqind, dhe të dyja shifrat tregojnë për rritje të këtij shqetësimi në krahasim me vitin 2011 (43.3% femrat dhe 39.1% djemtë). Të dhënat e vitit 2014 dëshmojnë se janë të rinjtë e qyteteve të tjera që e ndjejnë më shumë këtë kërcënim të krimit të rrugës teksa

55.7% e shprehin këtë shqetësim përkundër 46.7% të të rinjve nga Tirana dhe zonat rurale. Ky është një tregues se qytetet e tjera për shkak të krizës ekonomike, emigracionit të paktët, veçanërisht në Itali e Greqi ndjehen më të prekura nga krimi i rrugës. Një e dhënë tjetër interesante është se vazhdon prirja ku të rinjtë e shtresave të varfra preken më shumë nga krimi i rrugës me 42.9 përqind përkundrejt 48.1 përqind të atyre që vijnë nga shtresat e pasura.

Ndërsa lidhur me trafiqet e ndryshme, 52.9 përqind e të rinjve i shohin ato si një problem shqetësues ku për vetë natyrën e këtij kërcënimi sërish femrat kanë një përqindje më të lartë vlerësimi me 54 përqind përkundrejt meshkujve me 44.1 përqind. Është interesante se vazhdon të mbetet i njëjtë niveli i shqetësimit për të rinjtë nga Tirana me ata të fshatit, respektivisht 46.7 megjithëse shënon një ulje në përqindje në krahasim me vitin 2011 kur shpreheshin 54.7%. Ndërkohë në raport me vitin 2011 vërejmë se është rritur numri i të rinjve në qytetet e tjera që e shohin si shqetësim të madh problemin e trafiqueve të ndryshme nga 40 dhe 42.9% në 55,7 dhe 50.7%

Nga ana tjetër, 50.8 përqind e të rinjve të intervistuar i konsiderojnë kërcënimet nga sulmet terroriste si shumë pak ose aspak shqetësim, duke shënuar një rënie të këtij shqetësimi në krahasim me vitin 2011 kur kjo shifër ishte 62.1%. Por ka një rritje nga 20 përqind në 27% të numrit të të rinjve që i konsiderojnë kërcënimet nga sulmet terroriste një shqetësim të madh. Tek ata që i konsiderojnë ato si të tilla bie në sy se me rritjen e shkallës së informacionit dhe arsimimit kemi një përqindje më të lartë në vlerësimin e tij si një problem shqetësues. Por të rinjtë që jetojnë në qytete të tjera janë më të ndjeshëm ndaj kërcënimit të sulmeve terroriste si problem shqetësues në respektivisht me 39.2 përqind përkundër atyre që jetojnë në Tiranë me 25.8% Kjo është një prirje e përmbysur në krahasim me vitin 2011 që mund të ketë lidhje me situatën e shpërthimeve që pasoi në disa qytete të vendit në gjysëm e dytë të vitit 2013 e më tej si edhe me fenomenin e luftëtarëve shqiptarë që u identifikuan në disa qytete pasi ishin përfshirë në konfliktet e Lindjes së Mesme

Për shkak të shkallës së lartë të emigracionit veçanërisht në vendet fqinje si Italia e Greqia, ku shumicën e emigrantëve e përbënin të rinjtë problemet e ruajtjes së identitetit përballë mbijetesës ekonomike mbeten në një problem. Megjithatë kjo prirje është në rënie pasi në krahasim me

vitin 2011 kur për këtë shpreheshin 36.9 përqind e të rinjve në shkallë vendi, tashmë vetëm 22.2% e konsiderojnë këtë një shqetësim. Edhe meshkujt e shohin më me pak shqetësim këtë element teksa vetëm 20% e tyre në vitin 2014 përkundër 40.2 përqind në vitin 2011. Duke qenë se ky fenomen ka përfshirë emigrantët në Greqi, tashmë shkak të krizës së stërzgatur ekonomike në Greqi ky presion është pakësuar dhe Greqia nuk përbën më një vend tërheqës për emigrantët e rinj që do ta shkëmbejnë qoftë edhe me ndryshimin e identitetit. Përsa i përket dallimit mes të rinjve që vinë nga shtresat e ndryshme të dhënat e vitit 2014 tregojnë se të rinjtë e pasur nuk e shohin më këtë si një problem duke qenë se 62.4% e tyre e konsiderojnë pak ose shumë pak si shqetësim ruajtjen e identitetit përballë mbijetesës ekonomike mbeten në një problem. Kjo mund të jetë rrjedhojë e faktit se këta të rinj për shkak të burimeve financiare nuk kanë nevojë të emigrojnë në ato vende ku duhet të luajnë me identitetin e tyre sikurse kanë prirje kozmpolite si rrjedhojë e stilit të tyre të jetës.

### 3.1.1 Problemet e zhvillimit


Varfëria dhe papunësia janë ndër çështjet kryesore të zhvillimit që prekin drejtpërdrejt perspektivën e jetesës së të rinjve. Në këtë mënyrë rritja e varfërisë vazhdon konsiderohet shqetësuese për 96.4 përqind të të rinjve në shkallë vendi. Ajo që vlen të theksohet është se edhe për të rinjtë e shtresave të varfra dhe të pasura niveli i përqindjes është pak a shumë i përafërt ku 94.1 përqind e të rinjve nga shtresat e varfra e konsiderojnë shqetësim të madh përkundërt 95 përqind të atyre të pasur. Nga të dhënat e anketimit të vitit 2014 vërejmë se pavarësisht nivelit arsimor, prejardhjes pasurore apo krahinore dhe dallimit moshor pothuajse të gjithë të rinjtë e këtyre kategorive shprehen mbi 90% se varfëria përbën një problem shqetësues që cënon drejtpërdrejt zhvillimin e shoqërisë.

Edhe niveli i papunësisë përbën një shqetësim në një shkallë të madhe për 95.6 përqind të të rinjve të intervistuar, çka tregon rëndësinë e këtij elementi për ta. Vërejmë se ky është një shqetësim i përgjithshëm që prek si të rinjtë e varfër, ashtu edhe ata të pasur me një përqindje të përafërt;



respektivisht me 94.5 përqind dhe 95.8 përqind. Madje përqindja e të rinjve të pasur është pak më e lartë në raport me të ata që vijnë nga shtresat e varfra kur shprehen qoftë për varfërinë apo papunësinë. Ky shqetësim shpreh perceptimin e përgjithshëm ku në një treg me mundësi të pakta punësimi edhe të rinjtë e shtresave të pasura nuk e kanë të lehtë të krijojnë individualitetin e pavarësinë e tyre që vjen përmes punës. Ndërkohë me rritjen e moshës ky shqetësim bëhet edhe më i dukshëm dhe përbën një problem shumë shqetësues edhe 96% pe të rinjve shumë të kualifikuar siç janë ata me arsim universitar (apo pasuniversitar).

**G1. Shkalla e shqetësimit që provokojnë problemet**



***Politika, punësimi dhe drejtësia, sfidat kryesore të vendit sipas të rinjve në Shqipëri***

Politika, punësimi, drejtësia, dhe siguria janë problemet kryesore në vend sipas të rinjve në grupet e diskutimit. Shumë prej të rinjve e shohin politikën si shkaktare të problemeve të cilët ata hasin në jetën e përditshme. Të rinjtë shqiptarë shprehin gjithashtu mjaft rezerva për funksionimin e sistemit të drejtësisë, të cilin e vlerësojnë si të korruptuar dhe të paaftë.

***“Politika nuk po bën asgjë. Presim mos përmiresohen gjërat por asgjë nuk ndryshon.” (Tiranë, Urban)***

***“Drejtësia, pra nëse ke ndonjë problem me drejtësinë, megjithëse mua nuk më ka rënë ndonjëherë rasti por mendoj se nuk do ta zgjidhja dot pa pasur në mes ndonjë devijancë.” (Tiranë, Urban)***

Edhe në rastet kur janë në marrëdhënie pune, të rinjtë shprehin një sërë qëndrimesh e vlerësimesh lidhur me pasigurinë e vendit të punës dhe rreziqet e jetës dhe shëndetit në punë. Në nivel kombëtar 73 përqind e të rinjve të intervistuar e konsiderojnë shqetësim të madh pasigurinë për vendin e punës. Kjo madje vihet re edhe në zonat rurale ku, megjithëse quhen të vetëpunësuar në sektorin bujqësor, të rinjtë ndjehen 75.4 përqind të pasigurt përkundrejt 78.4 përqind të atyre në zonat e tjera urbane. Ky është edhe një tregues i pamundësisë dhe larmisë së punësimit në zonat rurale. Është interesante se është rritur përqindja e të pasurve në krahasim me vitin 2011 nga 60.8 në masën 69.8 përqind të cilët shprehen ndjehen të pasigurt për vendin e punës përkundrejt 78.2% përqind të të varfërve, të cilët sërish kanë rritje të kësaj përqindje përkundër vitit 2011(72.5 %). Kjo pasiguri shkon duke u rritur me nivelin dhe hyrjen në moshë pune. Vërejmë sërish se pasiguria për vendin e punës është më e madhe mes të rinjve të zonës së jugut të vendit respektivisht 83.2 përqind përkundrejt atyre në veri me 60.8 përqind. Ndërkohë është me interes të theksojmë se kjo pasiguri mes tyre rritet pavarësisht arsimimit apo kualifikimit, teksa 72.7 përqind e të rinjve me arsim universitar apo pasuniversitar ndjehen të pasigurt përkundrejt 82.6 përqind të atyre me arsim para-universitar

Edhe kushtet në vendin e punës për të rinjtë që punojnë janë ndër elementët thelbësorë që ndikojnë në mbarëvajtjen e jetës së tyre. Në nivel kombëtar, 55.8 përqind e të rinjve të pyetur e vazhdojnë ta konsiderojnë shqetësim të madh rrezikimin e jetës dhe shëndetit në vendin e punës. Kjo prirje vazhdon të mbetet e pandryshuar në zonat rurale (57.8 përqind) përkundrajt zonave të tjera urbane (48.5 përqind) çka lidhet me natyrën ende të rëndë të punëve që kryejnë të rinjtë në fshat. Natyrisht të varfërit janë më të prekur ndaj këtyre rreziqeve me 65. përqind përkundrajt të rinjve të shtresave të pasura me 51.7 përqind, por këta të fundit kanë një rritje në krahasim me vitin 2011 kur përqindja mes tyre ishte 43.3%. Për moshat e reja që hyjnë herët në marrëdhënie pune këto përbëjnë një shqetësim më të madh ku të rinjtë e moshës 16-17 shprehen me 60.8 përqind përkundrajt atyre 18-22 vjeç me 53.4 përqind. Në jug të vendit rreziku dhe shëndeti në vendin e punës për të rinjtë sërish është një problem më shqetësues me 62.7 përqind përkundrajt atyre në veri me 48.4 përqind. Rritja e nivelit të arsimimit i ekspozon të rinjtë në punë më pak të rrezikshme prandaj përqindja e tyre bie sikurse janë para-universitarët me 65.1 përqind përkundrajt të rinjve universitarë me 50.6 përqind. Në këtë rast vërejmë se përkundër të dhënave të vitit 2011 është rritur përqindja e të rinjve parauniversitarë nga 55% në 65.1% që konsiderojnë shqetësim të madh rrezikimin e jetës dhe shëndetit në vendin e punës.

Përveç elementëve të mësipërm, edhe aspekte të tjera që lidhen me cilësinë e jetës siç është ndotja e mjedisit, ndryshimet e klimës, përhapja e HIV/AIDS apo sëmundjeve të ndryshme janë shqetësuese për të rinjtë.

Lidhur me ndotjen e mjedisit, 63.1 përqind e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar e konsiderojnë atë një shqetësim të një shkalle të madhe përkundrajt 26.9 përqind që e konsiderojnë shqetësim deri në njëfarë mase. Është interesant të vihet re se ka një përqindje më të madhe të të rinjve në fshat me 67.7 përqind që e konsiderojnë problem ndotjen e mjedisit përkundrajt 60.8 përqind të atyre në zonat e tjera urbane. Njëkohësisht një fakt interesant është përqindja e ulët e të rinjve në Tiranë me 55%, që shprehen se ndotja e mjedisit përbëmb shqetësim për ata duke dëshmuar një vetëdije të ulët mjedisore përballë problemeve

të shumta që ndeshen në Tiranë. Nga ana tjetër megjithëse është një element që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës vërejmë se përqindja e të pasurve që e konsiderojnë shqetësim ndotjen e mjedisit është më e ulët, respektivisht 57.1 përqind përkundrajt atyre të varfër me 65.1 përqind. Pothuajse të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga mosha, e konsiderojnë një problem shqetësues ndotjen e mjedisit. Madje të rinjtë e grupmoshës 16-17 vjeç shprehen një shqetësim më të madh me 66.1% përkundrajt të rinjve të moshës 18-22 vjeç me 61.8 përqind. Gjithashtu ndotja e mjedisit përbën një shqetësim më të madh tek të rinjtë e zonës qendrore e jug të vendit, respektivisht me 65.4 përqind, 70.3 përqind, përkundrajt atyre në veri me 52.5 përqind. Kjo lidhet me faktin se aktiviteti ekonomik pas viteve 90 që pati pasoja mbi mjedisin vecanërisht ndërtimi dhe manifaktura u përqëndrua në këto zona.

Në vijim të ndikimit të mjedisit si një element i rëndësishëm në mbarëvajtjen e jetës së tyre lidhur me ndryshimet e klimës, të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të mos shohin ndonjë problem për tu shqetësuar në raport me Shqipërinë. Vetëm 20.8 përqind e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar e konsiderojnë këtë si një shqetësim, 31.8 përqind në njëfarë mënyre një shqetësim, ndërsa 47.9 përqind e konsiderojnë shumë pak ose aspak një shqetësim. Në Tiranë kjo përqindje e të rinjve që e konsiderojnë një shqetësim të një shkalle të lartështë më e madhe se në fshat përkatësisht 24.7 përqind me 20.9 përqind çka flet sërish për një nivel të ulët ndërgjegjësimi në zonat rurale që janë më të prekura prej saj. Ndërsa të rinjtë e shtresave të varfra dhe të pasura kanë pak a shumë të njëjtin shqetësim për këtë çështje. Me rritjen e moshës kemi një ndërgjegjësim më të madh siç duket mes grup-moshave 16-17 vjeç me 18.6 përqind dhe 23-27 vjeç me 24.6 përqind, por në krahasim me vitin 2011 shiftra tregojnë një rënie të përqindjes së këtyre grupmoshave dhe ulje të mëtejshme të nivelit të tyre ndërgjegjësimit mbi ndikimet e ndryshimit të klimës në mjedisin ku jetojmë. Të bën përshtypje se tek të rinjtë me shkollim universitar e pasuniversitar ky nivel shqetësimi është më i ulët se tek ata me shkollim parauniversitar; respektivisht 51.4 përqind përkundrajt 64.5 përqind.

Përhapja e HIV/AIDS dhe rreziku nga sëmundjet kanceroze synojnë të shndërrohen në shqetësime për të rinjtë. Siç vërehet edhe nga rezultatet e pyetësorit, 39. përqind e të rinjve në nivel kombëtar e konsiderojnë shqetësim në një shkallë të konsiderueshme përhapjen e HIV/AIDS duke vënë re një ulje të këtij shqetësimi në krahasim me vitin 2011 kur kjo shifër ishte 43.5%. Vëmë re se mbetet dallimi mes zonave rurale me 41.0 përqind për shkak të rrezikut dhe frikës që ngjall mungesa e informacionit rreth këtij virusi përkundrejt të rinjve nga zonat e tjera urbane ku përqindja është 23.7 përqind. Por në të dyja rastet ka një reduktim të përqindjeve të të rinjve cka dëshmon për rritje të mëtejshme të ndërgjegjësimit të dyja grupeve rinore. Nga ana tjetër vazhdon të ruhet një dallim mes të rinjve të shtresave të pasura dhe atyre të varfra ku 42.2 përqind e të varfërve e konsiderojnë problem përkundrejt 39.7 përqind të të pasurve, çka nënkupton se këta të fundit zotërojnë një shkallë më të lartë informimi rreth masave mbrojtëse. Gjithashtu në grup-moshën 16-17 vjeç përqindja e të rinjve që e konsiderojnë atë një shqetësim është më e lartë, me 41.5 përqind përkundrejt atyre 18-22 vjeç me 35.4 përqind. Për këta të fundit për rritjes së shkallës së informacionit dhe pjekurisë ul nivelin e shqetësimit. Ndërkohë vërejmë një ndërgjegjësim më të madh të të rinjve nga zona e veriut lidhur me këtë fenomen, ku gjatë anketimit të vitit 2014 janë 42.9 përqind e tyre që e konsiderojnë përhapjen e HIV/AIDS një shqetësim përkundër 30.9% të tyre në vitin 2011

Kjo vjen si rrjedhojë e depërimit të normave e sjlljeve më liberale në këto zona por që shoqërohen edhe me kërcënime të kësaj natyre. Ndërkohë, me rritjen e shkallës së informimit dhe arsimimit ky problem pëson një ulje të përqindjes së të rinjve që e konsiderojnë shqetësim nga 44.9 përqind për para-universitarët tek 40.7 përqind të të rinjve universitarë.

Një tregues mjaft i rëndësishëm është përqindja e lartë e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar, ku 52.6 përqind e konsiderojnë shqetësim në një shkallë të madhe përhapjen e sëmundjeve kanceroze. Ky është një nive më i ulët shqetësimi krahasuar me vitin 2011 kur kjo shifër ishte 60.8%. Në këtë rast ka sërish një përqindje më të madhe të femrave (57.1 përqind) përkundrejt meshkujve (48.4 përqind), çka tregon ndikimin e

informacionit mediatik që është më i shumtë për sëmundjet kanceroze tek gratë si p.sh. kanceri i gjirit. Një element interesant përbën fakti se ky shqetësim është më i madh tek i të rinjtë nga zonat rurale me 55.4% përkundër atyre nga Tirana me 36 përqind.. Në këtë drejtim vërehet se të rinjtë nga shtresat e varfra ndjehen më të kërcënuar ndaj këtyre sëmundjeve me 55.9 përqind përkundërt të pasurve me 51.5 përqind. Nga pikëpamja e shpërndarjes gjeografike ka një vlerësim pak a shumë të njëjtë të këtij shqetësimi mes grupeve të rinjve respektivisht me 51.1 përqind në veri, 51.6 përqind në pjesën qendrore të vendit dhe 56 përqind e rinjve në Jug. Kjo dëshmon se këto sëmundje po bëhen njësoj të rrezikshme në të gjitha rajonet e vendit. Ndërkohë nuk vihen re dallime as mes të rinjve që kanë nivel të ndryshëm arsimor përse i përket nivelit të këtij shqetësimi madje janë 57% rinjtë parauniversitarë gjë përkundër 55% të atyre universitarë që e konsiderojnë këtë një problem shqetësues

Në vijim të vlerësimeve të mësipërme, të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të jenë sërish të përmbajtur kur është fjala për perspektivën e rritjes ekonomike dhe ndryshimin e gjendjes së tyre në 10 vitet e ardhshme. Vetëm 11.6 përqind e të rinjve të intervistuar mendojnë se gjendja ekonomike në 10 vjet do të ndryshojë shumë, ndërsa 64.1 përqind mendojnë se gjendja ekonomike e popullit shqiptar do të ndryshojë në mënyrë modeste. Në këtë rast nuk vërejmë ndonjë dallim mes meshkujve dhe femrave që kanë shprehur të njëjtin nivel në përqindje. Nivelin e optimizimit mes të rinjve të Tiranës dhe zonave rurale është pak a shumë i njëjtë respektivisht me 62.5% dhe 63.2%. Ndërkohë vërehet se të rinjtë nga shtresat e varfra e kanë shtuar nivelin e pesimizimit të tyre pasi përkundër vitit 2011 kur 65% shpresonin për një rritje modeste të ekonomisë në 10 vitet e ardhshëm tashmë janë vetëm 53.8% e tyre që pohojnë të njëjtën gjë. Të rinjtë nga pjesa qendrore e jugore e vendit janë pak më optimistë lidhur me një ndryshim modest të ekonomisë në 10 vitet e ardhshme respektivisht me 66.6% e 66.2% përkundër atyre që jetojnë në veri me 57.6%. Me rritjen e shkollimit vërehet një mbështetje e të rinjve që besojnë edhe për një rritje modeste ekonomike ku në raport me 63.8 përqind të të rinjve parauniversitarë që mbështesin këtë vlerësim, për të rinjtë me arsim universitar e pasuniversitar kjo përqindje është në 68.3%

## 3.2 Demokracia dhe Politika

### 3.2.1 Interesi dhe informacioni mbi politikën

Të rinjtë në Shqipëri nuk janë shumë të interesuar mbi zhvillimet politike në vend. Vetëm një grup i vogël prej tyre shprehet se është shumë i interesuar, por përqindja e tyre është më e ulët edhe se kategoria e të rinjve që janë krejtësisht të paimentuar. Ndërkohë, rezultatet e anketimit na tregojnë se të rinjtë kanë nivele të ndryshme interesi për zhvillimet politike në vend ku vetëm 7 përqind e të rinjve shprehen se janë shumë të interesuar, 20.8 përqind e tyre të interesuar, ndërsa 41. përqind janë të pa interesuar.

#### **Të rinjtë shqiptarë, të ndarë përsa i përket interesit të tyre mbi zhvillimet politike në vend**

Të rinjtë në Shqipëri janë të ndarë përsa i përket interesit të tyre për çështjet dhe zhvillimet politike në vend. Gjetjet e grupeve të diskutimit si dhe ato të sondazhit janë të ngjashme me ato të vitit 2011 në këtë aspekt. Sipas rezultateve të 2014, 40% e të rinjve shprehen të interesuar, ose shumë të interesuar për zhvillimet në vend. Shumë prej tyre shprehen mjaft të interesuar për zhvillimet e fundit politike në vend, duke u shprehur se i tërheqin emisionet e debatit mbi politikën në vend.. Disa të rinj gjithashtu shprehen se janë të interesuar kryesisht për faktin se prindërit e tyre janë aktualisht pjesë e administratës publike, dhe vendi i tyre i punës shpesh varet nga situata politike në vend.

***“Jam i interesuar për politikën. I ndjek të gjitha. Nuk e bëj këtë gjë për kënaqësi por për informim. Eshhtë pjesë e ndërgjegjes së një individi të jetë e informuar për atë që ndodh.”*** (Tiranë, Urban)

***“Në momentin që po flas tani më intereson për faktin lidhur me familjen sepse prindërit i kam në punë shteti dhe ktu ekziston akoma mundësia që nëse ndërrohen krahët politike ndërrohen edhe nënpunësit gjë që ka ndodhur para shumë vitesh.”*** (Tiranë, Urban)

***“Politika në Shqipëri është pjesë e pandashme e shoqërisë. Nëpërmjet politikës bëhen reformat këtu ne vendin tonë. Nëpërmjet pushtetarëve bëhen reformat. E ndjek se çfarë bëhet për shëndetësinë, ku edhe studioj për infermieri, më pëlqen kjo pjesë, por edhe në përgjithësi për arsimin, çështjet ekonomike, taksat. Ndjek disa emisione politike.. Më pëlqejnë.”***

(Tiranë, Rural)



Kur bëhet fjalë për zhvillimet politike që ndodhin jashtë Shqipërisë të rinjtë shqiptarë vazhdojnë të mbeten shumë të pa interesuar. Për sa i përket zhvillimeve politike në Ballkan vetëm 13.8 përqind e të anketuarve u përgjigjën se janë të interesuar, 36.3 përqind paksa të interesuar dhe 47.7 përqind janë të pa interesuar. Grupi i të rinjve të interesuar është më i vogël në Tiranë, me rreth 9 përqind, ashtu edhe grupi i të pa interesuarve me 48.5 përqind.

Të rinjtë nga qytetet e tjera dhe zonat rurale shfaqin një dallim të dukshëm në këtë drejtim ku vërehet një përqindje më e lartë e tyre qoftë në grupin e të interesuarve, ashtu edhe në atë të të pa interesuarve.

Ndërkohë rreth 15.9 përqind e të rinjve të anketuar u përgjigjën se ishin të interesuar për zhvillimet politike në shkallë botërore, ndërsa 36.9 përqind paksa të interesuar. Pjesa e atyre të rinjve që u shprehën të pa interesuar është rreth 36. përqind. Ndonëse në krahasim me vitin 2011 ka një rënie të lehtë të përqindjes së të rinjve që shprehen të pa interesuar për zhvillimet e politikës botërore nga 42.7% në 36% sërish mbetet i lartë niveli i apatisë dhe indiferencës mbi këto zhvillime duke patur parasysh globalizimin e pasojave që sjellin ngjarje të caktuara Kjo prirje mbetet e pandryshuar edhe në bazë të rritjes së grupmoshave e nivelit arsimor ku 40% e të rinjve universitarë e pasuniversitarë shfaqin një interes të pakët për zhvillimet e politikës botërore.





F1. Sa të informuar/interesuar janë prindërit tuaj në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me politikën?




Të pyetur nëse bindjet e tyre politike përkojnë me ato të prindërve të tyre, 31.7 përqind e të rinjve u përgjigjën se ato kanë një përputhje të madhe. Nga ana tjetër 35.7 përqind u shprehën se bindjet e tyre politike përputhen disi me ato të prindërve, duke përbërë 67.4 përqind të numrit të përgjithshëm të të rinjve të përzgjedhur për këtë anketë. Ndërsa rreth 13.7 përqind e të rinjve thonë që bindjet e tyre përputhen shumë pak me ato prindërve dhe vetëm 13.8 përqind u përgjigjën se bindjet e tyre politike nuk u përputhen aspak me ta. Të gjithë këto të dhëna megjithëse me ndryshime të vogla nga viti 2011( 29.1%; 32.3% ; 61.4%) përfocojnë prirjen drejt një unifikimi të mëtejshëm të bindjeve politike të të rinjve me ato të prindërve.

**F3.** Sa janë të ngjashme pikëpamjet e bindjet tuaja politike me ato të prindërve tuaj?



Për sa i përket informimit, televizioni vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit për të rinjtë shqiptarë ku rreth 87 përqind e tyre e përmendën atë si një burim të rëndësishëm gjatë anketimit. Përkundër të dhënave të vitit 2011 ku për 57.1 përqind të të anketuarve burimi i dytë më i përmendur i informacionit ishin bisedat me miqtë dhe të njohurit, në vitin 2014 39% e tyre pohojnë se është interneti burimi i dytë i informacionit duke e barazuar si burim informimi me bisedat në familje e me shokët. Ndërkohë vetëm 19 përqind, u shprehën se lajmet i merrnin nga gazetatat. Për shkak të varësive së ndryshme që krijojnë tek të rinjtë mjetet e informacionit, vërehet se të rinjtë në Tiranë janë më pak të varur nga televizioni sesa ato nga qytetet e tjera dhe zonat rurale. Një tregues interesant është se sërish të rinjtë nga qytetet jashtë Tiranës e përdorin internetin si burim informacioni më shumë sesa të tjerët rreth 47% e tyre përkundër 40% të atyre që janë në Tiranë

**F7. Cilat janë burimet kryesore të informimit tuaj në lidhje me zhvillimet politike?**




Nga të dhënat e anketimit vërejmë një lidhje të fortë edhe mes pasurisë dhe burimeve të informacionit. Me rritjen e nivelit të pasurisë, shtohet në mënyrë të ndjeshme përdorimi i internetit si mjet informacioni. Nga grupi i të rinjve që i përkasin shtresave të varfra, vetëm 19 përqind e përdorin atë për këtë qëllim, ndërkohë që interneti përdoret si burim informimi nga rreth 50 përqind e atyre të rinjve që përfshihen në kategorinë e të pasurve. Gjithashtu edhe përqindja e atyre të rinjve që lexojnë gazeta pëson rritje të ndjeshme me ndryshimin e nivelit të arsimimit. Ndërsa vetëm 14 përqind e të rinjve me arsim fillor përmendin gazetën si mjet informacioni, kjo përqindje rritet tek ata me arsim të mesëm në rreth 19 përqind,. Ndër të rinjtë me arsim të lartë rreth 25 përqind e tyre marrin informacion nga gazetën ndërsa 48% nga interneti

### 3.2.2 Sjellja Politike

Të dhënat tregojnë se të rinjtë shqiptarë janë shumë aktivë në procesin zgjedhor. Nga i gjithë grupi i të anketuarve për arsye analize u morën në konsideratë vetëm ata që kanë mbushur 18 vjeç në vitin e fundit, dhe kanë pasur mundësi të votojnë në zgjedhjet e vitit 2011.

Nga të rinjtë e intervistuar të grup-moshës 19-27 vjeç, 28.3 përqind pohuan se kanë votuar në çdo proces zgjedhor, 8.7 përqind kanë votuar pothuajse në gjitha zgjedhjet, 17.2 përqind kanë votuar në pak prej tyre dhe 44 përqind u përgjigjen se nuk kanë votuar asnjëherë.

**F4.** Nëse ju kujtohet, sa herë keni votuar që kur keni fituar të drejtën për të votuar?




Nga ana tjetër vërejmë se të rinjtë shqiptarë të moshës 19 vjeç e lart nga zonat rurale janë më aktivë në pjesëmarrjen e tyre në proceset zgjedhore pasi 43.5 përqind e tyre u shprehën se kanë votuar në çdo zgjedhje të mundshme dhe vetëm 5.6 përqind u përgjigjën se nuk kanë votuar asnjëherë. Ndërsa të dhënat e anketimit dëshmojnë se të rinjtë nga

qytetet e tjera, përveç Tiranës janë më pak aktivë në këtë drejtim teksa 39,5 përqind e tyre shprehen se kanë votuar në çdo proces zgjedhor dhe vetëm rreth 10.7 përqind pohuan se nuk kanë votuar asnjëherë.

Megjithatë, ndryshimi statistikor me Tiranën është i vogël ku për të njëjtat pyetje të rinjtë e këtij qyteti janë përgjigjur respektivisht në shifrat 41.5 dhe 8.9 përqind.

Në lidhje me bindjet e tyre politike, të rinjve iu kërkua të përcaktonin vendin që ato zinin në një shkallëzim nga 1-10 ku 1 përfaqëson të majtë ekstreme dhe 10 të djathtë ekstreme. Rezultatet tregojnë se 26 përqind e të rinjve i përcaktoi bindjet e saj politike në të majtë (1-4), 28.9 përqind në qendër (5-6) dhe 19.9 përqind në të djathtë (7-10). Nga ana tjetër, 23.6% të rinj thanë se ata nuk e dinë ose nuk kanë pikëpamje politike.

*F8. Ne pergjithesi bindjet tuaja politike jane: Ju lutem perdorni shkallen e vleresimit 1-10, ku 1 do te thote "E Majtë Ekstreme" dhe 10 do te thote "E Djathtë Ekstreme"*




Gjithashtu edhe gjinia duket se përbën një faktor në orientimin politik tek të rinjtë, ku femrat janë të prirura më shumë nga e majta (26.7 përqind) sesa e djathta (19.8 përqind), ndërsa të rinjtë meshkuj e pozicionojnë më shumë veten e tyre nga spektri i djathtë (22.7 përqind) sesa i majtë

(20.9 përqind). Për më tepër, vajzat dhe djemtë përbëjnë përqindje të barabartë, me 23.6 përqind, të atyre të rinjve të cilët shprehen se nuk e dinë ose nuk kanë orientimin politik,

Kur i ndajmë të rinjtë e intervistuar në varësi të zonës ku ata jetojnë, vërejmë se orientimi i tyre politik ndryshon në raport me mesataren kombëtare. Në këtë kuadër të rinjtë nga zonat rurale janë më të prirur nga e djathta përkundrejt të rinjve nga Tirana që vendosin veten më shumë në të majtë të spektrit politik sesa mesatarja kombëtare

Përsa i përket përfaqësimit të rinjve në politikë rreth 35.7% e të rinjve në nivel kombëtar pohojnë se ata janë disi të përfaqësuar ndërsa 54.5% mendojnë se të rinjtë janë të përfaqësuar pak ose shumë pak

**F10.** Sa të përfaqësuar ndiheni prej te rinjve ne politike ?




Ndërkohë, angazhimi i të rinjve në aktivitete politike vijon të mbetet i vogël. Vetëm një numër i vogël i të rinjve pjesëmarrës deklarojnë se janë përfshirë në aktivitete politike. Disa të rinj gjatë grupeve të diskutimit deklarojnë se kanë qënë të angazhuar në aktivitete politike për parti të ndryshme në Shqipëri. Ata i konsiderojnë angazhime të tilla (kryesisht gjatë fushatave zgjedhore) si mundësi të mira për tu punësuar.

*“[Do donit të angazhoheshit në aktivitete politike?] - Duke parë që mund të gjejnë punë edhe mundet.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë kam miq që janë të sëmurë mbas politikës. Ndryshim nuk kam në mënyrën e të sjellurit por ata duhet të largohen sa më parë nga kjo varësi që kanë. Megjithatë kjo nuk ka ndikuar në marrëdhënien tonë.” (Tiranë, Urban)*


Në lidhje me efektin pozitiv që ushtrojnë kuotat gjinore në politikë dhe nivelin e demokracisë në vend vetëm 23.8% e të rinjve në nivel kombëtar besojnë se këto kanë ndikim dhe 31.7% e tyre pohojnë se ato ndikojnë pak ose aspak. Kjo shkallë mosbesimi shfaqet e dukshme tek dallimet ku vetëm 16.2% e të rinjve meshkuj besojnë se kuotat gjinore mund të sjellin ndryshim në cilësinë e politikës e demokracisë përkundër 31.8% të femrave.

**F11.** Sa e rëndësishme është për ju respektimi i kuotave gjinore ne Shqiperi?



Të rinjtë synojnë që demokracia të nxisë konkurrencën në bazë të meritokracisë dhe transparecës përgjatë procesit politik që zhvillohet në Shqipëri. Rreth 49.1 % e tyre do të parapëlqenin të zgjidhnin kandidatët për deputetë përmes listave të hapura zgjedhore cka është dëshmi e dëshirës së tyre për një konkurrencë të hapur brenda sistemit politik dhe cilësi të përfaqësimit e demokracisë.

**F6.** A do të donit që partitë ta zgjidhnin deputetin me listë të mbyllur siç është aktualisht apo ta votonit ju në një listë të hapur?



### 3.2.3 Besimi tek demokracia dhe tek institucionet


Të rinjtë e intervistuar iu përgjigjën edhe pyetjeve që lidhen me besimin sesi ka ndikuar vota e tyre në mënyrën si janë drejtuar qeveritë qendrore dhe lokale. Të dhënat e anketimit tregojnë se shumica e të rinjve nuk besojnë se vota e tyre ka ndonjë ndikim të madh në mënyrën se si drejtohen institucionet. Vetëm 10.7 përqind besojnë se vota e tyre ndikon në shkallë të gjerë në mënyrën se si janë drejtuar institucionet dhe rreth 29.8 përqind besojnë se vota e tyre ndikon deri diku. Një numër i madh i të rinjve, afro 25.5 përqind besojnë se vota e tyre është shumë pak e rëndësishme dhe 29 përqind e konsiderojnë atë aspekt të rëndësishme.

Megjithëse niveli i perceptuar i ndikimit të votës në qeverinë lokale është më i lartë se në atë qendrore, sërish vetëm 17.8 përqind e të rinjve mendojnë se vota e tyre ka rëndësi në shkallë të gjerë. Pjesa tjetër e të rinjve ndahet mes atyre që pohojnë në masën 33 përqind se vota ka rëndësi deri diku, 21.3 përqind mendojnë se ajo ka shumë pak rëndësi dhe 22.8 përqind që nuk ka rëndësi fare




Fenomeni i blerjes së votës është një dukuri që ka çenuar në mënyrë të dukshme thelbin e cilësisë së demokracisë në vend dhe ka rrënuar besimin tek vota si mekanizëm për ndryshim. Rreth 83% e të rinjve në nivel kombëtar pohojnë se votat blihen në Shqipëri. Në këtë përfundim nuk vihen re dallime mes të rinjve përta i përket ndarjeve të tyre gjinore, krahinore, arsimore apo statusit të tyre social- ekonomik, ku mbi 80% e tyre pohojnë të njëjtë gjë. Ky perceptim i ngulitur për shitblerjen e votës dëshmon se për shumicën e tyre rastet përjashtimore të këtij fenomeni po shndërrohen në rregull gjatë proceseve zgjedhore

F.9 A Mendoni se blihet vota ne Shqipëri?



Megjithatë ky pohim mbi blerjen apo shitjen e votës duket se mbetet në nivelin e perceptimit që ata kanë krijuar nga shtypi dhe diskutimet pasi kur pyeten për përvojat konkrete të këtij fenomeni 69.1% e tyre në nivel kombëtar shprehen se nuk kanë patur rast që prindërve apo atyre tu ketë ofruar dikush para në shkëmbim të votës.

**F9.B** Gjatë votimeve ku keni marrë pjesë, a ju janë ofruar ndonjëherë juve ose prindërve tuaj para të blerë votën tuaj?




*Të rinjtë shqiptarë kanë nivele shumë të ulëta besimi në institucionet e vendit.*

Përsa i përket partive politike vetëm 4% e të rinjve të intervistuar në nivel kombëtar u besojnë partive politike ndërkohë që 75.1% e tyre u besojnë shumë pak ose nuk u besojnë fare. Ky përbën një tregues shqetësues e cila lidhet me trashëgiminë e partive politike shqiptare, rolin e tyre në tranzicionin shqiptar dhe nivelin e demokratizimit e cilësisë së tyre që pasqyrohet më vonë në ndërtimin e institucioneve e nivelit të reformave bindëse që ndërmarrin partitë fituese.

Edhe parlamenti shqiptar nuk gëzon një nivel të dukshëm besimi mes të rinjve shqipatrë teksa 68.7% e të rinjve në nivel kombëtar i besojnë shumë pak ose aspak këtij institucioni themelor të funksionimit të demokracisë liberale. Ky nivel mosbesimi pasqyron në mënyrë të natyrshme nivelin e mosbesimit për partitë politike që përbëjnë shtyllën e përfaqësimit

përmes deputetëve të tyre në parlament. Ndonëse Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nuk përbën për të rinjtë një institucion me rëndësi ai është sërish viuktimë e nivelit të mosbesimit që karakterizon të rinjtë shqiptarë ku rreth 62.6% e tyre i besojnë shumë pak ose aspak. Si rrjedhojë edhe për institucione të tjera përqindja e të rinjve në nivel kombëtar që shprehen nivele të ulëta besimi oser mosbesimi është sërish e lartë të tilla si qeverisja lokale me 63.4%, Prokuroria e Përgjithshme 61.5%, disi më pak Policia e Shtetit me 31.7%,. Ndër institucionet ku të rinjtë shprehin disi nje shkallë më të lartë besimi përkundër të tjerëve konsiderohen Policia e Shtetit, KLSH me 16%, liderët fetarë me 18%, Media me 15.4%.Ndërkohë edhe sindikatat e organizatat jo-qeveritare gëzojnë një nivel të ulët besimi mes të rinjve respektivisht me 8% dhe 9%

F13. Besimi ne institucione



Të rinjtë nga zonat urbane, por edhe nga ato rurale, ashtu si në 2011 vijnë të shfaqin besim të ulët tek institucionet në vend. Shumica e pjesëmarrësve deklarojnë se Policia është institucioni tek i cili kanë më tepër besim, ndërkohë që gjykatat dhe KQZ-ja janë institucionet tek të cilat ky grup i popullsisë beson më pak. Sipas rezultateve të sondazhit në terren, 3 në 5 të rinj të intervistuar shprehën se kanë shumë, ose disi besim tek Policia.

***“Nuk kam shumë besim tek asnjë institucion, për të mos thënë që nuk kam fare.”***

**(Tiranë, Urban)**

***“Tek policia mesa shihet ka një rritje besimi. Nuk del dot në makinë pa rrip sigurimi, në motor pa skafandër e nuk e shkel dot semaforin.”***


**(Tiranë, Urban)**

***“Unë tek policia kam besim, tek gjykata nuk kam besim.”***

**(Tiranë, Rural)**

Të rinjtë shqiptarë janë të ndarë në lidhje me vlerësimin për gjendjen e përgjithshme të demokracisë në vend. Nga të dhënat e anketimit rezultoi se vetëm 3.3 përqind e tyre janë shumë të kënaqur me nivelin e demokracisë në vend, përkundrajt 22.4 përqind që shprehën se janë thjesht të kënaqur. Nga ana tjetër, 16.8 përqind janë të pakënaqur me gjendjen dhe funksionimin e saj në Shqipëri, ndërsa 7.4 përqind janë shumë të pakënaqur. Në tërësi vërejmë se pjesa më e madhe e të rinjve, afro 48.2 përqind, ashtu si në vitin 2011 vazhdon të paraqesë një vlerësim mesatar për të, duke shprehur në këtë mënyrë një kënaqësi të përmbajtur për gjendjen e demokracisë

**F14.** Përgjithësisht sa i kënaqur ose pakënaqur jeni me nivelin e zhvillimit të demokracisë në Republikën e Shqipërisë?



## 4. Përfundime

Qeverisja dhe zhvillimi i vendit janë dy ndër elementët kryesorë që janë të ndërlidhur me njëri - tjetrin dhe me të cilin të rinjtë përballen në jetën dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Nga të dhënat e këtij vëzhgimi vërejmë se të rinjtë vazhdojnë të konsiderojnë moszbatimin e ligjit, krimin e rrugës dhe trafiket e ndryshme si ndër shqetësimet kryesore për sa i përket sigurisë së tyre dhe që i prek ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, pavarësisht nivelit të tyre socio-ekonomik, arsimimit apo vendndodhjes gjeografike. Nga ana tjetër, kërcënimet e terrorizmit ndërkombëtar apo tjetërsimi i identitetit etnik nga bashkëmohatarët e tyre në vendet ku kanë emigruar janë shqetësime të karakterit dytësor. Vërejmë sërish se përqindja më e lartë e natyrës së shqetësimeve të të rinjve lidhet me sfidat e jetës së tyre të përditshme që përkujnë me varfërinë, papunësinë, pasigurinë për vendin e punës, ndotjen e mjedisit etj. Zgjidhja e këtyre shqetësime nga qeverisja dhe institucionet demokratike mund ti lidhë të rinjtë me një cilësi jete më të mirë dhe të ardhme më të sigurtë.. Ndonëse shumica e të rinjve shprehin një vlerësim të përmbajtur por shpresëdhënës për sa i përket zhvillimit ekonomik të Shqipërisë për 10 vitet e ardhshme, ende tek ata ndjehet pasiguria për të ardhmen. Kjo pasqyrohet tek niveli ende i pakët i besimit të të rinjve në institucionet publike. Përsa kohë të rinjtë e shohin qeverisjen të lidhur ngushtë me luftën ndaj varfërisë, papunësisë dhe krijimin e një mjedisi të sigurtë për zhvillim cdo perceptim i tyre për cilësinë e saj do të jetë i kushtëzuar nga këta faktorë. Nga ana tjetër vlerësimi i tyre për gjendjen e demokracisë është i lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, sjelljen si votues, ndikimin e debatit politik dhe përballjen me aspektet e përditshme të funksionimit të demokracisë që përcillet përmes mediave.

## 5. Rekomandime

- Fushatat ndërgjegjësuere për të rinjtë duhet të përqendrohen më shumë drejt përdorimit të internetit si medium për të përçuar mesazhin tek të rinjtë.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i strukturave të zbatimit të ligjit që luftojnë krimin e rrugës dhe trafiqet duke rritur nivelin e sigurisë veçanërisht në mjediset sociale ku të rinjtë zhvillojnë aktivitetin e përditshëm si shkolla, lagje, ambiente argëtuese dhe sportive.
- Ndikimi i ndotjes së mjedisit dhe rritja e shqetësimeve për pasojat e tij edhe mes të rinjve të zonave rurale duhet të shoqërohet me ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga ana e institucioneve përgjegjëse.
- Fushatat ndërgjegjësuere dhe informuese mbi kërcënimet që vijnë nga ndryshimi i klimës dhe përhapja e HIV/AIDS duhet të përqendrohen më shumë tek ato grupe të rinjsh që preken më shumë prej tyre.
- Aktivitete si ditët e hapura të institucioneve për të rinjtë, apo takime periodike të titullarëve të institucioneve me të rinjtë do të ndihmonin në këtë drejtim.
- Duhet të behët më shumë nga sistemi arsimor dhe aktorët publikë për të nxitur interesin e të rinjve mbi zhvillimet politike në vend, rajon dhe nivel ndërkombëtar



# KAPITULLI VII:

TË RINJTË  
&  
INTEGRIMI  
EVROPIAN

Përgatitur nga: **Alba Çela**



## 1. Hyrje

Pas disa tentativave dhe përpjekjeve të vështira, si pasojë e klimës politike të acaruar në vend dhe zhvillimit të qetë të zgjedhjeve të qershorit 2013, Bashkimi Evropian i dha Shqipërisë statusin zyrtar të vendit kandidat në Qershor të vitit 2014. Hapi tjetër në rrugën e integritit është akoma më i rëndësishëm: hapja e negociatave. Shqipëria ka ndërmarrë disa reforma të mëdha që përkojnë me prioritetet e ndryshme të kërkuara nga BE por endet mbetet një rrugë e gjatë dhe e vështirë deri në hapjen e negociatave për anëtarësim.

Kroacia e u bë vend anëtar me të drejta të plota në BE ne vitin 2013 pas më shumë se 7 vitesh negociata dhe ky ishte një lajm i mirë për Ballkanin. Që nga zhvillimi i sondazhit të parë në 2011, kriza ekonomike në disa vende në BE dhe tensionet e brendshme që ajo ka krijuar, kanë vazhduar të ndikojnë në qasjen e BE-së ndaj integritit. Pas zgjedhjeve të Parlamentit Evropian në 2014, Komisioneri dhe Drejtori për Zgjerimin u emërtuan si Komisioneri dhe Drejtori i Politikave të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim, një zhvillim që sinjalizon deri diku një rënie të ritmit me të cilin BE ka dëshirë të zmadhohet. Nga ana tjetër roli i vendeve të fuqishme anëtare si Gjermania po forcohet paralelisht me Brukselin. Kështu me iniciativën e kancelares gjermane Merkel të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor tashmë janë të angazhuara në një kuadër të ri të bashkëpunimit rajonal në funksion të integritit të mëtejshëm, i ashtuquajtur Proces i Berlinit. Ky proces filloi me Samitin e gushtit 2014 në Berlin dhe vijoi me atë të një viti më pas në Vienë. Duhet theksuar se ëndrra europiane gëzon ende një mbështetje të madhe të opinionit publik në Shqipëri. Megjithatë ulje-ngritjet e procesit dhe ndikimi i krizës në vendet fqinjë si Greqia po fillon të hedhë farat e para të skepticizmit. Në këtë kuadër procesi i informimit dhe të përfshirjes së të rinjve do të jetë thelbësor për të vazhduar këtë mbështetje dhe shndërruar atë në energji pozitive drejt procesit të integritit evropian.

## 2. Gjetjet kryesore


- 87 përqind e të rinjve shqiptarë do të votonin pro anëtarësimit të Shqipërisë në BE në rastin e një referendumi përkatës ndërsa vetëm 5 përqind do të votonin kundër.
- Lidhur me efektet që do të kishte integrimi evropian mbi Shqipërinë, shumica e të rinjve, 62 përqind, mendojnë se integrimi do të sillte zhvillim të dyfishtë, si politik ashtu edhe ekonomik.
- Përsa i përket pritshmërive të të rinjve në lidhje me kohën kur Shqipëria pritet të bëhet vend anëtar rreth 35 përqind mendon se kjo do të ndodhë brenda 5 viteve të ardhshme; 35 përqind, në 10 vitet e ardhshme kurse 16 përqind mendojnë se kjo do të kërkojë më shumë sesa 10 vjet. Për 6 përqind të tyre do të duhen të paktën 20 vite të tjera.
- 36 përqind e të rinjve e lidhin procesin e integritit evropian me liberalizimin e vizave dhe lëvizjen e lirë të njerëzve në hapësirën evropiane. Ndërkohë rreth 28 përqind e tyre e kuptojnë integrimin si mundësi për të qëndruar dhe punuar lirshëm në vendet anëtare të BE ndërsa 6 përqind përmendin lëvizjen e lirë të mallrave.
- Këtë vit 46 përqind e të rinjve shprehën të kënaqur ose shumë të kënaqur me angazhimin e ekzekutivit shqiptar për të ecur përpara në procesin e integritit. Në këtë drejtim vihet re një rritje e përqindjes së të rinjve në krahasim me vitin 2011 ku vetëm 33 përqind të të rinjve shpreheshin të kënaqur me punën e qeverisë në drejtim të integritit evropian. Ndërkohë vihet re se ka rënë numri i atyre të rinjve që mendojnë se angazhimi i qeverisë në procesin e integritit është i pamjaftueshëm.

## 3. Analiza e detajuar e gjetjeve

### 3.1 Anëtarësimi në BE

Rinia shqiptare është qartësisht pro-europiane dhe përkrah rrugën e vendit drejt integritimit evropian. 87 përqind e të rinjve shqiptarë do të votonin pro anëtarësimit të Shqipërisë në BE në rastin e një referendumi përkatës ndërsa vetëm 5 përqind do të votonin kundër dhe 6 përqind nuk do të merrnin pjesë në votim. Shifrat e dhëna nga të rinjtë janë më të larta sesa ato që raportohen nga sondazhe të tjera për matjen e mbështetjes popullore për procesin e integritimit. Kështu në sondazhin kombëtar të ISHSN për vitin 2014, 77 përqind e popullsisë do të votonte pro integritimit në BE.


*H1. Si do të votonit në rastin e një referendumi për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian?*



## 3.2 Efektet e anëtarësimit në BE

Të pyetur mbi efektet që do të kishte integrimi evropian mbi Shqipërinë, shumica e të rinjve, ose 62 përqind e tyre, mendojnë se integrimi do të sillte zhvillim të dyfishtë, si politik ashtu edhe ekonomik. Rreth 22 përqind e të rinjve e vënë shumë theksin tek ndikimi që do të kishte procesi i integritit evropian në zhvillimi ekonomik të vendit ndërsa vetëm 4 përqind mendojnë se kjo nuk do të sillte ndonjë ndryshim. Nga ana tjetër ka një përqindje të ulët të të rinjve afro 3-4 përqind të cilët mendojnë se integrimi mund të ketë pasoja negative për vendin, pra që mund të sjellë probleme të ndryshme të natyrës ekonomike ose politike.

*H2. Cfare efekti mendoni se do te kishte integrimi ne Bashkimin Evropian per Shqipërinë?*



## Arsye skepticizmi

***“Nuk ndodh në të gjitha rastet që anëtarësimi të sjell zhvillim. Kemi rastin e Greqisë e cila është futur në borxhe në fund me Gjermaninë duke qenë pjesë e Bashkimit European.”*** komenton një i ri nga një fshat në Tiranë, duke treguar një ndër arsyt kryesore pse integrimi mund të ketë humbur fuqinë bindëse për disa qytetarë.

Kriza ekonomike në Greqi ka pasur mjaft ndikim në Shqipëri dhe efekti i saj në opinionin publik është i natyrshëm. Tek të rinjtë shqiptarë nuk mungojnë gjasjet që Shqipëria të ndjekë ndonjë model alternativ si Turqia, e cila për shkak të rritjes ekonomike po fuqizohet në arenën ndërkombëtare.


Megjithatë skepticizmi i shumicës së të rinjve buron nga kushtet dhe papërgatitja e vetë Shqipërisë për këtë proces : ***“që të futemi në BE duhet të jemi akoma më të zhvilluar, në radhë të parë si shtet” apo “Për sa kohë Shqipëria nuk është gati, nuk i ofron kriteret dhe kushtet, atëherë si mund të na pranojë Europa”.***

### 3.3 Koha e anëtarësimit në BE

Lidhur me pritshmëritë e tyre për kohën kur Shqipëria mund të anëtarësohet me të drejta të plota në BE të rinjtë duken se ndahen në tre grupe kryesore. Grupi i parë prej 35 përqind dëshmon një optimizëm naiv duke thënë se kjo do të ndodhë brenda 5 viteve të ardhshme. Duke qenë se Shqipëria ende nuk kanë filluar negociatat e anëtarësimit, ky vlerësim i të rinjve tregon për mungesa të theksuara informacioni. Për këtë arsye është e nevojshme një përditësim i informacionit mbi procesin dhe kushtet që duhen plotësuar. Ky grup i të rinjve ka pësuar një ulje të vogël (prej vetëm, 4 pikësh) në krahasim me sondazhin e vitit 2011 duke dëshmuar se mangësitë në informimin e të rinjve për këtë proces vijojnë të mbeten të pazgjidhura.

Një grup tjetër, rreth 35 përqind, mendon se anëtarësimi do të ndodhë në 10 vitet e ardhshme kurse 16 përqind e të rinjve mendojnë se përfundimi i procesit të integritimit do të kërkojë më shumë sesa 10 vjet. Nga ana tjetër afro 6 përqind e të rinjve pohojnë se do të duhen të paktën 20 vite tjera ndërkohë që pjesa e atyre që mendojnë se Shqipëria nuk do të arrijë të bëhet shtet anëtar i Be është e papërfillshme (3 përqind).

**H3.** Kur mendoni se Shqipëria do të anëtarësohet në BE?




### 3.4 Çfarë përbën anëtarësimi në BE

Niveli i ulët i kuptimit që kanë të rinjtë për procesin e integritimit evropian con në pritshmëri jorealiste mbi kohën e përmbylljes së tij. Sondazhi i IShSN i realizuar në 2014 na tregon se rreth 9 përqind e popullsisë priste që procesi i integritimit të kryhej asokohe në harkun e 1-2 viteve, pra brenda 2015. Nga ana tjetër shumica e shqiptarëve, ose 31.6 përqind presin që kjo të ndodhë brenda vitit 2020. Deklarata e Kreut të Komisionit Evropian Juncker që zgjerimi është ngrirë për pesë vitet e ardhshme (pra të paktën deri në 2019) duket se nuk është reflektuar në opinionin publik shqiptar.

Të rinjve iu është kërkuar të shprehen mbi integrimin evropian të vendit sipas aspekteve me të cilat ata e lidhin këtë proces. Kështu 36 përqind e tyre janë shprehur se integrimin e lidhin me liberalizimin e vizave si dhe lëvizjen e lirë të njerëzve në hapësirën evropiane. 28 përqind e tyre integrimin e kuptojnë si mundësi për të qëndruar dhe për tu punësuar lirshëm në vendet anëtare të BE dhe një grup i vogël prej 6 përqind përmend lëvizjen e lirë të mallrave. Në krahasim me vitin 2011, ka një rritje të konsiderueshme nga 13 në 28 përqind të të rinjve që lidhin integrimin me qëndrimin dhe punësimin në BE.

**H4. Me çfarë e lidhni integrimin Evropian**



Një ndër pesë të rinj e lidh integrimin me të gjithë faktorët e përmendur përfshirë dhe krizën ekonomike të BE, pavarësisht se ai nuk mbizotëron në opininet e tyre. Po ashtu është e papërfillshme përqindja e të rinjve që përmendin përdorimin e euros si aspekti kryesor me të cilin e lidhin integrimin evropian.

## Një ylber pritshmërih

Të rinjtë paraqesin një dinamikë interesante lidhur me pritshmëritë e tyre mbi integrimin evropian dhe anëtarësimin në BE. Të rinjtë e zonave rurale flasin qoftë për pritshmëritë e përgjithshme të tilla si si infrastruktura dhe lufta ndaj korrupsionit ashtu dhe për gjëra konkrete që lidhem me realitetin e tyre të përditshëm sic janë fondet për zhvillimin e bujqësisë.

Kështu një i ri nga fshatrat e Tiranës tregon se integrimi evropian do të jetë i dobishëm **“për çështjen e subvencionimeve në bujqësi. Dmth do të jetë një përparësi për ne sepse do të ketë kontroll më të lartë, ndërsa tani politika funksionon shumë keq [...] Kjo do jetë një mbështetje për pjesën më të madhe, ose për pjesën që jeton në fshat, të cila janë të vetëpunësuar,”**

Të rinjtë e zonave urbane e lidhin integrimin me lëvizjen dhe qëndrimin e pakufizuar në vendet anëtare apo rritjen e numrit të investitorve të huaj në Shqipëri.


Interesante janë opinionet e të rinjve që e shohin integrimin si një përmbyllje të procesit të ndarjes nga e kaluara komuniste, Një i ri nga zonat rurale thotë se **“Unë jam pro [integrimin] sepse do të ndihmonte shoqërinë në çdo fushë si mjekësi, infrastrukturë. Në çdo aspekt Shqipëria do të ishte një vend më i përparuar më ndryshe nga ç’ishte pasi diktatura e ka lënë me shumë pasoja.”**



### 3.5 Angazhimi i qeverisë Shqiptare

Të pyetur rreth angazhimit të ekzekutivit shqiptar në procesin e integritit europian të rinjtë janë të ndarë në vlerësimin e tyre. Megjithatë në krahasim me vitin 2011 vihet re një lëvizje e fortë drejt vlerësimeve pozitive. Këtë vit janë 46 përqind e të rinjve që shprehen të kënaqur ose shumë të kënaqur me këtë angazhim të qeverisë në krahasim me 33 përqind të të rinjve para katër vitesh. Numri i atyre që mendojnë se angazhimi i qeverisë është i pamjaftueshëm ka rënë nga 20 përqind (në 2011) në 12 përqind në vitin 2014

*H5. Ne përgjithësi si do ta vlerësonit angazhimin e qeverisë për anëtarësimin e vendit ne Bashkimin Evropian?*



## 4. Përfundime

Nga vrojtimi cilësor i të rinjve në 2014, rezulton se ata janë të informuar mbi progresin konkret të Shqipërisë, duke përmendur statusin zyrtar të vendit kandidat. Gjithashtu vihet re që të rinjtë shprehen të kënaqur me punën e qeverisë lidhur me procesin e integritimit. Ky optimizëm që gërshetohet me mbështetjen tradicionale të të rinjve ndaj integritimit evropian e përforcojnë imazhin e Shqipërisë si një vend euroforik. Megjithatë do të shihet në të ardhmen nëse kjo energji pozitive rinore do të shndërrohet në veprime konkrete nëpërmjet përfshirjes dhe mbështetjes së tyre për reformat e vështira që shpesh i paraprijnë integritimit. Nga ana tjetër paqartësitë e tyre mbi këtë proces dhe kohëzgjatjen e tij vazhdojnë të krijojnë opinione e pritshmëri jo realiste. Ky boshllëk informimi duhet përmbushur sic duhet për të shmangur keqkuptimet apo skepticizmin.

## 5. Rekomandime

- Iniciativat për përfshirjen aktive të të rinjve në procesin e integrimit duhen shpeshuar. Ato duhen shndërruar në projekte sistematike për të ruajtur mbështetjen pozitive të të rinjve, duke rritur informacionin mbi BE-në dhe ngjallur pritshmëri realiste nga anëtarësimi.
- Vlerësimi korrekt i kohëzgjatjes së hapave të integrimit nga institucionet vendim-marrëse kombëtare, evropiane dhe media duhet të jetë përparësi në mënyrë që të shmangen keqkuptimet mbi procesin.
- Të rinjtë duhen inkurajuar dhe mbështetur për të vepruar si grupe presioni pozitiv ndaj qeverisë duke kërkuar vazhdimësinë dhe transparencën e reformave të nevojshme për integrimin.



# KAPITULLI VIII:



ZËRI  
I TË  
RINJVE

Përgatitur nga: IDRA Research & Consulting

## HYRJE

Qëllimi kryesor i studimit mbi të rinjtë është të kuptojë qëndrimet, perceptimet, dëshirat, aspiratat dhe pritshmëritë e të rinjve në vend. Në thelb studimi synon të identifikojë ndryshimet mes të rinjve të zonave urbane dhe rurale me bindje të majta dhe të djathta.

Në këtë studim cilësor, do të identifikohen rezultatet e katër grupeve të diskutimit mbi tematikat e poshtëpërmendura:

- a) Koha e lirë dhe mënyra e jetesës
- b) Familja dhe rrethi shoqëror
- c) Ceshtje besimi dhe përkatësie
- d) Shqetësime dhe Aspirata
- e) Arsim dhe Punësim
- f) Qeverisje dhe Zhvillim
- g) Politikë
- h) Bashkimi Evropian

Katër grupet e diskutimit kanë në përbërje nga 8 të rinj të grupmoshave 16-27 vjec, të ndarë proporcionalisht sipas gjinisë (meshkuj dhe femra), me staturë sociale të ndryshme (të punësuar, të papunë, studentë etj). Ndër to, dy diskutime janë zhvilluar në zonat urbane dhe dy në zonat rurale, përkatësisht me bindje të ndryshme politike.

Grupet e diskutimit synojnë:

- a) Të kuptojnë perceptimet e të rinjve në Shqipëri
- b) Të identifikojnë aspiratat e të rinjve në Shqipëri
- c) Të vecojnë pritshmëritë e të rinjve në Shqipëri
- d) Të zbulojnë qëndrimet e të rinjve në Shqipëri

Studimi cilësor ka pasur një studim paraprak sasior, në të cilin janë anketuar 1200 të rinj në rang vendi, të grupmoshës 16-27 vjec, të zgjedhur në mënyrë rastësore. Ky raport do të analizojë më në thellësi rezultatet e studimit sasior me qëllim krahasimin dhe vlerësimin e mëtejshëm të qëndrimeve, perceptimeve dhe sjelljes së të rinjve.

Rezultatet e studimit cilësor janë vetëm indicative, pasi bazohen në përfundimet e nxjerra nga opinioni i 32 të rinjve. Si rrjedhojë, theksi është vene në krahasimin e tyre me rezultatet e nxjerra nga studimi sasior.

## 1. Koha e lirë dhe mënyra e jetesës

### 1.1 Një kafe me miqtë, mënyra më e mirë për të kaluar kohën e lirë sipas të rinjve në Shqipëri

Rezultatet e sondazhit në 2014, sipas të cilave rreth 68% e të intervistuarve deklarojnë se në kohën e lirë dalin shpesh me miqtë, konfirmohen edhe nga grupet e diskutimit. Ashtu si në studimin e 2011, shumica e kafeve me miqtë, rrjetet sociale, apo aktivitetet sportive (kryesisht për pjesëmarrësit meshkuj) vijojnë të jenë mënyrat më të zakonshme për të kaluar kohën e lire për rinjtë shqiptar.

Të rinjtë e punësuar, duket se nuk kanë mjaftueshëm kohë të lirë për të marrë pjesë në aktivitete argëtuese të këtij lloji. Largësia nga qendrat urbane ndërkohë, renditet si pengesa kryesore të rinjtë e zonave rurale për frekuentimin jo të shpeshtë të ambienteve të tilla argëtuese.

*“Ne që jemi në punë nuk është se kemi shumë kohë të lirë por në fundjavë ndonjë kalçeto, kafe,kaq. Ky është itinerari i zakonshëm” (Tiranë, Urban)*

*“Personalisht punoj vetëm 6 orë dhe punën e filloj pak vonë. Gjëja e parë që bëj kur ngrihem në mëngjes është kafe, dhe më pas planifikoj të takoj dikë që të mbyll ndonjë punë.” (Tiranë, Urban)*

*“Personalisht nuk është se kam shumë kohë të lirë se dhe atë që mund të quhet kohë e lirë e zë me punë. Por duke qënë se punoj 8 orë, pjesa e parë e ditës është e zënë me punë shtëpie dhe më pas më pëlqen të lexoj, shikoj TV. Këto emisionet politike edhe pse nuk dua të përfshihem unë, na bëjnë vetë ti ndjekim.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë merrem me libra pjesërisht se jo del koha se distancë e largët se nuk është afër e ke parasysh të vin nga këtu është gati 30 minuta rrugë se nuk të del koha por ajo pjesë që mbetet edhe studioj edhe merrem me aktivitete personale dhe leximin e informacione të ndryshme në internet.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë kohën e lirë e shfrytëzoj me aktivitete sportive pasi jam dhe i apasionuar pas futbollit një kohë të mire e kaloj duke luajtur futboll por edhe në darkë kur kam mundësi lexoj ndonjë herë ndonjë libër gjithmon sipas mundësive.” (Tiranë, Rural)*

## 1.2 Kinemaja dhe aktivitetet sportive, disa prej aktiviteteve më të pëlqyera nga të rinjtë shqiptarë

Kinemaja frekuentohet më shpesh nga të rinjtë në krahasim me Teatrin, kryesisht sepse shihet, si një aktivitet më tërheqës. Pamundësia për të koordinuar kohën e lirë me miqtë, është ndërkohë një nga arsyet kryesore pse disa të rinjë nuk i frekuentojnë shpesh këto opsione. Ashtu si në studimin e vitit 2011, edhe këtë vit, aktivitetet e ndryshme sportive (not, palester, hipizëm, ciklizëm, etj) pavarësisht se pëlqehen nga shumica e të rinjve në zonat urbane, shihen shpesh herë të papërbalueshme nga ana financiare, sidomos për të rinjtë studentë pa të ardhura fikse mujore.

Përgjithësisht, pjesëmarrësit shprehen se mungojnë hapësirat e gjelbërta si dhe ambientet sportive në komunitetet ku jetojnë. Mungesa e bibliotekave, apo fakti që shume prej atyre që ekzistojnë janë jo funksionale, konsiderohet si pengesë për të rinjtë që duan të lexojnë gjatë kohës së lirë.

*“Unë kinematë e frekuentoj 2 herë në vit. Sepse teknologjia siç e shohin ka arritur shumë zhvillime të lartë dhe ne mund të na vij shumë kollaj filmi hapim laptopin aty internetin shikojmë filmin.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë personalisht do ta preferoja shumë kinemanë ose teatrin por oraret nuk më përshtaten për shkak të punës. Dhe grupi im i shoqërisë, nuk mund të bëhem të gjithë në të njëjtin orar për të shkuar jo se nuk kemi dëshirë të shkojmë.” (Tiranë, Urban)*

*“Biblioteka është e papërshtatëshme këtu tek ne, unë personalisht që jam studente kam kërkuar dhe kam shkuar në të gjitha bibliotekat e mundëshme por ambjenti është i papërshtatshëm dhe librat janë të kufizuar, nuk ka libra.” (Tiranë, Urban)*



*“Në teatër është më vështirë të marësh informacion, më shumë duhet ta marësh fizikisht duhet të informohesh tek teatri, kurse në kinema faqet e kinemave që janë aktualisht në Tiranë janë dhe në rrjetet sociale dhe e ke më të thjeshtë për të parë se çfarë filmi duhet të ndjekësh.” (Tiranë, Rural)*

*“Këtu në Shqipëri përveç këtyre që u thanë, nuk ka as aktivitete sportive të organizuar nga pushteti vendor apo lokal, qoftë të organizuar nga vetë njerëzit.” (Tiranë, Urban)*

*“Aktivitetet në zonat e lira varen dhe nga mundësitë ekonomike dhe nga koha, pasi ata që janë dhe në pune dhe në shkollë nuk kanë mundësi kohore. (Tiranë, Urban)*

### 1.3 Aksesi në internet, mjaft i rëndësishëm për të rinjtë në Shqipëri

Të rinjtë shqiptarë, ashtu si në 2011, vijojnë të kenë akses të gjerë në internet, qoftë përmes telefonave, por edhe përmes lidhjeve të internetit në banesat e tyre. Grupet e diskutimit përforcojnë gjetjet e sondazhit në terren, sipas të cilit pothuajse 9 në 10 të rinj në Shqipëri deklarojnë se kanë akses në internet. Aksesi në internet vijon të shihet si një nevojë e rëndësishme për të rinjtë në Shqipëri, kryesisht për qëllime komunikimi, dhe informimi.

Për të rinjtë student, aksesi në internet shihet si një burim i frytshëm informacioni përsa i përket aktivitete të tyre shkollor. Pjesën tjetër të kohës në internet, të rinjtë e kalojnë në rrjetet sociale, argëtim (video, filma, muzikë, lojëra), si dhe komunikim online me të afërmit apo miqtë (skype, messenger, etj). Rezultatet e sondazhit gjithashtu treguan se aksesi në rrjetet sociale dhe komunikimi me miqtë janë arsyet kryesore për të aksesuar internetin nga të rinjtë me respektivisht 85 dhe 74% të intervistuarve të cilët e pohojnë një fakt të tillë.

*“Unë e përdor më shumë për të marrë informacion për degën që studioj si dhe për të kaluar kohën e lirë.” (Tiranë, Urban)*

*“Internetin e përdor për të parë filma, për të luajtur, për të shpenzuar kohë në fcb(facebook). Justifikimi është ta lidhim se na duhet në shkollë pastaj të tjerat.”(Tiranë, Urban)*

*“Po përveç, pasi aktivizohemi në facebook ose në rrjete të tjera sociale edhe për shkollë gjithashtu, se ngaqë kemi shumë projekte ngaqë na duhen aty për të gjetur të dhëna dhe përdoret shumë.” (Tiranë, Rural)*

*“Po për shkollë[ë përdorim internetin] petagogu mund të na çoj një email të caktuar dhe nuk na i japin drejt për drejt prandaj dhe na duhet.” (Tirën, Rural)*

## 1.4 Aksesi në internet, problem për të rinjtë në zonat rurale

Aksesi në internet vijon të ngelet problematik për të rinjtë të cilët banojnë në zonat rurale/përiferike. Ky grup shprehet se të paturit e aksesit në internet në banesat e tyre jo gjithnjë është e mundur. Qëndrat e internetit, si rrjedhojë, mbeten shpesh opsioni i vetëm për këta të rinj.

*“Zgjedhja ime [të mos kem internet në shtëpi] dhe kompjuteri është në raste kur jam pushim ose raste festash e vendosim por raste kur jam e ngarkuar me mësim nuk e përdor se mund të më shpërqëndroj prandaj.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë nuk mbaj, arsyeja e parë pse unë nuk e mbaj internetin në shpi është se të them të drejtën edhe nëse do e kisha do isha shumë i varur ndaj tij.” (Tiranë, Rural)*

*“Nuk është arsyeja financiare ta kesh të sigurt sepse nuk është më e shumta ta marrësh internetin në shpi, por do të më shpërqëndronte shumë nga mësimet, jam shumë e sigurt.” (Tiranë, Rural)*

## 2. Familja dhe rrethi shoqëror

### 2.1 Të jetuarit me prindërit, opsioni më i mirë për të rinjtë shqiptarë

Në bazë të gjetjeve në 2014, shumica e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit, ashtu si në 2011, aktualisht jetojnë me prindërit. Gjetjet e grupeve të diskutimit vërtetojnë rezultatet e sondazhit në terren sipas të cilit pothuajse 4 në 5 të rinj të intervistuar aktualisht me prindërit. Mundësitë financiare, si dhe vështirësitë e hasura gjatë kohës që disa prej tyre janë përpjekur të jetojnë vetëm (gatim, pastrim, etj.) janë arsyt kryesore pse shumë të rinj, vijnë ta shohin jetësn me prindërit si opsionin më të mirë të mundshëm.

*“Nuk e di, përderisa nuk e kam provuar nuk mund të them, po ka ndoshta momente që mund të dëshiroj të jetoj me shoqërinë, por ama familja është ajo që të mbledh se në qoftë se do të rrinim vetëm me shoqërinë kur unë e shoh edhe në oraret kur familja ime nuk është prezente në shtëpi unë vonohem shumë më tepër edhe kur bëhet fjala për të ngrën mundësisht nuk shkoj në shtëpi, por aman shkoj diku nëpërmjet lekut për të ngrën.Se di.” (Tiranë, Rural)*

*“Në Shqipëri ndryshe nga jashtë shtetit është pak e vështirë të ndahesh nga familja dhe përveç kësaj dhe mundësitë financiare nuk janë pasi nuk është e lehtë të gjesh punë.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë personalisht nuk do të doja të jetoja larg prindërve, vetëm nëse do të zgjidhja shokun tim të jetës ose te studioja jashtë dhe të kthehesha përsëri.” (Tiranë, Urban)*

*“Edhe po të punosh këtu në Tiranë, rroga nuk të mjafton që ta perballosh jetesën vetëm. Më mirë është që të jetosh me prindërit dhe të japësh një pjesë të të ardhurave në familje dhe të plotësosh dhe ata dhe veten. Në rast të kundërt duhet te gjesh një shok ose shoqe që të ndash shpenzimet se ndryshe nuk e përballon dot. (Tiranë, Urban)*

Dëshira për të jetuar të pavarur vihet re tek një numër relativisht të vogël të të rinjve. Sipas rezultateve të sondazhit, vetëm 1 në 5 të rinj të intervistuar do të donin të jetonin vetëm nëse do të kishin mundësitë e duhura financiare. Ky grup synon dhe të ndahet nga prindërit pas fillimit të studimeve universitare. Ky grup e sheh të jetuarit i ndarë nga prindërit, do të jetë gjë e mirë për ta, sepse do ti mundësojë të jenë të pavarur, sidomos financiarisht.

## 2.2 Sinqeriteti, Besnikëria, dhe respekti reciprok, vlerat më të rëndësishme për të rinjtë shqiptarë

Sinqeriteti, besnikëria, respekti, si dhe interesat e përbashkët, vijnë të jenë karakteristikat e cilat vlerësohen më së tepërmi tek miqtë nga të rinjtë në Shqipëri. Këto vlera rënditen si të më të rëndësishmet edhe nga të rinjtë e intervistuar gjatë sondazhit në terren, me 1 në 3 të intervistuar që rendisnin besnikërinë si vlerën më të rëndësishme. Të rinjtë i shohin këto tipare si mjaft të rëndësishme në ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore. Në të njëjtën kohë, gatishmëria e miqve për të ofruar ndihmën e tyre në momente të vështira, është një tipar i cili gjithashtu vlerësohet mjaft pozitivisht nga të rinjtë shqiptar.

*“Fillimisht është sinqeriteti. Gjithashtu edhe besnikëria, dmth të jesh besnik ndaj shokut dhe mos tia kesh me hile, dmth tia futësh dikujt tjetër.” (Tiranë, Rural)*

*“Sinqeriteti, besnikëria, respekti janë vlerat të cilat vlerësoj më shumë tek miqtë.” (Tiranë, Urban)*

*“Veç atyre që normalisht jam shumë dakort ato siç i renditi, unë do doja shumë dhe guxim, në lidhje me gjithçka që mund të ketë, jo në lidhje me gjëra banale por në lidhje me gjëra të cilat të japin premisa për jetën.” (Tiranë, Urban) “Mikun tim ideal unë do të doja ta kisha besnik, të sinqert gjithashtu edhe që të më qëndrojë gjithmonë në krahë në të mira dhe në të këqija.” (Tiranë, Urban)*

## 2.3 Marrëdhëniet me komshinjtë, të rëndësishme për të rinjtë në Shqipëri

Marrëdhëniet e të rinjve shqiptar me fqinjët varen nga një sërë faktorësh, duke u nisur nga lloji i banesës (shtëpi private, apartament), si dhe nga kohëzgjata e banimit në mes të një komuniteti të caktuar. Ashtu si në 2011, të rinjtë vijnë të mos kenë shumë besim tek fqinjët, duke besuar më tepër tek familja apo miqtë. Megjithatë të rinjtë shprehen të vetëdijshëm për rëndësinë e të paturit të marrëdhënieve të mira me fqinjët, kryesisht, sepse sipas tyre, në rast nevojë, fqinjët janë të parët që mund të ofrojnë ndihmë. Nevoja për të krijuar një frymë bashkëjetese në komunitetet ku jetojnë, gjithashtu shihet si e rëndësishme nga të rinjtë.

*“Unë jetoj në pallat të vogël, kam 12 vite aty dhe njihemi dhe e ndihmojmë njëri-tjetrin.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë u bën vite që kam ardhur këtu dhe duke qënë se tek lagjia ime, përsa i përket lagjies së madhe jemi nga të parët që mund të them dhe jam ambjentuar se kush do që vinte i ri, ishin prindërit ato që u njihnin dhe çdo herë më tepër me çdo familje të re kshu që po them që i njoh..” (Tiranë, Urban)*

*“Po në përgjithësi, flasim për problemin që mund të kemi janë ato [komshinjtë] kudo që të shkosh. Njerëzit e tu mund ti marrësh në telefon por janë goxha larg, nëse nuk të ndihmojnë ato që ke rreth atëherë është e kotë.” (Tiranë, Rural)*

Megjithatë, një grup i vogël i të rinjve (kryesisht ata që jetojnë me qera), hasin shpesh problem me fqinjët. Ky grup pretendon se nuk i njohin fqinjët, dhe se problemet midis tyre lidhen kryesisht me çështje e pastrimit apo mirëmbajtjes së ambienteve të përbashkëta në komunitet.

*“Ne që kemi jetuar në qytete të vogla e kemi ndjerë shumë këtë pjesën e marrëdhënies me komshinjtë pasi kemi pasur marrëdhënie të afërta ndërsa këtu në Tiranë është ndryshe. Unë kam shumë problematika me komshinjtë, të zihet rruga etj gjëra absurde. Në qytetin ku kam jetuar unë nuk ishte e nevojshme ti thoshe komshiut mos ma zërë rrugën se këtu do të kaloj unë.” (Tiranë, Rural)*

*“Shumë keq këtu në Tiranë [me komshinjtë], diskutojnë gjëra banale pa lidhje, për shkallën diskutojmë se gjë tjetër nuk na lidh me ta. Të ndalojnë të hapësh rroba në ballkon se i bën xhamin pis etj. Shumë keq.” (Tiranë, Rural)*

## 2.4 Të rinjtë shqiptarë, përgjithësisht pa paragjykime mbi komshinjtë

Prejardhja gjeografike e fqinjëve nuk përbën problem për të rinjtë shqiptarë në përgjithësi. Në ndryshim nga rezultatet e 2011, rezultat e sondazhit në terren në 2014, si dhe gjetjet e grupeve të diskutimit, tregojnë se më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar do të ndiheshin shumë mirë ose mirë, nëse pranë tyre do të zhvendosej një familje nga jugu (60%) apo një familje nga veriu (58%). Ashtu si në 2011, në përgjithësi vihet re një qasje tolerante e të rinjve Shqiptar për të bashkëjetuar në një komunitet me përfaqësues të shtresave të ndryshme sociale në vend. Shumë prej tyre shprehen se për ta nuk do të përbënte asnjë ndryshim, edhe në rast se fqinjët do të të ishin të huaj.

*“Më shumë se problem unë do ta quaja çudi dhe do me shtynte ta njihja [komshinjtë e huaj].” (Tiranë, Rural)*

*“Nuk është se do më interesonte shumë nga vinin komshinjtë, përveç faktit nëse do më kërkonte ndihmë apo do të mund ta ndihmoja do ta bëja me gjithë qef.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë në pallat kam disa komshinjë turq dhe italian dhe janë shumë të respektueshëm, nuk kam fare problem që ata janë aty.” (Tiranë, Urban)*

*“Komshinjtë e huaj zakonisht janë shumë miqësor dhe të afrueshëm, kurioz dhe të respektueshëm.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë kam 2 vite në Tiranë, më parë kam jetur në Greqi dhe nuk kam pasur asnjë problem, shumë pak grek janë racist pjesa tjetër janë të sjellshëm dhe të respektueshëm. Nuk do ta kisha problem nëse do të kisha një komshi nga greqia apo kudoqoftë.” (Tiranë, Urban)*

*“Mua më pëlqen shumë një zonjë kineze që kam në lagjie, ajo sa herë që del merr me vete një qese dhe e mëson femijen e saj që mbeturinat ti hedh aty ndërsa shqiptarët i lëshojnë në tokë.” (Tiranë, Urban)*

*« Atdhetarë jemi por jo nacionalistë, sa të shkojmë deri në atë pikë sa të jemi raciste ndaj komshinjëve. » (Tiranë, Urban)*

*“Problem I vetëm në këtë rast është komunikimi nuk kuptohemi [me komshinjtë e huaj].” (Tiranë, Rural)*

*“Nuk ka problem ka vetëm kënaqësi, sidomos me ca janë nga Korca nga Vlora sidomos zonat e Vlorës ato i kam shumë, biles kam një shok nga Vlora që na tregon ca histori shumë të bukura.” (Tiranë, Rural)*

Problematik mbetet marrëdhënia e të rinjve shqiptarë me shtresa të caktuara sociale, kryesisht me përfaqësuesit e komunitetit homoseksual. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve, shprehen se do ta kishin problem nëse pranë tyre do të jetonte një çift homoseksual. Sipas tyre, shëmbulli që do të ofronte ky çift për ta dhe familjen e tyre do të ishte i gabuar. Sondazhi në terren gjithashtu e vërteton këtë fakt me pak më shumë se gjysmën (55%) e të rinjve të intervistuar, që deklarojnë se do të ndiheshin shumë keq, ose keq nëse pranë tyre do të banonte një çift homoseksualësh. E njëjta qasje vihet re tek disa (grup i vogël) pjesëmarrës të rinj përse i përket mundësisë së të paturit fqinje një familje nga Serbia, apo Greqia si komshinj. Ngjarjet e Tetorit në Beograd (ndeshja Serbi-Shqipëri) duket të kenë pasur një efekt të konsiderueshëm tek të rinjtë Shqiptare.

*“Unë jam shumë nacionaliste dhe sa herë që kam folur në rrjetet sociale për grekët kam përfunduar duke u grindur kështu që...” (Tiranë, Urban)*

*“Unë këtë rast [kur komshinjtë janë një çift homoseksual] do ta kisha pak problem sepse domosdoshmërisht në qoftë se je komshi diku në rrugë do të përballësh me ta edhe ata janë nuk e di shumë njerëz më falni për shprehjen perversë.” (Tiranë, Rural)*

*“Neqoftese do te isha familjar do ta kisha me shume problem kte punen e neqoftese do ti kisha komshi [ciftin e homeseskualeve].” (Tiranë, Rural)*

*“Tek unë nuk ka ndonjë ndikim të madh por siç dhe ky djali më shumë tek familja tek të vegjëlit. Sot dhe femijët për çdo gjë kanë pyetje edhe ato i kanë fare mirë përgjigjet e qarta që mund ti kthejnë fëmijëve.” (Tiranë, Rural)*

### 3. Çështje besimi dhe përkatësie

#### 3.1 Të rinjtë shqiptarë: Besimtar, por jo praktikantë

Marrëdhënia e të rinjve Shqiptare me besimin, ashtu si në 2011, vijon të mbetet e ndërlikuar, përsa i përket besimit në zot, dhe praktikimit të fesë. Pavarësisht se besimi në zot pranohet nga një masë e konsiderueshme e të rinjve shqiptarë, shumë pak prej tyre deklarojnë se i praktikojnë fetë respektive.

Toleranca fetare e të rinjve në Shqipëri, më shumë se qasje personale, duket të jetë një rrjedhojë e përvojave personale të të rinjve, ku prindërit u përkasin shpesh feve të ndryshme. Vetëm disa të rinj pretendojnë se vizitojnë/kanë vizituar shpesh vendet e kultit. Shumica ndërkohë pretendon se ose se e bëjnë një gjë të tillë shumë rrallë, ose nuk e kanë bërë kurrë. Gjithashtu tregon se rreth 4 në 5 të rinj të intervistuar praktikojnë fetë e tyre vetëm gjatë festive fetare (Krishtlindje, Pashkë, festa e Novruzit, etj).

*“Unë besoj në zot por nuk i praktikoj ritet fetare. Më pëlqen që ti vizitoj të gjitha këto ndërtesat fetare, kisha, xhami.” (Tiranë, Urban)*

*“Mua kur më bie rasti të shkoj në ndonjë kishë apo xhami dhe futem.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë besoj në zot por jo tek besimet fetare.” (Tiranë, Urban)*

*“Familja ime është myslymane dhe unë di që besoj në zot po se di se si quhet, se quhet allah se quhet krisht di që është dikush.” (Tiranë, Rural)*

*“Besimi në zot është i rëndësishëm thjesht në momentin kur lutemi për diçka të kemi besim për atë që kërkojmë. Unë nuk po them te vesh të ndjekësh rregullat si muaji Ramazanit e kto, por thjesht të besosh në atë që kërkon.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë frekuentoj unë jam myslyman por vete në kishën e Laçit nuk kam qef as në xhami as në kishë tjetër.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë do thoja që besoj në zot por që nuk praktikoj ndonjë fe unë nga familja ime jam myslymane por nuk praktikoj fe “ (Tiranë, Rural)*



## 3.2 Besimi fetar, jo faktor i rëndësishëm për marrëdhëniet me miqtë

Besimi fetar nuk shihet nga të rinjtë shqiptarë si një faktor që ka ndikim të madh në marrëdhëniet me miqtë. Në pothuaj asnjë rast, nuk vihet re një tendencë e të rinjve pjesëmarrës për të pasur një marrëdhënie konfliktuale me miq të besimeve të ndryshëm.

Ndërkohë, edhe përsa i përket faktorëve të cilët ndikojnë në zgjedhjen e tyre të partnerit/es apo bashkëshortit/es së tyre të ardhshme, besimi fetar nuk është i rëndësishëm për të rinjtë shqiptarë. Megjithatë, një grup fare i vogël i pjesëmarrësve shprehen se prindërit e tyre do të preferonin që bashkëshorti/bashkëshortja e tyre në të ardhmen të jetë nga i njëjti besim. Shumë prej të rinjve pjesëmarrës shprehen se festojnë të gjitha festat fetare, pavarësisht besimit të tyre dhe familjes. Të rinjtë e konsiderojnë këtë qasje si një vlerë të çmuar dhe mjaft pozitive të shoqërisë në Shqipëri.

*“Edhe unë do të thosha që[harmonia fetare] është një gjë e mirë dhe e bukur që besojmë në diçka dhe e shfaqim duke festuar diçka e pranon tjetrin e beson tjetrin.” (Tiranë, Rural)*

*“Gjëja e fundit që më intereson është feja të paktën për mua por që ka dhe njerëz radikal që meren.” (Tiranë, Rural)*

*“Për mua besimi fetar nuk është i rëndësishëm në një marrëdhënie me një shok apo shoqe por vetë jam ndier i diskriminuar për shkak të besimit tim myslyman. Dikush i cili ishte ortodoks më ka thënë që i kam inat myslymanët.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë kam një rast të veçantë, kam mamën dhe babin jo të së njëjtës fe dhe të dy e respektojnë njëri-tjetrin, i festojmë të gjitha festat.” (Tiranë, Rural)*

## 4. Shqetësime dhe Aspirata

### 4.1 Të rinjtë shqiptarë, të gatshëm për tu larguar nga Shqipëria

Situata përsa i përket dëshirës së të rinjve për tu larguar nga vendi, mbetet përgjithësisht e pandryshuar krahasuar me 2011. Kështu, edhe në 2014, shumica e të rinjve në grupet e diskutimit shprehen se do të largoheshin nga Shqipëria nëse do tju jepej një mundësi e tillë. Sondazhi në terren gjithashtu konfirmon gjetjet e grupeve të diskutimit përsa i përket dëshirës së të rinjve për të emigruar. Sipas rezultateve, rreth 9 në 10 të rinj të intervistuar do të dëshironin të emigronin nëse do të ju jepej mundësia.

Arsyet e dhëna nga të rinjtë për largimin nga Shqipëria, lidhen kryesisht me shpresën për mundësi më të mira studimi jashtë Shqipërisë, si dhe garantimin e një standardi më të mirë jetese. Mungesa e një sistemi meritokratik për punësimin, varfëria dhe papunësia janë disa prej arsyeve të tjera të renditura nga të rinjtë shqiptarë. Pavarësisht dëshirës së pandryshuar për të emigruar, një numër i konsiderueshëm i të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit shprehen të gatshëm për tu rikthyer dhe të investojnë në Shqipëri të ardhurat nga emigracioni.

*“Do të doja të emigroja, ndoshta për master dhe të kthehem prapë. Sepse po të bësh një master jashtë mund të gjesh një punë më të mirë kur kthehesh.” (Tiranë, Urban)*

*“Dua të largohem sepse jam mërzitur me përditshmërinë këtu. Më pëlqen të jem i pavarur dhe të jetoj vetëm. Për të krijuar të ardhura ekonomike më të mira.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë do të emigroja për mundësi më të mira shkollimi, që në një të ardhme të largët të kthehem këtu dhe të bëj diçka, ndërsa këtu me këtë shkollim dhe këto rrethana që kam ndihem shumë inferiore. Jashtë do mundohem të njoh më shumë, do kem një kulturë dhe mentalitet tjetër.” (Tiranë, Urban)*

*“Këtu shkon në gjykatë rryshfet, në spital rryshfet. Mbaron shkollën e lartë dhe nuk ke punë, duhet ose mik ose lek ndërsa jashtë shtetit nuk ekzistojnë këto gjëra, nëse ke rezultate të mira në shkollë në mos sot nesër do a kesh nje vend pune.” (Tiranë, Urban)*

*“Arsyeja e parë[pse do të emigroja] është ekonomike dhe nuk ka një të ardhme të sigurt këtu në vendin tonë unë aktualisht studioj por mesa kemi dëgjuar ose çflitet duhet paguar për një vend pune dhe nuk varet në varsi të aftësive por nga buxheti.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë personalisht për arsye që dua të emigraj është çështja ekonomike dhe papunësia para një jave një rast konkret dhe më kërkuan 3000 euro për të hyrë në filan pune.” (Tiranë, Rural)*

*“Dhe unë për vete do doja tu largoja biles jam penduar që kam zgjedhur të vazhdoj masterin këtu në shqipëri të vazhdoja jashtë sepse ka më shumë mundësi për tu punësuar dhe për tu integruar në shoqërin europiane e mira e të mirave është që ta vazhdon ne Amerikë.” (Tiranë, Rural)*

## 5. Arsimimi dhe punësimi

### 5.1 Njohjet dhe paraja, faktorët kryesorë që të garantojnë punësim në Shqipëri sipas të rinjve në Shqipëri

Miqtë, paraja si dhe të paturit e profilit të duhur (arsimor) vijnë nga të rinjtë në grupet e diskutimit si faktorët kryesorë të cilët ndihmojnë në gjetjen e një pune në Shqipëri, ngjashëm me gjetjet e vitit 2011. Shumë prej tyre ankohen për mungesën e një sistemi të mirëfilltë meritokratik në vend, i cili do të mundësonte punësimin e më të mirëve në profesionet e ndryshme. Pjesëmarrësit gjithashtu ankohen për mungesën e informacionit mbi tregun e punës nga institucionet përgjegjëse. Zyrat e punës, apo zyrat e këshillimit të karrierës, sipas të rinjve mungojnë, janë jo efikase, si dhe shpesh herë mjaft të vështira për tu gjetur.

*“Unë mendoj se arsimi është shumë i rëndësishëm, në radhë të parë për kulturë personale dhe pastaj për të gjetur punë, por më e rëndësishmja nga të gjitha është të jesh në kërkim gjithmonë sepse mikun dhe lekët mund ti kesh ose jo por që po të kërkosh gjen.” (Tiranë, Urban)*

*“Shumica kur kërkojnë punë them për punëmarrësit duan njerëz me eksperiencë, ne që mbarojmë shkollën jemi studentë, tani që mbarojmë shkollë nuk kemi eksperiencë ku të shkojmë ku ta marrim eksperiencën?” (Tiranë, Urban)*

*“Faktori mik është më e rëndësishmja për të gjetur punë në Shqipëri.” (Tiranë, Urban)*

*“Një punë kërkon shumë arsim në fushën profesionale dhe në pjesën akademike por që në shqipëri këto janë zbehur dhe gjithmonë po hyjnë ato që janë me miq.” (Tiranë, Rural)*

*“Ka mungesë informimi, duhet të kesh njohje. Unë për vete nuk di ku të drejtohem për të gjetur një punë.” (Tiranë, Urban)*

*“Këtu zyrat e punës të kërkosh nuk i gjen dot me lehtësi, duhet të levizësh sa andej – këtej. Këtu shkon të gjesh punë dhe të thonë po nuk pate eksperiencë nuk mund të punësohesh.” (Tiranë, Urban)*

*„Po flas për pamundësinë e informimit, unë dua të punoj dhe vullnetarisht por nuk di ku, nuk kam ku të informohem.” (Tiranë, Urban)*

## 5.2 Të rinjtë shqiptarë, të informuar dhe optimist mbi avantazhet e arsimit profesional në Shqipëri

Të rinjtë shqiptarë janë relativisht të informuar mbi arsimin profesional në vend. Shumë prej tyre e shohin arsimin profesional është një opsion mjaft i mirë, i cili rrit shanset e të rinjve për të gjetur punë, pavarësisht se shumë prej tyre shprehen se tashmë kanë zgjedhur universitetet për arsimin e tyre. Në të njëjtën kohë, të rinjtë mendojnë se arsimi profesional ka marrë një hov gjatë viteve të fundit në Shqipëri, i cili vërtetohet edhe nga numri në rritje, sipas tyre, i studentëve që zgjedhin një opsion të tillë për të ardhmen e tyre. Ndërkohë, rezultatet e sondazhit që një numër i konsiderueshëm prej 20% të të rinjve të intervistuar në terren, shprehen preferencën e tyre për të zgjedhur arsimin profesional nëse do t’ju duhej të zgjidhnin.

*“Unë vazhdoj teknologji ushqimore. Ndonjëherë shkoj tek shkolla Hoteleri-Turizëm dhe shoh që sot ndryshe nga më parë ka më shumë femra dhe ka më shumë nxënës. Më parë kam studiuar atje por e lash se ashtu erdhën kushtet në familje.” (Tiranë, Urban)*

*“Arsimi profesional arsimi që ti kryen mbasi mbaron arsimin 9-vjeçar ti nuk futesh në një shkollë të mesme të përgjithshme po futesh në një shkollë të mesme profesionale në një degë të caktuar që mund të jetë hidraulik elektirçist mekanik.” (Tiranë, Rural)*

*“Unë kam shtëpinë tek shkolla Hoteleri-Turizëm dhe kam vënë re që kohët e fundit janë shtuar shumë nxënësit.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë kam një vëlla të vogël dhe mami thoteë që nëse nuk fiton universitetin të vazhdojë një shkollë profesionale për të patur mundësi të keteë një profesion që të hajë bukë.” (Tiranë, Urban)*

*“Dhe ajo është një shkollë shumë e mirë nga ato që po bëhen tani për faktin se një zanat dhe mund të gjesh punë dhe pa mik thjesht sepse njeriut në kohët e sotme i nevojitet ai zanat dhe do sdo një njeri po mar shembullin elementar nëqoftëse do ti prishej soba apo lavatriçja në shpi do ta kërkojë me patjetër një elektrikist nuk do ketë rrugë zgjidhje tjetër.” (Tiranë, Rural)*

*“Për mendimin tim arsimit profesional është gjëja më e mirë që mund të bëhet për arsyen e thjeshtë se ka studentë të cilët nuk mësojnë dhe kanë mundësinë që të marrin një zanat, mekanik, hidraulik apo diçka tjetër.” (Tiranë, Urban)*

*“Shkolla profesionale është një opsion i mirë për ata që janë të vendosur për atë që duan të bëhen. Do ishte më mirë po të fillohej që në gjimnaz. Mua më është ofruar dhe nuk e kam dashur, kam preferuar më mirë një arsim të përgjithshëm.” (Tiranë, Urban)*

*“Po e kam menduar[arsimin profesional si opsion], më shumë për vëllain se sa për vete se është tjetër për meshkujt dhe tjetër për femrat sepse unë nuk mund të bëhem hidraulike apo elektrikiste. Për djemtë të cilët nuk e kanë aftësinë të lexojnë është një gjë e mirë.” (Tiranë, Urban)*

## 5.3 Të rinjtë shqiptarë, përgjithësisht perceptim negativ mbi universitetet private

Perceptimi për universitetet private tek të rinjtë vijoje të mbetet përgjithësisht negativ, krahasuar me studimin në 2011. Shumë prej të rinjve shqiptarë mendojnë se këto universitete nuk ofrojnë një system vlerësimi meritokratik për studentët, duke e zëvenduar atë me pagesat nën dorë. Në të njëjtën kohë, sipas të rinjve, diplomat e lëshuara nga këto universitet në fund të studimeve, në shumicën e rasteve as nuk merren parasysh nga punëdhënësit në tregun e punës, për shkak të cilësisë së dobët. Universitetet private shihen nga të rinjtë si institucione të cilat ofrojnë një cilësi të dobët arsimimi, si dhe janë shpesh të papërbalueshëm nga ana financiare për studentët.

*“Në universitet privat, paguan 3500 lek ne vit dhe të thotë profesori çfarë note do që ta vendos.”*

*(Tiranë, Urban)*

*“Unë personalisht kam një kushëri që jeton në Greqi dhe po e merr shkollën në një universitet privat këtu duke mos ardhur fare. Vjen duke vetëm jep lekët e provimeve dhe kaq.”*

*(Tiranë, Urban)*

*“Universiteti privat është skandaloz, edhe në punë nuk i marrin.”*

*(Tiranë, Urban)*

*“Kemi dëgjuar për lloj-lloj skemash[që ofrojnë universitetet private], dokumentash nga më skandalozesh etj.”*

*(Tiranë, Urban)*

*“Janë shumë të pakta universitetet private që kanë cilësi të mirë mësimdhënie, mund të jenë 2-3 ndërsa të tjerat lënë për të dëshiruar.”*

*(Tiranë, Urban)*

Megjithatë, një numër më i vogël i të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit vlerësojnë disa prej universiteteve private në Shqipëri, duke konsideruar cilësinë e arsimit si dhe reputacionin e këtyrë të fundit si mjaft të mirë. Pavarësisht këtij vlerësimi, edhe këto institucione, sipas të rinjve, rrallë ofrojnë tarifa të përballeshme për studentën në Shqipëri.

*“Unë personalisht i kam të ndara universitetet private. Ka disa që janë të mirë, psh Zonja e Këshillit të Mirë, do të doja të studioja aty pasi ka mësimdhënie më cilësore dhe kushte më të mira por nuk kam mundësi financiare. Çmimet janë shumë të larta dhe të papërballeshme.”*  
(Tiranë, Urban)

*“Unë vazhdoj studimet në univeristet privat dhe mund të them me shumë bindje të plotë që rregullat normat të gjitha mësimdhënia është më e mirë se në shtet aty ku vazhdoj unë”*  
(Tiranë, Urban)

*“Duke qënë se jam pjesë e arsimit publik, ka disa universitete private që ofrojnë shumë kushte të mira për studentët përpos tarifës së shtrenjtë të shkollimit që kanë. Por ajo tarife përputhet, përputhet. Mendoj se ja vlen të shkosh në një universitet privat, psh te UET, te UFO. Ka dhe treg pune. Ata, mbasi mbaron aty, të integrojnë në një vend pune. Duket sikur vendi i punës është i hapur, është rruga e hapur për një vend pune.”*  
(Tiranë, Rural)

*“Ti mund të kesh shpenzuar shume para për universitetin privat, por ama ne të ardhmen do të kesh një pune, do ta kesh fituar atë. Sepse ne universitet publik edhe gjë, por në universitetin privat do ta kesh më të thjeshtë.”*  
(Tiranë, Rural)

*“Po mar dy shembuj Kristali që nuk i njihet diploma sot është e kot që të vesh në atë shkoll dhe UET që kam dëgjuar që është shumë shkoll e mirë, por mendoj që kur del nga Uet ke një rrugë të hapur mendoj unë emri është një nga arsyt psh merr diplomën e Kristalit nuk ke çë do është e kotë të financosh për aty.”*  
(Tiranë, Rural)



## 6. Qeverisje dhe Zhvillim

### 6.1 Politika, punësimi dhe drejtësia, sfidat kryesore të vendit sipas të rinjve në Shqipëri

Politika, punësimi, drejtësia, dhe siguria janë problemet kryesore në vend sipas të rinjve në grupet e diskutimit. Shumë prej të rinjve e shohin politikën si shkaktare të problemeve të cilët ata hasin në jetën e përditshme. Të rinjtë shqiptarë shprehin gjithashtu mjaft rezerva për funksionimin e sistemit të drejtësisë, të cilin e vlerësojnë si të korruptuar dhe të paaftë.

*“Politika nuk po bën asgjë. Presim mos përmiresohen gjërat por asgjë nuk ndryshon.” (Tiranë, Urban)*

*“Kemi dhe probleme të tjera siç është dhuna dhe krimet që janë shtuar shumë kohët e fundit.” (Tiranë, Urban)*

*“Drejtësia, pra nëse ke ndonjë problem me drejtësinë, megjithëse mua nuk më ka rënë ndonjëherë rasti por mendoj se nuk do ta zgjidhja dot pa pasur në mes ndonjë devijancë.” (Tiranë, Urban)*

Korrupsioni shihet gjithashtu si një nga problemet kryesore me të cilat përballet vendi sipas të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit. Veçanërisht korrupsioni në sistemin arsimor, shihet si mjaft i dëmshëm nga pjesëmarrësit, qoftë për cilësinë e arsimit, si dhe për faktin se fenomeni bëhet shpesh pengesë për ngritjen e një sistemi meritokratik për studentët.

*“Normalisht [korrupsioni]e ul shumë cilësinë e arsimit, sepse nëse nuk i ke aftësitë për ta marrë një provim ti e blenë provimin dhe në këtë mënyrë nuk je i aftë për atë lende. Nëse dikush ka mbaruar shkollën për mësues dhe këtë shkollë e ka marrë me lek, çfarë edukimi do tu jap nxënësve në të ardhmen???. Kështu bie cilësia e arsimit.” (Tiranë, Urban)*

*“Mënyra se si kemi zgjedhur të jetojmë, në pranojmë mikun, rryshfetin, lekun. Ne pranojmë të japi, lekun dhe të mbarojmë punë të parët, pranojmë ti japim lek infermieres etj. Kjo është, duhet të ndryshojmë vetë në fillim dhe jo ta presim nga të tjerët.” (Tiranë, Urban)*

*Na intereson të dimë nëse ka korrupsion në arsim, sepse futet në punë një që nuk e meriton, ose e merr notën dhe pa ardhur fare në shkollë.” (Tiranë, Urban)*

*“Korrupsioni sjell probleme në shoqëri pasi marr një shembull të një hidrauliku që mund ta ket marrë diplomën me pagesë ai nuk di ta rregullojë problemin që ka, për shembull dhe sjell dëme në shoqëri diku më i vogël diku mund të bëhet më i madh.” (Tiranë, Rural)*

## 6.2 Të rinjtë në Shqipëri, vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies, por të pakënaqur me infrastrukturën në shkolla

Përgjithësisht, të rinjtë pjesëmarrës në grupet e diskutimit shprehen të kënaqur nga cilësia e mësimdhënies në Shqipëri. Të rinjtë vlerësojnë pozitivisht mësuesit me përvojë të gjatë pune, duke i konsideruar ata si të mirëpërgatitur.

Megjithatë, shumë prej të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit ankohen për mungesën e infrastrukturës së nevojshme në sistemin arsimor Shqiptar. Mungesa e laboratorëve, apo infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e praktikës në shkolla, është një pengesë të cilën të rinjtë pretendojnë se e hasin shpesh në auditoriume.

*“Tek brezat e moshuar është e mirë ndërsa kohët e fundit tek të rinjtë është skandal, shumë dobët. Mësues të cilët kanë mbaruar me notën 6 dhe na japin mend neve që jemi me 8 e lartë.” (Tiranë, Urban)*

*“Nga ana e profesorëve nuk kemi vërejtje por nga ana e infrastrukturës po. Une jam për Kimi Industriale dhe nuk kemi laboratore, janë vetëm disa gjëra që kanë qënë që në kohën e Enverit.” (Tiranë, Urban)*

*“Është mire, jo vetëm profesorët e vjetër por dhe disa profesorë të rinjtë kanë dalë shumë të mirë. Më shumë duhet të investohet tek rregulli se sa tek cilësia e arsimit pasi ajo është e mirë, por ne na ndodh që shkojmë në*

*kafe vetëm sepse nuk kemi vend ku të ulemi në auditor. Gjithashtu të ketë dhe ambiente ku studentët të kenë mundësinë të presin nëse kanë një orë pushim dhe të mos jenë të detyruar të presin në kafe.” (Tiranë, Urban)*

*“Ka mungesë të laboratorëve. Dmth infrastruktura e shkollës për zhvillimin e praktikave është zero, me shumicë.” (Tiranë, Rural)*

## 7. Politikë

### 7.1 Të rinjtë shqiptarë, të ndarë përsa i përket interes të tyre mbi zhvillimet politike në vend

Të rinjtë në Shqipëri janë të ndarë përsa i përket interesit të tyre për çështjet dhe zhvillimet politike në vend. Gjetjet e grupeve të diskutimit si dhe ato të sondazhit janë të ngjashme me ato të vitit 2011 në këtë aspekt. Sipas rezultateve të 2014, 40% e të rinjve shprehen të interesuar, ose shumë të interesuar për zhvillimet në vend. Shumë prej tyre shprehen mjaft të interesuar për zhvillimet e fundit politike në vend, duke u shprehur se i tërheqin emisionet e debatit mbi politikën në vend.

Nga një numër i konsiderueshëm i të rinjve ndëkohë, politika shihet si diçka e nevojshme, sidomos përsa i përket garantimi të një të ardhmeje më të mirë për ta në vend. Disa të rinj gjithashtu shprehen se janë të interesuar kryesisht për faktin se prindërit e tyre janë aktualisht pjesë e administratës publike, dhe vendi i tyre i punës shpesh varet nga situata politike në vend.

***“Jam i interesuar për politikën. I ndjek të gjitha. Nuk e bëj këtë gjë për kënaqësi por për informim. Ehtë pjesë e ndërgjegjes së një individi të jetë e informuar për atë që ndodh.”*** (Tiranë, Urban)

***“Unë personalisht ndjek emisionin Opinion me të gjitha temat që ai transmeton.”*** (Tiranë, Urban)

***“Do apo nuk do je i interesuar se vetëm atë jep jam i interesuar por kur ka ndonjë gjë me rëndësi.”*** (Tiranë, Urban)

***“Po i ndjek dhe jam i interesuar sepse kam prindërit të dy të punësuar në shtet dhe postet e tyre nga apolitike janë kthyer në politike, përveç kësaj jam i interesuar dhe për çështjet e ndryshme të përgjithëshme.”*** (Tiranë, Urban)

***“Në momentin që po flas tani më intereson për faktin lidhur me familjen sepse prindërit i kam në punë shteti dhe ktu ekziston akoma mundësia që nëse ndërrohen krahjet politike ndërrohen edhe nënpunësit gjë që ka ndodhur para shumë vitesh. “ (Tiranë, Urban)***

***“Politika në Shqipëri është pjesë e pandashme e shoqërisë. Nëpërmjet politikës bëhen reformat këtu ne vendin tonë. Nëpërmjet pushtetarëve bëhen reformat. E ndjek se çfarë bëhet për shëndetësinë, ku edhe studioj për infermieri, më pëlqen kjo pjesë, por edhe në përgjithësi për arsimin, për këto çështjet ekonomike, për taksat. Edhe i ndjek disa emisione politike. Ndjek Top Story-n te Top Channel, ndjek emisionet e Eni Vasilit te News 24. Më pëlqen.” (Tiranë, Rural)***

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i të rinjve shprehen shumë pak, ose aspak, të interesuar mbi çështjet politike në vend. Si arsye për mungesën e interesit përmendet zhgënjimi me partitë politike. Për një pjesë tjetër të të rinjve, politika thjesht nuk është terheqëse, ndërsa preferojnë të ndjekin zhvillimet e lidhura me çështje të tjera në vend.

Për me tepër, të rinjtë Shqiptar, ashtu si në 2011, vijnë të kenë një perceptim tejet negativ për politikanët në Shqipëri. Shumë prej tyre shprehen se pothuajse të gjithë politikanët i përkasin një kategorie, dhe se ata janë shkaku kryesor i problemeve me të cilat përballet vendi aktualisht. Të rinjtë shprehen gjithashtu në favor të përfaqësimit të tyre nga politikanët të rinj. Megjithatë, aktualisht pjesëmarrësit mendojnë se politikanët e rinj në partitë kryesore janë thjesht kopje e modelit të liderëve të tyre, duke mos ofruar asnjë gjë të re përsa i sjelljes së tyre politike.

***“Unë as shumë dhe as pak. Ndryshimet kryesore i ndjek por është bërë kaq keq tani sa më mirë të mos e ndjekësh fare.” (Tiranë, Urban)***

***“Nuk shoh fare, nuk më tërheq politika..” (Tiranë, Urban)***

***“Unë shoh shumë pak politikë.” (Tiranë, Urban)***

***“Sa vjen dhe zbehet se kur e sheh se nuk po nxjerrin gjë në dritë çti shohësh. I ndjek vetëm rastësisht.” (Tiranë, Urban)***

***“I interesuar nuk jam por kur qëllon televizori aty i ndjek.” (Tiranë, Urban)***

***“Ka mbaruar ndonjëri për politike aty? Aty ka shtangiste, sportiste, piktorë, doktorë, ç’lidhje kanë ata me politikën.” (Tiranë, Urban)***

***“Nuk bëjnë për ne, ata që kanë qënë të aftë kane ikur.” (Tiranë, Urban)***

***“Politikanët janë arsyeja e të gjitha problematikave që po diskutojmë sot.” (Tiranë, Urban)***

***“Politikanët e rinj nuk ndihen fare. E kanë mendjen të vjelin sa më shumë nga shteti për aq kohë sa jane ne pushtet. Duhet të të hiqen politikanët që kanë që nga 91-shi do të hiqen. Ato kanë 20 vjet në politikë kështu që do të hiqen. Do të rigjenerohet politika.” (Tiranë, Rural)***

Politika vijon të jetë një temë e cila zë një vend të konsiderueshëm në bisedat e të rinjve me miqtë. Megjithatë, sipas të rinjve, bindjet politike të miqve nuk ndikojnë aspak në marrëdhëniet me ta.

Ndërkohë, angazhimi i të rinjve në aktivitete politike vijon të mbetet i vogël. Vetëm një numër i vogël i të rinjve pjesëmarrës deklarojnë se janë përfshirë në aktivitete politike. Disa të rinj gjatë grupeve të diskutimit deklarojnë se kanë qënë të angazhuar në aktivitete politike në parti të ndryshme në Shqipëri. Disa prej këtyre të rinjve i konsiderojnë angazhime të tilla (kryesisht gjatë fushatave zgjedhore) si mundësi të mira për tu punësuar.

***“[Do donit të angazhoheshit në aktivitete politike?] Duke parë që mund të gjejmë punë edhe mundet.” (Tiranë, Urban)***

***“[Do donit të angazhoheshit në aktivitete politike?] Edhe po, edhe jo, varet. Varet nga kush është në pushtet me një fjalë ndikon kjo gjë mund të jetë partia e kundërt në pushtet dhe ti je me partinë e kundërt dhe ti nuk mund të ngresh zërin në thonja sepse të ulin.***

*“Kanë shumë pak ndryshime ndërmjet të majtës dhe të djathtës. Nqs i gjykojmë në parim të majtet kane politike për përkrahjet sociale, për të varfërit, ndërsa të djathtët kanë këtë për tregun e lirë, për privatizimin, pra për biznesmenët kurse nga ana tjetër janë këta punëtorët. Kë Kjo diference në Shqipëri është shumë e pakët, shumë e pakët. Këtu në Shqipëri më shumë si te thuash është e kopjuar nga vendet e tjera, nga shtetet e Europës” (Tiranë, Rural)*

*“Unë kam miq që janë të sëmurë mbas politikës. Ndryshim nuk kam në mënyrën e të sjellurit por ata duhet të largohen sa më parë nga kjo varësi që kanë. Marrëdhënia nuk ka ndikim nga kjo gjë.” (Tiranë, Urban)*

*“Unë personalisht gjej tema të tjera për diskutim. Nuk besoj se kjo [politika] është tema më e mirë për tu diskutuar.*

*“Nuk ndodhin gjithmonë diskutimet kështu. Ka dhe njerëz që diskutojnë për politikën, për mendimet e tyre edhe bëjnë një krahasim dmth. Nëse ti je me X parti dhe tjetri me një Y parti, bën ato krahasimet, edhe ti informohesh. “ (Tiranë, Rural)*

*“Unë jam me Partinë Socialiste, kam shumë kontakt të fortë me të dhe kam shume shokë të ngushtë që janë me PD-në. s’ka asnjë problem në aspektin shoqëror flas.” (Tiranë, Rural)*

## 7.2 Policia, institucioni tek i cili të rinjtë shqiptarë besojnë më shumë, ndërsa KQZ-ja institucioni tek i cili besojnë më pak

Të rinjtë nga zonat urbane, por edhe nga ato rurale, ashtu si në 2011 vijojnë të shfaqin besim të ulët tek institucionet në vend. Shumica e pjesëmarrësve deklarojnë se Policia është institucioni tek i cili kanë më tepër besim, ndërkohë që gjykatat dhe KQZ-ja janë institucionet tek të cilat ky grup i popullsisë beson më pak. Sipas rezultateve të sondazhit në terren, 3 në 5 të rinj të intervistuar shprehen se kanë shumë, ose disi besim tek Policia.

***“Nuk kam shumë besim tek asnjë institucion, për të mos thënë që nuk kam fare.” (Tiranë, Urban)***

***“Më pak besim kam tek gjykatat dhe më shumë në perspektivë kam tek shëndetësia.» (Tiranë, Urban)***

***“Tek policia mesa shihet ka një rritje besimi. Nuk del dot në makinë pa rrip sigurimi, në motorr pa kokorapo nuk e shkel dot semaforin.” (Tiranë, Urban)***

***“Unë tek policia kam besim, tek gjykata nuk kam besim.” (Tiranë, Rural)***

***“KQZ ka dhënë prova që populli voton, ata i fusin në kuti të gabuara. Janë në mospërputhje me votën se ku e çon populli. KQZ nuk mendoj se po e bën punën e saj. Edhe Gjyqësori po ashtu nuk është i pavarur. Sistemi demokratik funksionon që të jetë ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori të jenë në mënyrë të pavarur.” (Tiranë, Rural)***

***“Unë nuk u besoj [institucioneve në Shqipëri] se nuk janë transparente. Në atë informacion që marrim, e marrim nga media. Edhe media në Shqipëri nuk është aq e pavarur, është shumë e varur. Pothuajse të gjitha ato stacionet televizive janë të varura. Kështu që nuk na jepet informacioni siç duhet.” (Tiranë, Rural)***

***“Cdo institucion është i varur, si media, si parlamenti, si sistemi gjyqësor. Të gjitha janë të varura.” (Tiranë, Rural)***



## 8. Bashkimi Europian (BE)- Proçesi i integritimit

### 8.1 Të rinjtë shqiptarë, përgjithësisht të informuar mbi integrimin Europian të Shqipërisë

Të rinjtë shqiptarë janë përgjithësisht të informuar mbi statusin aktual të Shqipërisë në proçesin e integritimit Europian. Shumë prej pjesëmarrësve në grupet e diskutimit ishin në dijeni të faktit se Shqipëria është tashmë zyrtarisht vend kandidat për anëtarësim. Megjithatë, një pjesë e vogël e të rinjve pjesëmarrës në grupet e diskutimit shprehen shqetësimin e tyre mbi faktin se se informacioni mbi proçesin e integritimit në përgjithësi mungon, ose është i pamjaftueshëm.

***“[Në çfarë faze është Shqipëria përta i përket integritimit në BE?]Me aq sa kam dëgjuar, jemi thjesht vend kandidat.”*** (Tiranë, Urban)

***“Në çfarë faze është Shqipëria përta i përket integritimit në BE? Kemi marrë statusin e vendit kadidat.”*** (Tiranë, Urban)

***“[Në çfare faze është Shqipëria përta i përket integritimit në BE?] Statusin e kantidatit e kemi marre tani nuk ka shumë kohë, vjet.”*** (Tiranë, Urban)

***“Nuk ka informacion të lirshëm për lexuesen të lirshëm dhe jo për ata që marrin pjesë në struktura.”*** (Tiranë, Urban)

***“Unë personalisht nuk kam gjetur mjaftueshëm informacion kur kam kërkuar për integrimin Europian.”*** (Tiranë, Urban)

## 8.2 Të rinjtë shqiptarë, mbështetës të integritimit European

Përgjithësisht, të rinjtë shqiptarë, ashtu si në 2011, vijonë të shfaqen mbështetës të anëtarësimit të vendin në Bashkimin European. Gjetjet e grupeve të diskutimit vërtetohen edhe më tej nga rezultatet e sondazhit, sipas të cilit pothuajse 9 në 10 të rinj do të votonin pro anëtarësimit në një referendum të mundshëm. Për të rinjtë shqiptarë, anëtarësimi në Bashkimin European do të sillte mundësi më të mira arsimimi për ta, standard më të mirë jetese, si dhe mundësi për lëvizje të lirë. Ky grup i të rinjve e sheh anëtarësimin në Bashkimin European si një garanci për më shumë investime të huaja në Shqipëri në të ardhmen.’

***“Eshtë një mënyrë shumë e mirë zhvillimi duke parë dhe vendet e tjera që janë pjestar të Bashkimit European zhvillim ekonomik të mirë, kanë një mënyrë jetese shumë më të mirë dhe kanë shumë përparësi.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Unë jam pro sepse do të ndihmonte shoqërinë në çdo aspekt mjekësi në infrastrukturë në çdo aspekt shqipëria do të ishte një vend më i përparuar më ndryshe nga çështë pasi diktatura e ka len më shumë pasoja.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Një arsye pse do të isha pro nëse do të futeshim në Bashkimin European dhe Europa është më e zhvilluar se në çdo kush ose do marri zhvillim ose do dobësohet e kam fjalën si nga ana, nga të gjitha anët që mund të merret një shtet apo populli i këtij shteti. Unë jam shumë i sigurt se nëse do të futeshim në Bashkimin European vetëm do të mernim fuqi.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Në plan të parë krahasohet BE-SHBA. Nqs Shqipëria anëtarësohet në BE, do të ketë një rritje të nivelit ekonomik, do rritet infrastruktura, dmth do të barazohet me vendet e tjera. Do të rritet Banka.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Anëtarësimi në BE ka dhe avantazhet në korrupsion. Korrupsioni do të ulet sepse do të ketë kontroll, si në institucione, si në biznese e të gjitha.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Një avantazh tjetër për çështjen e subvencionimeve në bujqësi. Dmth do të jetë një avantazh sepse do të ketë kontroll më të lartë, ndërsa tani politika funksionon shumë keq. Dmth ai që ka mikun, e merr subvencionin, I jep 5 milion atij X dhe vetë merr 30. Ose psh tjetri që nuk ka mik, nuk merr fare, ndërkohë që ai mundohet me e bo investimin, mundohet me u punësu në shtëpinë e vet në familjen e vet në tokën e vet edhe kur vjen puna nuk merr gjë nga shteti. Kjo do jetë një favor për pjesën më të madhe, ose për pjesën që jeton në fshat që vetë punësohen,”***  
(Tiranë, Rural)

***“Mund të lëvizim lirshëm, të zgjedhim ku të jetojmë dhe jo siç është tani që qendron vetëm tre muaj.”***  
(Tiranë, Urban)

***“Mendoj se do të përfitonim [nga anëtarësimi në BE] se do të vinin më shumë investitor të huaj shtetëror dhe jo fantazmë siç vijnë tani.”***  
(Tiranë, Urban)

Ndërkohë, anëtarësimi në Bashkimin Europian shihet me skepticizëm nga një grup i vogël i të rinjve shqiptarë. Të rinjtë në këtë grupshprehen të shqetësuar për faktin se vendi nuk është në të njëjtin nivel ekonomik si vendet e tjera anëtare. Në këtë mënyrë, sipas tyre, Shqipëria rrezikon të përfshihet në një krizë ekonomike ashtu si Greqia, Italia, Spanja etj. Për më tepër, këta të rinj mendojnë së Bashkimi Europian nuk do të sillte asnjë ndryshim konkret në jetën e tyre.

***“Jam kundër anëtarësimit sepse do na mbysin po u bëmë antare, do na blejnë siç bëri dhe NATO që ne vetëm paguajmë për të.”***  
(Tiranë, Urban)

***“Nuk ndodh në të gjitha rastet që anëtarësimi të sjell zhvillim. Kemi rastin e Greqisë e cila është futur në borxhe në fund me Gjermaninë dhe është pjesë e Bashkimit Europian dhe ajo.”***  
(Tiranë, Rural)

***“Jam kundër jo për faktin se nuk do e doja një Shqipëri më të mirë apo më të zhvilluar po se vendet që janë në Bashkimin Europian nuk e kanë***

*fituar zhvillimin se janë pjesë e Bashkimit European e kanë patur vite më përpara, që të futemi ne në BE duhet të jemi akoma dhe më të zhvilluar përveç si shtet në radhë të parë sepse do kemi shumë humbje meqënëse do futemi në BE, gjëja kryesore do kthehet leku në euro, shqipëria jo vetëm që ka miliarda borxhe po do bie në një krizë ekonomike akoma edhe më të thellë dhe ne nuk do ti përballojmë dot kushtet që BE do vërë* “ (Tiranë, Rural)

*“Jam kundër sepse nuk kemi kushtet e duhura për të qënë pjesë e BE. Kemi akoma shumë problem.”*  
(Tiranë, Urban)

*“Për sa kohë Shqipëria nuk është gati, nuk l ofron kriteret dhe kushtet, atëherë si mund të na pranojë Europa ne?”*  
(Tiranë, Rural)

*“Unë mendoj se të paktën ekonomikisht do të jemi më mirë nëse nuk integrohemi. Po të marrim shembullin e Turqisë, ajo nuk është e integruar dhe ka nivel më të lartë jetese dhe kosto më të ulët jete se disa prej vendeve që janë antarë te BE.”*  
(Tiranë, Urban)

### 8.3 SHBA, aktori ndërkombëtar me ndikimin më të madh në vendimet e marra nga Shqipëria sipas të rinjve

Shumica e pjesëmarrësve të rinj mendojnë se BE ka një influence të madhe në vendimet që merren në Shqipëri. Fakti që gjatë gjithë procesit të integrimit BE ka kërkuar plotësimin e një sërë kushtesh nga Shqipëria, shihet nga të rinjtë shqiptarë si provë për influencën që kanë institucionet Europiane në vendimmarjen e vendit. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve, i shohin Shtetet e Bashkuara të Amerikës si aktorin ndërkombëtar i cili ka influencën më të madhe në vendimet që merren në vend.

*“[Momentalisht mendoni se BE ka ndonjë influencë ne vendimet që merren në vend?]Po ka shumë, sepse përderisa të kërkon kushte ti duhet ti plotësosh ato.”* (Tiranë, Urban)

***“BE jo aq shumë por Amerika më tepër mendoj unë.” (Tiranë, Urban)***

***“Unë mendoj që po {BE ka ndikim në vendimet që merren në Shqipëri] sepse kishin tërë këto vite që e mbanin dmth q nuk kishim marre statusin e vendit kantidat nëse do të kishte qën në dorën e politikanëve shqiptar do të kishin bërë diçka tani jua kanë lën atyre te shohin seç do bejnë ata ?” (Tiranë, Urban)***

***“Unë do thoja jo Parlamenti Europian por ai ambasadori që është në shqipëri amerikan ka më shumë ndikim në vendimet që merren.” (Tiranë, Urban)***

***“Nga shtetet e BE ?Unë mendoj se Gjermania ka më shumë ndikim se ajo është dhe super fuqia e Europës ka një ndikim tek ne.” (Tiranë, Urban)***

***“Kam përshtypjen se çdo institucion i jashtëm ndikon shumë në Shqipëri, nuk e di pse kemi këtë ndikim kaq të madh nga faktori i jashtëm.” (Tiranë, Rural)***

***“Në vendimmarrje po them më shumë ndikon politika përbashkët e BE se sa e një shteti të caktuar.” (Tiranë, Rural)***

***“Po [ BE ka ndikim në vendimet e Shqipërisë]sepse ne jemi një vend i vogël dhe ndikohemi. Po jo gjithmonë është mirë të ndikohemi nga Bashkimi Europian. Edhe pse jemi vend i vogël duhet të jemi pak të pavarur.” (Tiranë, Rural)***

***“Më shumë ndikim tek Shqipëria ke miku i madh, SHBA. SHBA-ja është mirë të ketë ndikim duke pare që është një shtet shembull i demokracisë.” (Tiranë, Rural)***







**ANEX 1**

**METODOLOGJIA**



Komponenti sasior për këtë studim bazohet në një anketë kombëtare me 1200 të intervistuar, të cilët janë të rinj të moshës 16-27 vjeç. Kampinoni i intervistuar është përfaqësues për Shqipërinë dhe ofron mundësinë e analizës së nëngrupeve të interesit. Një përshkrim i detajuar i metodologjisë për pjesën sasimore të këtij studimi paraqitet si më poshtë:

## 1. Kampioni përfaqësues Kombëtar

Për të arritur në një kampion përfaqësues kombëtar, IDRA Research & Consulting përdor një metodë kampionimi të përbërë nga tre hapa:

- i). Hapi i parë - Përzgjedhja e pikave të kampionimit
- ii). Hapi i dytë - Përzgjedhja e familjeve/shtëpive
- iii). Hapi i tretë - Përzgjedhja e të intervistuarve

## 1.1 Hapi i parë- Përzgjedhja e pikave të kampionimit

IDRA zotëron listën e qendrave të votimit të bëra publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kjo listë përmban numrin e qendrës së votimit, numrin e votuesve të regjistruar në atë qendër, adresën e qendrës së votimit (qark, rreth, bashki ose komunë, adresë). Përzgjedhja bëhet nëpërmjet PPS<sup>1</sup> ku numri i zgjedhësve të regjistruar shërben si MOS<sup>2</sup>. Kjo përzgjedhje u jep mundësi zgjedhjeje të qendrave të votimit në përpjesëtim me numrin e votuesve të regjistruar në atë qendër votimi, thënë ndryshe qendrat e votimit të cilat kanë një numër më të madh votuesish të regjistruar kanë një mundësi më të madhe përzgjedhje. IDRA stratifikon kampionin sipas qarqeve edhe sipas ndarjes urbane dhe rurale<sup>3</sup>. Thënë ndryshe IDRA përzgjedh një numër të caktuar qendrash votimi urbane dhe rurale për çdo qark. Për këtë studim u përzgjodhën në mënyrë rastësore 120 qendra votimi të ndryshme dhe në secilën prej tyre u zhvilluan 10 intervista.

## 1.2 Hapi i dytë- Përzgjedhja e familjeve/shtëpive

Çdo intervistuesi iu caktua një pikë reference/pikë fillimi për çdo pikë të përzgjedhur të kampionit, që në përgjithësi ishte vetë qendra e votimit ose një ndërtesë e njohur, një kryqëzim rrugësh, shkollë, institucion public, etj. Mbase mbërrinte në pikën e references/pikën e fillimit, intervistuesi i kthente shpinën kësaj pike dhe fillonte të ecte duke mbajtur gjithmonë anën e tij të djathtë. Intervistuesi u udhëzua të numëronte banesat dhe të kryente intervistë në çdo banesë të tretë të numëruar.

1 - English Probability Proportional to Size.

2 - Anglisht Measure of Size.

3 - Ndarja urbane dhe rurale bëhet sipas ndarjes administrative bashki ose komunë. Ato qendra votimi të cilat ndodhen nën administrimin e një bashkie kategorizohen si urbane, ndërsa ato qendra votimi të cilat ndodhen nën administrimin e një komune kategorizohen si rurale. Disa zona të cilat ndodhen në periferi të Durrësit ose Tiranës, kanë të gjitha karakteristikat e zonave urbane në infrastrukturë dhe dendësi banorësh (psh: disa qendra votimi në komunën e Dajtit, komunën e Farkës ose zona e Kënetës në Durrës). Këto zona janë kategorizuar si urbane. Gjithashtu disa bashki, si psh Bashkia Divjakë, Bashkia Himarë, etj kanë nën administrimin e tyre fshatra të zonës. Qendrat e votimit të ndodhura në këto fshatra janë kategorizuar si rurale.

## 1.3 Hapi i tretë- Përzgjedhja e të intervistuarve

Përzgjedhja e të intervistuarit bëhet nëpërmjet metodës së ditëlindjes së fundit. Intervistuesi merr listën dhe ditëlindjet e banuesve të shtëpisë të cilët janë të moshës 16 vjeç e sipër. Kontaktohet për intervistë banuesi i shtëpisë i/e cila ka festuar ditëlindjen i/e fundit nga dita e intervistës. Nëse banori i shtëpisë<sup>4</sup> i cili ka festuar ditëlindjen i fundit nuk ndodhet, intervistuesi lë një takim dhe përpiqet ta kontaktojë personin e përzgjedhur edhe dy herë të tjera.

Nëse intervistuesi nuk arrin ta kontaktojë banuesin e përzgjedhur mbas përpjekjes së tretë, atëherë banesa kategorizohet si refuzim dhe kontaktohet për intervistë banesa tjetër e përzgjedhur sipas metodologjisë. Nëse banuesi i përzgjedhur refuzon të marrë pjesë në intervistë, atëherë banesa kategorizohet si refuzim dhe kontaktohet për intervistë banesa tjetër e përzgjedhur sipas metodologjisë.

### Për tu patur parasysh!

IDRA përdor numrin e votuesve të regjistruar në një qendër votimi për të kryer stratifikimin si dhe për të përzgjedhur qendrat e votimit. Numri i votuesve të regjistruar përbën një mjet shumë të mirë nëse kampioni është përfaqësues i popullsisë 18 vjeç e sipër. IDRA mendon që numri i votuesve të regjistruar përbën një mjet të mirë kampioni edhe për kampionin e këtij studimi (16-27 vjeç) duke marrë parasysh që një qendër votimi duke patur më shumë votues të regjistruar ka më shumë banesa të cilat ndodhen në zonën gjeografike të saj<sup>5</sup>, për rrjedhojë mundësia që në atë zonë të ndodhen më shumë individë të moshës 16-27 vjeç është më e lartë.

---

4 - Banues i shtëpisë do të quhen të gjithë individët të cilët kanë jetuar të paktën 6 muajt e fundit në banesë nga dita e intervistës. Emigrantët dhe studentët nuk konsiderohen si banues të shtëpisë.

5 - Të dy faktorët kanë korrelim të lartë



**ANEX 2**

PYETËSORI

## KOHA E LIRË DHE MËNYRA E JETESËS

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Pa përgjigje ]

### A1. Sa shpesh i kryeni secilën nga këto aktivitete?

		Shpesh	Ndonjëherë	Asnjëherë	Pa përgjigje
A1.1	Dëgjoni muzikë	1	2	3	9
A1.2	Dilni me miqtë	1	2	3	9
A1.3	Lexoni libra/revista	1	2	3	9
A1.4	Praktikoni sport	1	2	3	9
A1.5	Shihni televizor	1	2	3	9
A1.6	Shkoni ne Kinema	1	2	3	9

### A2. Mesatarisht, gjatë një dite të zakonshme sa orë shikoni televizor?

\_\_\_\_\_ (orë)

### A3. Sa shpesh i ndiqni këto programe televizive?

		Çdo ditë	Rreth 2-3 herë në javë	Rreth 1 herë në javë	Më pak se 1 herë në javë	Asnjëherë	Pa përgjigje
A3.1	Programe me muzikë popullore shqiptare	1	2	3	4	5	9
A3.2	Programe me muzikë të lehtë shqiptare	1	2	3	4	5	9
A3.3	Programe me muzikë të huaj	1	2	3	4	5	9
A3.4	Filma artistikë shqiptarë	1	2	3	4	5	9
A3.5	Filma të huaj me tema shoqërore	1	2	3	4	5	9
A3.6	Filma të huaj aksion	1	2	3	4	5	9

A3.7	Filma të huaj triler	1	2	3	4	5	9
A3.8	Dokumentarë historikë/shkencorë	1	2	3	4	5	9
A3.9	Telenovela	1	2	3	4	5	9
A3.10	Lajme	1	2	3	4	5	9
A3.11	Programe me debat politik	1	2	3	4	5	9
A3.12	Sport/Programe me komente sportive	1	2	3	4	5	9
A3.13	Programe fetare	1	2	3	4	5	9
A3.14	Programe humoristike	1	2	3	4	5	9
A3.15	Lojëra fati/Programe me kuize	1	2	3	4	5	9

#### A4. A keni qasje në internet?

(1) Po Vazhdo	(2) Jo Kalo tek Pyetja A7
---------------	---------------------------

#### A5. Mesatarisht, gjatë një dite të zakonshme sa orë kaloni në internet?

_____ (orë)
-------------

#### A6. Cilat janë arsyet kryesore se pse ju personalisht e përdorni internetin?

Për punë	A	Për të shkarkuar filma/libra	G
Për të lexuar lajme/informuar	B	Për të luajtur	H
Për të kërkuar informacione të ndryshme (për shkollën/punën/kuriozitete etj.)	C	Për të bërë blerje/pagesa/rezervime online	I
Për të komunikuar me miq/të afërm nëpërmjet chat-it	D	Për të aksesuar rrjete sociale si facebook etj.	J
Për të dërguar e-maile	E	Për të kontrolluar llogarinë bankare online	K
Për të parë video/dëgjuar muzikë	F	Tjetër (INT. Specifiko _____)	L

**A7. Sa para shpenzoni mesatarisht NË MUAJ për secilën nga këto aktivitete?**

	Shuma në Lekë	Nuk e di
<b>A7.1</b> Për të parë filma (kinema/blerje dvd-sh etj)	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.2</b> Për të frekuentuar kafenetë/baret/restorantet/pub-et	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.3</b> Për të blerë veshje/këpucë/aksesorë	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.4</b> Për karta telefoni mobil /fatura telefoni	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.5</b> Për të blerë libra	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.5</b> Per sherbime si parukeri/estetike/palester pishine	_____ lekë të reja	9999
<b>A7.7</b> Tjeter (INT. Specifiko _____)	_____ lekë të reja	9999

**A8. Për secilën nga alternativat që do t'ju përmend, a mund të më thoni nëse janë në modë apo jashtë mode PËR JU?**

[ INT. Vetëm çfarë është në modë apo jashtë mode për respondentin. Jo për shoqërinë, familjen,etj. ]

	Në modë	Jo aq ne mode	Jashtë mode	Nuk e di
<b>A8.1</b> Të mbarosh studimet universitare	1	2	3	9
<b>A8.2</b> Të bësh karrierë	1	2	3	9
<b>A8.3</b> Të angazhohesh në politikë	1	2	3	9
<b>A8.4</b> Te marrësh pjesë në aksione apo nisma qytetare	1	2	3	9
<b>A8.5</b> Të martohesh	1	2	3	9
<b>A8.6</b> Të dukesh bukur	1	2	3	9
<b>A8.7</b> Të vishesh me veshje te firmave te njohura	1	2	3	9
<b>A8.8</b> Të ushqehesh në mënyrë të shëndetshme	1	2	3	9
<b>A8.9</b> Të pish marihuanë	1	2	3	9

**A9. A pini cigare?**

(1) Po Rregullisht	(2) Me raste	(3) Jo Nuk jam duhanpirës	(4) Pa përgjigje
--------------------	--------------	---------------------------	------------------

**A10. A pini alkool?**

(1) Po, rregullisht (çdo ditë)	(2) Po, disa herë në javë
(3) Vetëm në fundjavë	(4) Rrallë
(5) Jo, asnjëherë	(9) Pa përgjigje

**A11. Mendoni se konsumi i alkoolit është:**

(1) I pranueshëm	(2) I nevojshëm për të mbajtur një rreth të caktuar shoqëror
(3) I papranueshëm	(9) Nuk e di/Pa përgjigje

**A12. Sa i kënaqur jeni me pamjen tuaj të jashtme?**

(1) Shume i/e kënaqur	(2) I/e kënaqur
(3) Disi i/e kënaqur	(4) I/e pakënaqur
(9) Nuk e di/Pa përgjigje	



### A13. Më lejoni t’ju pyes, cila nga këto pohime përcakton aktivitetin tuaj seksual?

[INT: Mos e lexo alternativën “Nuk e di/Pa përgjigje/Refuzoj”]

(1) Nuk kam kryer marrëdhënie seksuale	(2) Kam kryer marrëdhënie seksuale me një partner
(3) Kam kryer marrëdhënie seksuale me më shumë se një partner	(9) Nuk e di/ Pa përgjigje
(88) Refuzoj	

### A14. A përdorni masa mbrojtëse në jetën tuaj seksuale?

(1) Po, i përdor rregullisht	(2) Po, i përdor me raste
(3) Jo, nuk i përdor asnjëherë	(4) Nuk i njoh, nuk e di çfarë janë
(9) Pa përgjigje	(88) Refuzoj

### A15. Si e vlerësoni ju virgjërinë në kohët tona?

(1) Një vlerë/virtyt i rëndësishëm për të dyja gjinitë	(2) Një vlerë/virtyt i rëndësishëm për vajzat
(3) Një barrë psikologjike për të rinjtë	(4) Një koncept jashtë mode
(9) Nuk e di/Pa përgjigje	(88) Refuzoj

## ÇËSHTJE BESIMI DHE PËRKATËSIE

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (99) Nuk e Di ]

**B1. Ju lutem imagjinoni një nivel me 10 shkallë, ku në shkallën e parë (1) do të vendosnit njerëzit të cilëve u besoni më pak dhe në të fundit (pra në të 10-tën) do të vendosnit njerëzit të cilëve u besoni më shumë. Në cilën shkallë do t'i vendosnit njerëzit e mëposhtëm?**

	Nuk besoj-----Besoj plotësisht	Nuk e di
<b>B1.1</b> Familjaret tuaj	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.2</b> Të afërmit tuaj	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.3</b> Shokët tuaj	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.4</b> Fqinjët tuaj	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.5</b> Kolegët e punës	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.6.</b> Njerëz me fe të ndryshme nga juaja	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.7.</b> Njerëz me bindje të ndryshme politike nga ju	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99
<b>B1.8.</b> Udhëheqësit Fetar (Hoxha, Prifti)	1 2 3 4 5 6 7 8 9 10	99

**B2. Si do të ndiheshit nëse në ndërtesën/pranë shtëpisë tuaj do të vinte të banonte secila nga këto familje?**

	Shumë mirë	Mirë	Nuk më intereson	Keq	Shumë keq	Nuk e di
<b>B2.1</b> Një familje rome	1	2	3	4	5	9
<b>B2.2</b> Një çift homoseksualësh	1	2	3	4	5	9
<b>B2.3</b> Një çift studentësh	1	2	3	4	5	9
<b>B2.4</b> Një çift pensionistësh	1	2	3	4	5	9
<b>B2.5</b> Një familje nga veriu i vendit	1	2	3	4	5	9
<b>B2.6</b> Një familje nga jugu i vendit	1	2	3	4	5	9

<b>B2.7</b> Një familje nga Europa Perëndimore (Franca, etj.)	1	2	3	4	5	9
<b>B2.8</b> Një familje nga SHBA	1	2	3	4	5	9
<b>B2.9</b> Një familje nga Ballkani (Greqia, Serbia, Maqedonia, etj)	1	2	3	4	5	9
<b>B2.10</b> Një familje shumë besimtare/fetare	1	2	3	4	5	9

### B3. A jeni ndjerë ndonjëherë i diskriminuar për shkak të faktorëve që do t'ju përmend? Sa shpesh?

	Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di
<b>B3.1</b> Përkatësia juaj gjinore (mashkull/femër)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.2</b> Statusi juaj ekonomik (i /e varfër, i/e pasur)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.3</b> Përkatësia juaj fetare (mysliman, katolik, etj.)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.4</b> Përkatësia juaj etnike \ (rom, minoritar, etj.)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.5</b> Niveli juaj arsimor (shkollë 8-vjeçare, e mesme, etj.)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.6</b> Përkatësia juaj partiake (Demokrat, Socialist, etj)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.7</b> Prejardhja juaj krahinore (nga veriu, jugu etj.)	1	2	3	4	5	9
<b>B3.8</b> Prejardhja juaj fshatare/qytetare	1	2	3	4	5	9

### B4. Cilat janë tre vlerat që ju çmoni më shumë nga këto? Ju lutem mi rendisni këto tre vlera sipas rëndësisë.

	E Para <b>B4.1</b>	E Dyta <b>B4.2</b>	E Treta <b>B4.3</b>
<b>A.</b> Dinjteti vetjak ( identiteti/formimi)	1	1	1

B. Të jesh besnik/e (ndaj partnerit, miqve, punëdhënësit)	2	2	2
C. Të marrësh përgjegjësi	3	3	3
D. Të jesh i/e pavarur	4	4	4
E. Prestigji në shoqëri (statusi në shoqëri, rëndësia në shoqëri)	5	5	5
F. Altruizmi (te japësh, te ndihmosh te tjerët pa interes)	6	6	6
G. Pasurimi	7	7	7
H. Toleranca (te pranosh te tjerët që janë ndryshe nga ti)	8	8	8
I. Shpirti konkurrues (lufton për te përmbushur qëllimet)	9	9	9
J. Korrektësia	10	10	10
K. Shpirti novator (krijon dhe pranon ide ndryshe nga te tjerët)	11	11	11
Z. Nuk di/Pa përgjigje	99		

**B5. A jeni angazhuar në aktivitete vullnetare/ punë për të cilat nuk ka qenë e nevojshme të paguheni gjatë 12 muajve të fundit?**

(1) Po	(2) Jo [INT. Kalo tek B8]
(9) Nuk e di/Pa përgjigje [INT. Kalo tek B8]	

**B6. Në cilat lloje të veprimtarive vullnetare nga veprimtaritë e**

## poshtëshënuara jeni angazhuar gjatë 12 muajve të fundit?

[INT. Mund të zgjidhet me shumë se një përgjigje. Rretho te gjitha ato që përmenden!]

<b>A</b>	Ndërtim ose riparim objektesh publike si ujësjellës, rrugë, ura etj
<b>B</b>	Pastrim i mjediseve publike
<b>C</b>	Krijim ose riparim i sipërfaqeve të gjelbra
<b>D</b>	Mbrojtje e komunitetit tuaj nga veprimet e kriminelëve
<b>E</b>	Pjesëmarrje në zbutjen e konflikteve ndërmjet komunitetit tuaj dhe të tjerëve
<b>F</b>	Pjesëmarrje në zbutjen e konflikteve midis anëtarëve të komunitetit tuaj
<b>G</b>	Ndihmë apo kurse në fushën e arteve (letërsi, pikturë, muzikë, teatër, etj)
<b>H</b>	Ndihmë apo kurse në fushën e gjuhëve të huaja
<b>I</b>	Ndihmë apo kurse në fushën e shkencave ekzakte (matematike, fizikë, kimi, etj.)
<b>J</b>	Ndihmë apo kurse në fushën e informatikës
<b>K</b>	Ndihmë shëndetësore / mjekësore për njerëzit në nevojë
<b>L</b>	Tjetër ( INT. Specifiko _____ )

## B7. Cila është arsyeja kryesore që ju nxit të angazhoheni në veprimtari vullnetare? [INT. TREGO KARTËN!] INT:Vetëm një përgjigje!

(1)	Dëshira për t'u ndjerë aktiv/i angazhuar në shoqëri
(2)	Ndjenja e përkushtimit ndaj të tjerëve
(3)	Tradita e familjes
(4)	Bindjet fetare
(5)	Dëshira për të bërë miq të rinj
(6)	Dëshira për të zbatuar në praktikë njohuritë profesionale
(7)	Dëshira për t'u njohur me punëdhënës privat, të cilët më pas mund t'ju punësojnë
(8)	Dëshira për t'u njohur me punëdhënës publik, të cilët më pas mund t'ju punësojnë
(9)	Dëshira për t'u njohur me drejtues të institucioneve ndërkombëtare, të cilët më pas mund t'ju punësojnë
(10)	Arsye tjetër [INT. Specifiko _____ ]
(99)	Nuk e di/Pa përgjigje

**B8. Ju personalisht, cilës fe i përkisni?**

(1)	Myslimane
(2)	Ortodokse
(3)	Katolike
(4)	Bektashie
(5)	Protestante
(6)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(7)	Jam ateist [INT. Kalo tek B9]
(8)	Nuk praktikoj asnjë fe [INT. Kalo tek B9]
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje [INT. Kalo tek B9]

**B8.1 Sa shpesh e praktikoni fenë tuaj?**

(1)	Përditë
(2)	1-2 herë në javë
(3)	Vetëm në rastet e festave fetare (Bajram, Krishtlindnje, Pashke, Festa e Novruzit etj.)
(4)	Asnjëherë
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

**B9. A ju ka ndodhur të frekuentoni vende të shenjta të një feje të ndryshme nga e juaja?**

(1) Po	(2) Jo
(9) Nuk e di/Pa përgjigje	

## FAMILJA DHE RRETHI SHOQËROR

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Nuk e Di ]

### C1. Aktualisht, me cilin jetoni? Jetoni vetëm, me prindërit, me partnerin/partneren apo me miq/të afërm?

(1)	Jetoj vetëm [INT. Kalo tek C3]
(2)	Jetoj me prindërit e mi
(3)	Jetoj me partnerin/partneren [INT. Kalo tek C3]
(4)	Jetoj me miq/të afërm [INT. Kalo tek C3]
(5)	Tjetër (INT. Specifiko _____) [INT. Kalo tek C3]
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje [INT. Kalo tek C3]

### C2. Cili nga këto pohime ju pershtatet më mirë?

(1)	Jetoj me prindërit pasi për ne, si familje, është zgjidhja me komode
(2)	Nëse do të kisha mundësi financiare, do të doja të jetoja vetëm
(3)	Do të doja të jetoja vetëm, por prindërit e mi nuk pajtohen me këtë
(4)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

### C3. Cili nga këto pohime, përshkruan më mirë marrëdhënien që keni me prindërit tuaj?

(1)	Kuptohemi shume mire me njeri-tjetrin
(2)	Kuptohemi, edhe pse ndodh të përballemi me këndvështrime të ndryshme
(3)	Në përgjithësi nuk kuptohemi, hasim shpesh në mosmarrëveshje
(4)	Marrëdhënia jonë është konfliktuale
(5)	Prindërit e mi nuk jetojnë
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### C4. Cili nga këto pohime, përshkruan më mirë marrëdhënien që keni me vëllezërit/motrat tuaja?

(1)	Kuptohemi shume mire me njeri-tjetrin
(2)	Kuptohemi, edhe pse ndodh të përballemi me këndvështrime të ndryshme
(3)	Në përgjithësi nuk kuptohemi, hasim shpesh në mosmarrëveshje
(4)	Marrëdhënia jonë është konfliktuale
(5)	Nuk kam motra/vëllezër
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### C5. Cili prej anëtarëve të familjes suaj, ka më shumë ndikim në vendime që merrni për çështje të rëndësishme?

(1)	Babai
(2)	Nëna
(3)	Vëllai
(4)	Motra
(5)	Gjyshi
(6)	Gjyshja
(7)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### C6. Si i merrni vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën tuaj?

(1)	Prindërit e mi vendosin për gjithçka
(2)	Prindërit dhe unë vendosim së bashku
(3)	Unë gëzoj liri të plotë dhe vendos vetë
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje



## C7. Si e përfytyroni veten tuaj në të ardhmen?

(1)	Duke u martuar dhe krijuar familje
(2)	Duke bashkëjetuar me një partner/e [INT. Kalo tek C9]
(3)	Pa partner/e dhe pa detyrime familjare [INT. Kalo tek C9]
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje [INT. Kalo tek C9]

## C8. Cila mendoni se është përparësia KRYESORE e martesës në krahasim me bashkëjetesën?

(1)	Martesa rrit përgjegjësinë e bashkëshortëve për njëri-tjetrin
(2)	Martesa rrit përgjegjësinë e bashkëshortëve për fëmijët
(3)	Martesa ofron më shumë siguri ekonomike për bashkëshortët
(4)	Martesa është më e pranueshme se bashkëjetesa në opinionin e shoqërisë Shqiptare
(5)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

## C9. Cila mendoni se është përparësia KRYESORE e bashkëjetesës në krahasim me martesën?

(1)	Partnerët janë më të pavarur nga njëri-tjetri
(2)	Partnerët kanë më shumë mundësi të përqendrohen te karriera
(3)	Partnerët kanë më pak mundësi të konfliktohen me njëri-tjetrin
(4)	Partnerët e kanë më të lehtë të zgjidhin mosmarrëveshjet
(5)	Partnerët e kanë më të lehtë të ndahen nga njëri-tjetri
(6)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

**C10. Sipas mendimit tuaj, cila është moshë më e përshtatshme për martesën e vajzave në përgjithësi?**

\_\_\_\_\_ (vjeç)

**C11. Sipas mendimit tuaj, cila është moshë më e përshtatshme për martesën e djemve në përgjithësi?**

\_\_\_\_\_ (vjeç)

**C12. Sa fëmijë do të donit të kishit? Sa prej tyre do të donit të ishin vajza dhe sa djem?**

C12.1 Numri i fëmijëve	C12.2 Numri i vajzave	C12.3 Numri i djemve
_____ (fëmijë)	_____ (vajza)	_____ (djem)

**C13. Nëse jeni, do të ishit beqar/e, sa të rëndësishëm i konsideroni secilin nga faktorët e mëposhtëm në momentin që do të vendosni për bashkëshortin/bashkëshorten tuaj?**

	Shumë i rëndësishëm	I rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I parëndësishëm	Tërësisht i parëndësishëm	Pa përgjigje
C13.1 Përkatësia fetarë	1	2	3	4	5	9
C13.2 Gjendja ekonomike	1	2	3	4	5	9
C13.3 Miratimi i familjes time	1	2	3	4	5	9
C13.4 Virgjëria	1	2	3	4	5	9
C13.5 Personaliteti	1	2	3	4	5	9
C13.6 Pamja e jashtme	1	2	3	4	5	9

C13.7 Niveli i arsimit	1	2	3	4	5	9
C13.8 Interesa të përbashkëta	1	2	3	4	5	9
C13.9 Prejardhja krahinore	1	2	3	4	5	9

**C14. Duke ndryshuar pak temën, a jeni pjesë e një grupi të caktuar miqsh ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin dhe dilni shpesh bashkë?**

(1)	Po
(2)	Jo [INT. Kalo tek pyetja 16]
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

**C15. Në përgjithësi sa i/e kënaqur jeni me rrethin tuaj shoqëror/ shoqërinë tuaj**

(1)	Shumë i/e kënaqur
(2)	I/e kënaqur
(3)	Deri diku i/e kënaqur
(4)	I/e pakënaqur
(9)	Tërësisht i/e pakënaqur

**C16. Gjatë vitit të kaluar a ju ka ndodhur të përfshiheni në konflikte të dhunshme sipas situatave të mëposhtme?**

	Po	Jo	Pa përgjigje
C16.1 Me të rinj të tjerë në lagje	1	2	9
C16.2 Me të rinj të tjerë në një pub, disko apo klub	1	2	9
C16.3 Në palestër, fushë futbollit, etj.	1	2	9
C16.4 Në shkollë	1	2	9
C16.5 Të rinj me përkatësi politike të ndryshme nga e juaja	1	2	9
C16.6 Me policinë (p.sh. në demonstrata, protesta, etj.)	1	2	9

## SHQETËSIME DHE ASPIRATA

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Nuk e Di ]

**D1. A keni dëshirë të zhvendoseni nga vendbanimi juaj ekzistues në një qytet/fshat tjetër të Shqipërisë?**

(1)	Po
(2)	Jo [INT. Kalo tek D3]
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje [INT. Kalo tek D3]

**D2. Cila është arsyeja KRYESORE që do ju bënte të ndryshonit vendbanim?**

(1)	Dëshira për të përmirësuar standardin ekonomik të jetesës
(2)	Dëshira për të pasur më shume variacion kulturor
(3)	Dëshira për të pasur shkollim më cilësor
(4)	Mundësi më të gjera për t'u punësuar
(5)	Mundësi më të mëdha për të hapur biznesin tuaj
(6)	Dëshira për të qenë më afër njerëzve të afërt
(7)	Dëshira për t'ju larguar konflikteve në fshatin ose qytetin ku banoni
(8)	Tjetër ( INT. Specifiko _____ )
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

**D3. Sa dëshirë keni të emigroni jashtë Shqipërisë?**

(1)	Shumë
(2)	Disi
(3)	Pak
(4)	Aspak
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### D4. Cili vend do t'ju tërhiqte më shumë për të emigruar?

(1)	Greqi
(2)	Itali
(3)	Gjermani
(4)	Angli
(5)	Shtetet e tjera te Bashkimit Evropian
(6)	Shtetet e Bashkuara te Amerikës
(7)	Kanada
(8)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Asnjë vënd nuk më tërheq
(99)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### D5. Cila është arsyeja KRYESORE që do ju bënte të emigronit jashtë Shqipërisë? [INT. Një përgjigje]

(1)	Dëshira për të përmirësuar standardin ekonomik të jetesës
(2)	Dëshira për të pasur më shume variacion kulturor
(3)	Dëshira për të pasur shkollim më cilësor
(4)	Mundësi më të gjera për t'u punësuar
(5)	Mundësi më të mëdha për të hapur biznesin tuaj
(6)	Dëshira për të qenë më pranë njerëzve të afërt
(7)	Dëshira për t'ju shmangur konflikteve dhe streseve në Shqipëri
(8)	Tjetër (INT. Specifiko _____)
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

#### D6. Si e shikoni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?

(1)	Më mire se tani
(2)	Njëlloj si tani
(3)	Më keq se tani
(9)	Nuk e di/Pa përgjigje

## D7. Sa dakord jeni me secilën nga këto thënie? Do të thoshit se jeni shumë dakord, dakord, deri diku dakord, jo dakord apo aspak dakord ?

	Shumë Dakord	Dakord	Deri diku Dakord	Jo -dakord	Aspak dakord	Pa përgjigje
<b>D7.1</b> Duhet të dish çfarë do të arrish në jetë.	1	2	3	4	5	9
<b>D7.2</b> Kush rrezikon, NUK fiton asgjë.	1	2	3	4	5	9
<b>B7.3</b> Nëse kujdesesh për të tjerët, në fund do të shpërblehesh	1	2	3	4	5	9
<b>D7.4</b> Nuk ka kuptim të vendosësh qëllime në jetë, pasi asgjë nuk është e sigurt sot.	1	2	3	4	5	9
<b>D7.5</b> Shoqëria duhet të ketë norma morale, përndryshe nuk funksionon	1	2	3	4	5	9
<b>D7.6</b> Nuk mund ta ndash hidhërimin me të tjerët në ditët e sotme	1	2	3	4	5	9
<b>D7.7</b> Duhet të besosh në fat, dhe të marrësh nga jeta çfarë të jepet	1	2	3	4	5	9
<b>D7.8</b> Në jetë duhet të jesh i rrethuar nga njerëz tek të cilët mund të mbështetesh	1	2	3	4	5	9
<b>D7.9</b> Në jetë është e mjaftueshme të kesh disa miq dhe të bësh çfarë ke qejf	1	2	3	4	5	9
<b>D7.10</b> Njeriu duhet të përqendrohet te karriera, te gjitha të tjerat janë dytësore.	1	2	3	4	5	9
<b>D7.11</b> Njeriu duhet të izolohet në vetvete dhe të jetojë në botën e tij sepse jeta është shumë e vështirë	1	2	3	4	5	9
<b>D7.12</b> Të interesohesh për atë çfarë po ndodh në shoqëri është pjesë e rëndësishme e jetës	1	2	3	4	5	9
<b>D7.13</b> Gjëja më e arsyeshme në jetë është të orientohesh nga të tjerët, pra të ecësh me rrymën.	1	2	3	4	5	9

## CËSHTJE ARSIMIMI DHE PUNËSIMI

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Nuk e Di ]

<p><b>E1. Aktualisht a vazhdoni shkollën?</b></p>	<p>(1) Po vazhdoj shkollën e mesme                  (2) Po vazhdoj Universitetin                  (3) Po vazhdoj Master/Doktoraturë                  (4) Jo [INT. Kalo tek E14]                  (9) Refuzon [INT. Kalo tek E14]</p>
<p><b>E2. A keni vazhduar/keni ndërmend të vazhdoni shkollën e lartë?</b></p>	<p>1. Po                  2. Jo [Kalo tek E2B]</p>
<p><b>E2A1. Arsytet të cilat ju shtynjë ose ju kane shtyre të vazhdoni shkollën e lartë?</b></p>	<p>A. Për të zgjeruar horizontin, kapacitetet intelektuale                  B. Për të marre një diplomë e cila do me lejonte me shume mundësi për të gjetur pune                  C. Për të përmbushur vullnetin e prindërve                  D. Për të fituar me shume para, për t'u pasuruar                  E. Për të siguruar një status me të larte shoqëror                  F. Për të krijuar njohje dhe eksperiencia të reja                  G. Nuk kam/kisha c'te bej/a me mire                  H. Tjetër _____</p>
<p><b>E2A2. Cila nga alternativat e mëposhtme në lidhje me zgjedhjen tuaj për shkollën e lartë ju përshtatet më shumë?</b></p>	<p>(1) Kam studiuar/studioj/do të studioj në drejtimin që kam dashur/dua                  (2) Zgjodha/do të zgjedh profilin që mendoj se më siguron të ardhura të sigurta, megjithëse nuk përputhet me dëshirën time                  (3) Zgjodha/Do të zgjedh nje profil ku mendoj se kam shanse të fitoj shkollën, megjithëse nuk përputhet me dëshirën time                  (9) Nuk e di / Pa përgjigje</p>

<p><b>E2B. Arsyet e mos vazhdimit të shkollës së lartë?</b> [INT. Pyet nëse E2= 2. Jo]</p>	<p>A. Nuk me pëlqen te studioj B. Nuk mendoj qe do me siguronte nje te ardhme me te mire C. Prindërit e mi nuk me mbështeten/ nuk dëshironin te vazhdoja D. As miqtë e mi nuk vazhdojnë/vazhduan shkollën E. Mundësi financiare te kufizuara F. Tjetër ( _____ )</p>
<p><b>E3. A keni vazhduar/ndërmend të vazhdoni shkollën profesionale/ kurset e formimit profesional?</b></p>	<p>1. Po 2. Jo [Kalo tek E4]</p>
<p><b>E3A. Arsyet e vazhdimit të arsimit profesional?</b> [INT. Pyet nëse E3=1. Po]</p>	<p>(1) Për të marrë një profesion i cili do më lejojte më shumë mundësi për të punuar/ tu punësuar (2) Për të përmbushur vullnetin e prindërve (3) Per të fituar më shumë para, për tu pasuruar (4) Për të ndjekur një pasion personal që kam për një fushë të caktuar (5) Për të krijuar njohje dhe eksperiencia të reja (6) Nuk kam / kisha ctë bëja më mirë (9) Tjetër ( _____ )</p>
<p><b>E4. Në përgjithësi sa i/e kënaqur jeni me cilësinë e arsimit në Shqipëri?</b></p>	<p>(1) Shumë i/e kënaqur (2) I/e kënaqur (3) Deri diku i/e kënaqur (4) I/e pakënaqur (5) Tërësisht i/e pakënaqur (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>
<p><b>E5. Nëse do t'ju jepej mundësia të zgjidhnit, ku do te preferonit të arsimoheshit?</b></p>	<p>(1) Në një shkollë publike në Shqipëri (2) Në një shkollë private në Shqipëri (3) Në një shkollë publike jashtë vendit (4) Në një shkollë private jashtë vendit (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>
<p><b>E6. Nëse do t'ju jepej mundësia të zgjidhnit, cilën shkollë do të preferonit?</b></p>	<p>(1) Shkollë profesionale (shkollë që ju siguron një zamat të caktuar si mekanik, elektrikist, hidraulik, etj.) (2) Universitet (9) Nuk e di/ Pa përgjigje</p>



<p><b>E7. Cila ka qenë mesatarja e rezultateve tuaja në shkollë vitin e kaluar?</b></p>	<p>(1) Shumica 4-5 (2) Shumica 5-6 (3) Shumica 7-8 (4) Shumica 9-10 (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>
<p><b>E8. A e mendoni se ekziston fenomeni i blerjes së notave dhe provimeve në shkollë?</b></p>	<p>(1) Po blihen shpesh (2) Po blihen me raste (3) Po, por blihen ralle (4) Jo asnjëherë (9) Nuk e di/ Pa përgjigje</p>
<p><b>E9. Mesatarisht sa orë në ditë shpenzoni duke studiuar?</b></p>	<p>(1) Deri në 1 orë në ditë (2) Mesatarisht 1-2 orë në ditë (3) Mesatarisht 2-3 orë në ditë (4) Mesatarisht 3-4 orë në ditë (5) Më shumë se 4 orë në ditë (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>
<p><b>E10. Çfarë kursesh keni ndjekur gjatë vitit të fundit shkollor? [INT. Lejohet të zgjidhet më shumë se një alternativë!]</b></p>	<p>A. Kurs gjuhe të huaj B. Kurs lëndësh shkencore C. Kurs lëndësh shoqërore D. Kurs arti E. Tjetër kurs formimi (specifiko _____) F. Nuk kam ndjekur asnjë kurs privat gjatë vitit të fundit <b>[Kalo tek E9]</b></p>
<p><b>E11. Cila është arsyeja KRYESORE që ju shtyn të merrni mësimë në kurse private?</b></p>	<p>(1) Nuk mund të kuptoni lëndën pa shpjegim plotësuese (2) Mësuesit nuk ju kalojnë nëse nuk shkoni në kurse privatisht (3) Mësuesit ju ulin notën nëse nuk shkoni në kurse privatisht (4) Është bërë në modë, në kurse private shkojnë të gjithë (5) Dëshironi të përparoni përtej njohurive që ju jep programi i shkollës në lëndët në të cilat ndiqni kurse (6) Dëshironi të kultivoni talentin në një fushë të caktuar (7) Tjetër (<b>INT. Specifiko</b> _____) (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>

<p><b>E12. A keni kryer ndonjë praktikë/stazh/internship?</b></p>	<p>(1) Po (2) Jo (9) Nuk e di/ Pa përgjigje</p>																		
<p><b>E13. A mendon se pas përfundimit të studimeve universitare do të gjesh shpejt pune?</b> [INT.Per ata që kane përfunduar studimet dhe janë të punësuar pyet: Pas përfundimit të studimeve universitare sa shpejt gjendet nje pune?]</p>	<p>(1) Po besoj se do gjej pune menjëherë (2) Po besoj se do gjej pune pas nje fare kohe (3) Jo nuk besoj se do të gjej pune shpejt (9) Nuk e di/ Shpresoj</p>																		
<p><b>E15. Mesatarisht sa orë punoni në javë?</b></p>	<p>_____ (orë)</p>																		
<p><b>E16. A punoni në profesionin që keni marrë ose po merrni?</b></p>	<p>(1) Nuk kam marrë ndonjë profesion (2) Po, punoj në profesionin që kam marrë/po marrë (3) Deri-diku punoj në profesionin që kam marrë (4) Jo, nuk punoj në profesionin që kam marrë/po marrë (9) Nuk e di/ Pa përgjigje</p>																		
<p><b>E17. Në cilin prej sektorëve të mëposhtëm do të donit të punësoheshit?</b></p>	<p>(1) Në administratën publike (2) Në sektorin privat (3) Në organizata jo-qeveritare (OJQ) (4) Në institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, OSBE, etj.) (5) Tjetër (INT. Specifiko _____) (9) Nuk e di/ Pa përgjigje</p>																		
<p><b>E18. Çfarë profesioni do të donit të kishit?</b></p>	<p>Specifiko: _____</p>																		
<p><b>E19. Unë do të përmend 5 elemente të cilët njerëzit i konsiderojnë si të rëndësishëm për të gjetur pune sot në Shqipëri:</b> Ju lutem a mund ti rendisni keto 5 elemente sipas rëndësisë që ata kane për të gjetur pune për ju duke vendosur të parin atë element që ju e konsideroni si më të rëndësishmin dhe kështu me rradhe të gjithë elementet e tjere? [INT. Vendos 1 pranë faktorit më të rëndësishëm, 2 pranë faktorit të dytë të përmendur e kështu me rradhe]</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Elementi</th> <th>Renditja 1-5</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>E19A</td> <td>Njohjet/Miqtë</td> <td></td> </tr> <tr> <td>E19B</td> <td>Aftësia profesionale</td> <td></td> </tr> <tr> <td>E19C</td> <td>Niveli i arsimit</td> <td></td> </tr> <tr> <td>E19D</td> <td>Lidhjet politike</td> <td></td> </tr> <tr> <td>E19E</td> <td>Fati</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Elementi	Renditja 1-5	E19A	Njohjet/Miqtë		E19B	Aftësia profesionale		E19C	Niveli i arsimit		E19D	Lidhjet politike		E19E	Fati	
	Elementi	Renditja 1-5																	
E19A	Njohjet/Miqtë																		
E19B	Aftësia profesionale																		
E19C	Niveli i arsimit																		
E19D	Lidhjet politike																		
E19E	Fati																		

<p><b>E20. Tani do t'ju përmend disa profesione të caktuara si dhe disa faktorë të cilët njerëzit i konsiderojnë të rëndësishëm kur vendosin për të pranuar një punë të caktuar.</b>                  Ju lutem a mund ti rendisni keto 4 faktorë sipas rëndësisë që ata kanë, duke vendosur të parin atë faktor që ju e konsideroni si më të rëndësishmin dhe kështu me rradhe të gjithë faktorët e tjere?                  [INT. Vendosi 1 prane faktorit me te redesishem, 2 prane faktorit te dyte te permendur e kështu me rradhe]</p>			<p><b>E20_1</b> Mësues</p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>
			<p><b>E20_1A</b> Të ardhurat/Rroga</p>	
			<p><b>E20_1B</b> Siguria e vendit të punës</p>	
			<p><b>E20_1C</b> Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>	
			<p><b>E20_1D</b> Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>	
<p><b>E20_2</b></p>	<p><b>Ekspert IT / Kompjuterash</b></p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>	<p><b>E20_3</b> Mjek</p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>
<p><b>E20_2A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>		<p><b>E20_3A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>
<p><b>E20_2B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>		<p><b>E20_3B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>
<p><b>E20_2C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>		<p><b>E20_3C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>
<p><b>E20_2D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>		<p><b>E20_3D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>
<p><b>E20_4</b></p>	<p><b>Mekanik/Elektricitist/ Hidraulik</b></p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>	<p><b>E20_5</b> Menaxher Biznesi</p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>
<p><b>E20_4A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>		<p><b>E20_5A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>
<p><b>E20_4B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>		<p><b>E20_5B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>
<p><b>E20_4C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>		<p><b>E20_5C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>
<p><b>E20_4D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>		<p><b>E20_5D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>
<p><b>E20_6</b></p>	<p><b>Arkitekt / Inxhinjer</b></p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>	<p><b>E20_7</b> Nënpunës Administrate</p>	<p><b>Renditja</b> 1-4</p>
<p><b>E20_6A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>		<p><b>E20_7A</b></p>	<p>Të ardhurat/Rroga</p>
<p><b>E20_6B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>		<p><b>E20_7B</b></p>	<p>Siguria e vendit të punës</p>
<p><b>E20_6C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>		<p><b>E20_7C</b></p>	<p>Vështirësia e vendit të punës/lodhja</p>
<p><b>E20_6D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>		<p><b>E20_7D</b></p>	<p>Statusi social i profesionit/ Respekti shoqëror që gezon profesionin</p>

## DEMOKRACI DHE POLITIKË

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Nuk e Di ]

<p><b>F1.</b> Sa të informuar/interesuar janë prindërit tuaj në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me politikën?</p>	<p>(1) Shumë të interesuar (2) Të interesuar (3) Deri diku të interesuar (4) Të paiteresuar (5) Tërësisht të paiteresuar (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>					
<p><b>F2.</b> Po JU personalisht, në çfare mase jeni të informuar/in-teresuar për zhvillimet politike sipas të gjitha shkallëve që do t'ju përmend?</p>	<p><b>Shumë i/e interesuar</b></p>	<p><b>I/e in-teresuar</b></p>	<p><b>Deri diku i/e in-teresuar</b></p>	<p><b>I/e pain-teresuar</b></p>	<p><b>Tërësisht i/e pain-teresuar</b></p>	<p><b>Pa përgjigje</b></p>
<p><b>F2.1.</b> Në shkallë botërore</p>	1	2	3	4	5	9
<p><b>F2.2.</b> Në Ballkan</p>	1	2	3	4	5	9
<p><b>F2.3.</b> Në Shqipëri</p>	1	2	3	4	5	9
<p><b>F3.</b> Sa janë të ngjashme pikëpamjet e bindjet tuaja politike me ato të prindërve tuaj?</p>	<p>(1) Shumë (2) Disi (3) Pak (4) Aspak (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>					
<p><b>F4.</b> Nëse ju kujtohet, sa herë keni votuar që kur keni fituar të drejtën për të votuar? <b>[Intervistues. Nëse do të ishte e nevojshme kujtojini respondentit se zgjedhjet e viteve të fundit janë bërë në 2005, 2007, 2009, 2011, 2013]</b></p>	<p>(1) Në çdo votim të mundshëm (2) Në shumicën e votimeve (3) Në pak votime (4) Asnjëherë (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>					
<p><b>F5.</b> Sipas mendimit tuaj, sa ndikon vota Juaj në mënyrën e drejtimit të institucioneve?</p>	<p><b>Pushteti / Shkalla</b></p>	<p><b>Shume</b></p>	<p><b>Disi</b></p>	<p><b>Pak</b></p>	<p><b>Aspak</b></p>	<p><b>Pa përgjigje</b></p>
<p><b>F5.1.</b> Te pushteti qendror (për Kuvendin e Republikës dhe Qeverinë)</p>	1	2	3	4		9
<p><b>F5.2.</b> Te pushtetit vendor (bashki, komunë)</p>	1	2	3	4		9

<p><b>F6.</b> A do të donit që partitë ta zgjidhnin deputetin me listë të mbyllur siç është aktualisht apo ta votonit ju në një listë të hapur?</p>	<p>(1) Me listë të mbyllur (siç është aktualisht)                  (2) Me listë të hapur (ta votoja vetë)                  (9) Nuk e di/Pa përgjigje</p>	
<p><b>F7.</b> Cilat janë burimet kryesore të informimit tuaj në lidhje me zhvillimet politike?   <b>[INT. Lejohet me shume se nje pergjigje]</b></p>	<p>A. Interneti                  B. Televizionet                  C. Gazetat e përditshme                  D. Radiot                  E. Bisedat në familje                  F. Bisedat me shokët dhe miqtë                  G. Tjetër (<b>INT. Specifiko</b> _____ )</p>	
<p><b>F8.</b> Në përgjithësi bindjet tuaja politike janë:   <b>Ju lutem përdorni shkallën e vlerësimit 1-10, ku 1 do të thotë "E Majtë Ekstreme" dhe 10 do të thotë "E Djathtë Ekstreme"</b></p>	<p><b>E Majtë Ekstreme</b>-----<b>E Djathtë Ekstreme</b></p> <p>1      2      3      4      5      6      7      8      9      10</p> <p>99. Nuk e di/ Nuk kam bindje politike</p>	
<p><b>F9A.</b> A mendoni se blihet vota në Shqipëri?</p>	<p>(1) Po                  (2) Jo                  (9) Nuk e di/Pa përgjigje                  (88) Refuzoj</p>	
<p><b>F9B.</b> Gjatë votimeve ku keni marrë pjesë, a ju janë ofruar ndonjëherë juve ose prindërve tuaj para të blerë votën tuaj?</p>	<p>(1) Po                  (2) Jo                  (9) Nuk e di/Pa përgjigje                  (88) Refuzoj</p>	
<p><b>F10.</b> Sa të përfaqësuar ndiheni prej të rinjve në politike ?</p>	<p>(1) Shume                  (2) Disi                  (3) Pak                  (4) Aspak                  (9) Nuk e di/pa përgjigje</p>	
<p><b>F11.</b> A mendoni se respektimi i kuotës gjinore në institucionet politike (përfshirja e më shumë grave në politikë) e rrit cilësinë e politikës?</p>	<p>(1) Shume                  (2) Disi                  (3) Pak                  (4) Aspak                  (9) Nuk e di/pa përgjigje</p>	
<p><b>F12.</b> Çfarë mendoni në lidhje me profesionin të politikanit?</p>	<p><b>F12A.</b> Në lidhje me vështirësinë:                  (1) I Vështirë                  (2) I Lehtë                  (9) Nuk e di/pa përgjigje</p>	<p><b>F12b.</b> Në lidhje me përfitimet:                  (1) Fitimprurës                  (2) Jo Fitimprurës                  (9) Nuk e di/pa përgjigje</p>
<p><b>F13.</b> Në përgjithësi në çfarë mase i besoni institucionet e renditura më poshtë? I besoni shumë, disi, pak apo aspak?</p>		

	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Nuk di
<b>F13.1</b> Partitë politike	1	2	3	4	9
<b>F13.2</b> Komisionin Qendror të Zgjedhjeve	1	2	3	4	9
<b>F13.3</b> Kuvendin e Shqipërisë	1	2	3	4	9
<b>F13.4</b> Qeverinë Qendrore	1	2	3	4	9
<b>F13.5</b> Pushtetin vendor/kryetarin e bashkisë/këshillin bashkiak	1	2	3	4	9
<b>F13.6</b> Prokurorinë e përgjithshme	1	2	3	4	9
<b>F13.7</b> Policinë	1	2	3	4	9
<b>F13.8</b> Kontrollin e lartë të shtetit	1	2	3	4	9
<b>F13.9</b> Drejtuesit fetar	1	2	3	4	9
<b>F13.10</b> Gjykatat	1	2	3	4	9
<b>F13.11</b> Mediat	1	2	3	4	9
<b>F13.12</b> Sindikatat	1	2	3	4	9
<b>F13.13</b> Organizatat jo-fitimprurëse, jo qeveritare	1	2	3	4	9
<b>F14.</b> Përgjithësisht sa i kënaqur ose pakënaqur jeni me nivelin e zhvillimit të demokracisë në Republikën e Shqipërisë?	(1) Shume i kenaqur (2) I kenaqur (3) Deri diku i kenaqur (4) I pakenaqur (5) Shume i pakenaqur (9) Nuk e di/Pa përgjigje				

## QEVERISJE DHE ZHVILLIM

[ INTERVISTUES: Në asnjë nga pyetjet mos e lexoni alternativën (9) Nuk e Di ]

### G1. Sipas mendimit tuaj, sa shqetësuese janë për shoqërinë Shqiptare problemet e poshtëshënuara?

	Shkalla e shqetësimit që provokojnë problemet	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Nuk e di/ Pa përgjigje
1	Rritja e shkallës së varfërisë	1	2	3	4	9
2	Papunësia	1	2	3	4	9
3	Ndotja e mjedisit	1	2	3	4	9
4	Kërcënimi nga sulmet terroriste	1	2	3	4	9
5	Kërcënimi nga përhapja e infeksionit hiv/aids	1	2	3	4	9
6	Kërcënimi nga përhapja e sëmundjeve kanceroze	1	2	3	4	9
7	Moszbatimi me korrektësi i legjislacionit	1	2	3	4	9
8	Pasiguria për vendin e punës	1	2	3	4	9
9	Rrezikimi i jetës dhe shëndetit në vendin e punës	1	2	3	4	9
10	Ndërrimi i kombësisë së emigrantëve Shqiptarë që punojnë në vendet fqinje	1	2	3	4	9
11	Kërcënimi nga kriminelët e rrugës	1	2	3	4	9
12	Trafikimet e ndryshme	1	2	3	4	9
13	Ndryshimet e klimës	1	2	3	4	9
14	Kërcënimi nga radikalizmi/ekstremizmi fetar	1	2	3	4	9

<p><b>G2.</b> Sipas mendimit tuaj si do të ndryshojë gjendja ekonomike e popullit Shqiptar përgjatë 10 viteve të ardhshme?</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Do të përmirësohet shumë</li> <li>2. Do të përmirësohet deri diku</li> <li>3. Do të mbetet njëlloj</li> <li>4. Do të përkeqësohet deri diku</li> <li>5. Do të përkeqësohet shumë</li> <li>9. Nuk e di/pa përgjigje</li> </ol>
<p><b>H1.</b> A mendoni se Shqipëria duhet të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe si do të votonit në rastin e nje referendumi për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian?</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Pro</li> <li>(2) Kunder</li> <li>(3) Nuk do të merrja pjesë në votim</li> <li>(9) Nuk e di/pa përgjigje</li> </ol>
<p><b>H2.</b> Cfare efekti mendoni se do te kishte integrimi ne Bashkimin Evropian per Shqipërinë?</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Do te sillte zhvillim ekonomik dhe politik</li> <li>(2) Do te sillte zhvillim ekonomik</li> <li>(3) Do te sillte zhvillim politik</li> <li>(4) Nuk do te ndryshonte asgjë</li> <li>(5) Do te sillte probleme ekonomike</li> <li>(6) Do te sillte probleme politike</li> <li>(7) Do te sillte probleme ekonomike dhe politike</li> <li>(9) Nuk e di/pa përgjigje</li> </ol>
<p><b>H3.</b> Kur mendoni se Shqipëria do të anëtarësohet në BE?</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Brenda 5 viteve te ardhshme</li> <li>(2) Brenda 10 viteve te ardhshme</li> <li>(3) Do te duhen me shumë se 10 vite</li> <li>(4) Do te duhen me shumë se 20 vite</li> <li>(5) Asnjëherë</li> <li>(9) Nuk e di/Pa përgjigje</li> </ol>
<p><b>H5.</b> Ne përgjithësi si do ta vlerësonit angazhimin e qeverisë për anëtarësimin e vendit ne Bashkimin Evropian?</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Plotësisht i mjaftueshëm</li> <li>(2) I mjaftueshëm</li> <li>(3) Deri diku i mjaftueshëm</li> <li>(4) I pamjaftueshëm</li> <li>(5) Plotësisht i pamjaftueshëm</li> <li>(9) Nuk e di/Pa përgjigje</li> </ol>





































































































































